


# NENDORI



E PERMUJSHME LETRARE — ARTISTIKE — SHOQËRORE — POLITIKE

Çmimi: 3 lekë

# NENDORI



# NENDORI

REVISTË E PËRMUAJSHME  
LETRARE — ARTISTIKE  
SHOQËRORE — POLITIKE

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTEVE  
TË SHQIPËRISË

## L E N D A

**PLENUMI I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTEVE TË SHQIPËRISË** . . . . . 3

**Pandi Mele** — Pranvera — Thatësira po mposhtet — Ndërtueset — linogravurë . . . . . 71

**Musa Vyshka** — Njëzetvjeçarja Republikë, poemë . . . . . 77

**Dhimitër Xhuvani** — Tuneli, fragmente nga romani . . . . . 81

### LETËRSI E HUAJ

**D. A. Furmanov** — Desanti i kuq, tregim . . . . . 137

### BIOGRAFI E NJERËZVE TË SHQUAR

**K. S. Stanislavski** — Jeta ime në art. 166

### LIBRA TË REJA

«Tregime të moçme shqiptare» — «Fjalorth termash letrare» — «Mos e këndo atë këngë» — «Mirashi» — «Paraja» — «Kapiteni pesëmbëdhjetë vjeçar». . . . . 193

### KRONIKË KULTURALE

Ceremonia e dorëzimit të diplomave fituesve të çmimeve të Republikës — Takimi i tretë i estradave për vitin 1965 — Ekspozita e piktorit korean Lju Hien Suk — Koncert me muzikë shqiptare — Një ekspozitë që premtton — «Në kërkim të ngjarjeve». . . . . 202

1

Viti i XIII i botimit

Janar — 1966

## ME DY FJALË

Në kopertina: Si Marko «Njëzetvjetori i Republikës» dhe N. Xhufka «Kthim nga puna».

Riprodhime nga punimet e studentëve të institutit të Lartë të Arteve figurative.

**Kolegjumi i redaksisë:** Koço Bihiku, Qamil Buxheli, Fatmir Gjata, Vilson Kilica, Baki Kongoli, Kolë Jakova, Albert Papparisto, Sterjo Spasse, Ibrahim Uruçi (Zv. kryeredaktor), Kudret Velça.

## Plenumi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë

Për dy ditë rrjesht, më 3 e 4 dhjetor 1965, zhvilloi punimet plenumi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, në të cilin mernin pjesë shkrimtarë, artistë, piktorë, skulptorë, kompozitorë, punonjës të artit e të kulturës dhe të ftuar të tjerë.

Ndodheshin gjithashtu antari i Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë dhe zv. kryetar i parë i Këshillit të Ministrave, Manush Myftiu, antari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qëndror të Partisë, Ramiz Alia, ministri i kulturës dhe arteve, Fadil Paçrami, sekretarja e Komitetit të Partisë për qytetin e Tiranës Fiqrete Shehu, etj.

Plenumin e hapi sekretari i përgjithshëm i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Shevqet Musaraj.

Pastaj shoku Manush Myftiu i dorëzoi Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë Urdhërin e Flamurit të Kuq të Punës të klasit të parë, që Presidiumi i Kuvëndit Popullor i ka akorduar me rastin e 20 vjetorit të themelimit të saj.

Raportin mbi detyrat që u dalin shkrimtarëve dhe artistëve lidhur me detyrat që shtroi plenumi i 15-të i Komitetit Qëndror të Partisë «Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave» e mbajti kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Dhimitër Shuteriqi.

Pastaj u bënë diskutime. Shkrimtarët, kompozitorët, piktorët dhe skulptorët folën për sukseset, që janë arritur në letërsi e artet gjatë vjetëve të pushtetit popullor, mbi nevojën e një njohje më të thellë të realitetit për t'u lidhur më mirë me jetën e masave punonjëse, për mbështetjen në traditat kombëtare dhe artin popullor për të krijuar një letërsi dhe art më militant që lufton për çështjen e partisë e të popullit, duke zhvilluar më tej realizmin socialist. Ata premtuan se do të punojnë për të vënë në jetë detyrat e plenumit të 15-të të Komitetit Qëndror të PPSH për të krijuar sa më shumë vepra për popullin.

Në plenum foli edhe shoku Ramiz Alia.

Në fund nga plenumi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë iu drejtua një letër përshëndetje Komitetit Qëndror të PPSH.

## **Presidiumi i Kuvendit Popullor dekoron Lidhjen e Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë me «Urdhërin e Flamurit të Kuq të Punës» të klasit të parë**

*Fjala e shokut Manush Myftiu*

Të dashur shokë,

**P**residiumi i Kuvendit Popullor dekoron Lidhjen e Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë me «Urdhërin e Flamurit të Kuq të Punës» të klasit të parë me rastin e 20 vjetorit të themelimit të saj. Kjo dekoratë është një vlerësim i lartë që Partia, Qeveria si dhe i gjithë populli ynë i bën punës së madhe që ka bërë organizata juaj në organizimin, mobilizimin dhe edukimin e shkrimtarëve e artistëve, është një vlerësim i madh që i bëhet punës tuaj sa të lodhëshme aq edhe fisnike për zhvillimin dhe lulëzimin e letërsisë e arteve tona të realizmit socialist.

Sukseset që ka arritur Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve gjatë këtyre 20 vjetëve janë një kontribut i çuar në lëmin e formimit e të zhvillimit të mëtejshëm të kulturës sonë kombëtare. Ato janë merita e punës së kualifikuar e të ndërgjegjshme që keni bërë të gjithë ju antarët e kësaj organizate si dhe e udhëheqjes së drejtë e të urtë të Partisë sonë, e cila e ka ndihmuar, orientuar e përkrahur atë gjatë gjithë veprimtarisë së saj.

Plenumi i XV i Komitetit Qëndror të Partisë, i cili diskutoi problemet e letërsisë e arteve e vlerësoi në mënyrë të veçantë rolin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, rolin e të gjithë antarëve të saj në edukimin komunist të masave punonjëse dhe shprehu besimin se edhe në t'ardhmen organizata juaj do të verë të gjitha forcat në përmeshjen me sukses të rolit dhe misionit që ajo ka.

Duke ju dorëzuar këtë dekoratë të lartë më lejoni që në emër të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të K.Q. të Partisë, të Këshillit të Ministrave t'ju përgëzoj nxehtësisht për punën e kryer dhe t'ju uroj suksese të tjera akoma më të mëdha, në punën tuaj për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e arteve, për zbatimin në jetë të vendimeve që mori Plenumi i fundit i Komitetit Qëndror të Partisë.

## **Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë**

**TIRANE**

Të dashur shokë,

**N**e shkrimtarët dhe artistët e Shqipërisë, nga mbledhja plenare kushtuar punimit të materialeve të Plenumit XV të Komitetit Qëndror të Partisë «Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe të arteve për edukimin komunist të masave», Ju dërgojmë përshëndetje të zjarrta dhe Ju shprehim, bashkë me ndjenjat e dashurisë dhe të besnikërisë sonë të thellë, mirënjohjen pa kufi për kujdesin dhe ndihmën e çmuar që i ka kushtuar dhe po i kushton vazhdimisht Partia jonë marksiste-leniniste e Punës rritjes dhe zhvillimit të letërsisë dhe arteve shqiptare të realizmit socialist.

Vlerësimi që i bën punës sonë të dy dekadave Plenumi XV i Komitetit Qëndror, i cili përkoi edhe me festën jubilarë të organizatës sonë, të themeluar 20 vjet të shkuara nën udhëheqjen dhe me kujdesin e Partisë, na gëzon e ngazëllen pa masë, na jep fuqi e frymëzim për suksese më të mëdha në të ardhëmen.

Ne jemi të lumtur, të dashur shokë, që krijimtaria jonë e re e viteve të pushtetit popullor, e orientuar qysh në djep nga Partia jonë e dashur, në rrugën e lavdishme të letërsisë dhe të arteve të realizmit socialist, në shërbim të përpjekjeve dhe të aspiratave fisnike të masave punonjëse, ka dhënë kontributin e saj në veprën madhështore. që krijoi populli ynë heroik gjatë vetëm 21 vjetve nën udhëheqjen marksiste-leniniste të Partisë, me në krye themeluesin dhe organizatorin e saj, shokun Enver Hoxha.

Ne i kemi njëkohësisht përpara sysh të metat e punës sonë dhe detyrat që na shtron Plenumi XV për kapërximin e tyre dhe për një hov më të vrullshëm përpara në sasinë, në cilësinë, në temën sa më aktuale dhe në përmbajtjen e shëndoshë ideopolitike të krijimtarisë sonë në të ardhëmen.

Në prak të Planit IV pesëvjeçar, që do të shënojë pa tjetër një hap gjigant përpara drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë sonë socialiste dhe për nder të jubileut të lavdishëm

të 25 vjetorit të Partisë së Punës, mëmës së të gjitha fitoreve, Ju premtojmë, të dashur shokë, se do të çfrytëzojmë në mënyrë më luftarake të gjitha mundësitë dhe do të vëmë të gjitha energjitë tona mendore e fizike për të krijuar sa më shumë vepra arti të vlefshëme për edukimin komunist të masave, vepra që të pasqyrojnë punën dhe luftën heroike të popullit tonë, i cili, edhe pse i rrethuar dhe i kanosur nga armiqtë e tij të betuar imperialistë dhe revizionistë modernë, ndërton e shpie përpara, nën udhëheqjen e Partisë, me kazmën në njërën dorë e me pushkën në tjetrën, jetën e tij të gëzuar socialiste.

Ne kemi bindje të plotë, të dashur shokë, se premtimit të dhënë do t'i dalim në krye dhe se në të ardhëmen do të meritojmë më mirë besimin dhe konsideratën që ka Partia për ne.

Këtë bindje na e frymëzon dashuria dhe besimi në të ardhëmen më të lulëzuar socialiste të Atdheut, drejt së cilës ndrit e udhëheq, me mençuri dhe besnikëri tradicionale ndaj marksizëm-leninizmit ngadhnjimitar, Partia jonë e lavdishme e Punës me shokun Enver në krye.

**Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë dhe Komiteti i saj Qëndror me në krye shokun Enver Hoxha!**

**Lavdi Marksizëm - Leninizmit!**

Nga mbledhja plenare e shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë.

Tiranë, 4 dhjetor 1965

## **Fjala e hapjes e shokut Shevqet Musaraj**

Të dashur shokë,

**N**ë gjithë plenumet dhe konferencat që ka organizuar Lidhja jonë gjatë jetës së saj 20-vjeçare, plenumi që fillon sot punimet e tij ka një rëndësi të veçantë dhe të jashtëzakonshme, për dy arsye:

**Arësyeja e parë** është se do të merret me punimin e materjaleve të plenumit XV të Komitetit Qëndror të Partisë «mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe të arteve për edukimin komunist të masave», i pari plenum i Komitetit Qëndror që iu kushtohet posaçërisht problemeve tona, që u bën një analizë të gjithanëshme dhe të thellë, marksiste-leniniste, letërsisë dhe arteve shqiptare të realizmit socialist, që nxjerr konkluzione të atilla, të cilat na japin krahë për fluturime të reja dhe shënon rrugët e zhvillimit të tyre të mëtejshëm.

Materjalet e plenumit XV të Komitetit Qëndror përbëjnë për ne punonjësit e letërsisë dhe të arteve një program të gjerë pune në prag të planit të katërt 5-vjeçar, përgatitja e të cilit, me pjesëmarrjen e gjallë e të talentuar të masave punonjëse, shënon fillimin e një revolucioni të ri, të paparë, në ndërgjegjen, mendimin dhe vullnetin e njerzve tanë. Punimi i këtyre materjaleve në plenumin tonë të sotmë dhe diskutimet tona mbi problemet dhe detyrat që na dalin përpara, do të jenë pa dyshim një ndihmë e madhe për letërsinë dhe artet, në mënyrë që atq të mund t'i dalin në krye edhe më mirë në të arthmen misionit të lartë që u ka besuar Partia dhe populli.

**Arësyeja e dytë**, të dashur shokë, është se ky plenum për kohëzgjatë më shumë se sa me qëllim, mbahet në këtë vjeshtë festive të jubileut të Lidhjes sonë, e cila, tanimë, i mbushi të njëzet vjetët dhe mund të krahasohet fare mirë me atë pishën e fortë të maleve tona që, me trupin atje sipër e me rrënjët thellë, nuk iu trëmbet erërave dhe stuhive.

E themeluar më 7 tetor 1945 nën udhëheqjen dhe me kujdesin e Partisë si organizatë vetëm e punonjësve të le-

tërsisë dhe duke u shkrirë, në kongresin e përbashkët të majit 1957, në një organizatë të vetme me atë të punonjësve të muzikës dhe të arteve figurative, që egzistonte më vete qysh më 1952, Lidhja jonë i justifikoi, me punë të vlerësuar nga Partia dhe populli, shpresat dhe qëllimet që frymëzuan krijimin e saj qysh në muajt e parë të çlirimit.

Ne kemi pasur gjithmonë dhe do të kemi sa të jemi gjallë një mirënjohje të posaçme për iniciatoren e organizimit tonë, Partinë e Punës së Shqipërisë, e cila, megjithëse sapo kish marrë në duar fatet e popullit dhe ndeshej me vështirësi të tjera të mëdha për të piketuar rrugët e ndërlikuara të së arthmes, nuk la për asnjë çast jashtë kujdesit dhe preokupacionit të saj problemin e letërsisë dhe të arteve. Fitorja historike e 29 Nëntorit edhe s'kish mbushur motin, vëndi ish akoma në valën e rrëmbyer të përpjekjeve për të shëruar plagët e rënda të luftës dhe Partia sa po hidhte hapat e para, me shtetëzimet dhe me reformën agrare, në fazën e re të Revolucionit, nëpërmes të minave që kishin lënë prapa armiqtë, kur në Tiranë, me kujdesin dhe ndihmën e saj, mbahej konferenca e parë e punonjësve të letërsisë shqipe, që shpalli themelimin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë.

Lidhja jonë, që mori më vonë emrin «Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë», u rrit e u zhvillua, ashtu sikurse edhe lindi, nën udhëheqjen dhe me kujdesin e vazhduar, atëror, të Partisë sonë, e cila, ndonse e re për vete, trashëgonte urtësinë dhe pjekurinë shekullore të popullit të saj, ndjente në venet e saj gjakun e heroit legjendar Skënderbeut dhe të poetit të madh kombëtar Naimit, mbante të ndezur në zemrën e saj me flakë të mëdha ndriçojnëse, zjarrin e fuqishëm të ideve ngadhënjimtare të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Njëzet vjet të shkuara, duke u nisur nga një trashëgim i pamjaftueshëm letrar - artistik që na kishin lënë paraardhësit dhe me një numur të kufizuar kuadrosh, përgjithësisht të reja dhe pa përvojën e nevojshme, të frymëzuar dhe të inkurajuar kryesisht nga besimi në partinë tonë marksiste-leniniste, nën udhëheqjen e së cilës populli kish korrur fitoren më të madhe të historisë së tij kundër pushtonjësve të huaj dhe shtypjes nacionale, ne i përvisheshim një rrugë shumë të vështirë: rrugës për të ndërtuar, mbi ato baza të pakta që kishim, letërsinë dhe artet e reja shqiptare të realizmit socialist, që duhej të kishin për burim të parë frymëzimi jetën dhe aspiratat e popullit në fuqi, luftën dhe punën e tij për një të arthme të bukur e të begatëshme, për një atdhe të fuqishëm e të përparuar.

Këtë jetë të bukur e të begatëshme të popullit tonë, këtë atdhe të fuqishëm e të përparuar të shqiptonjës, që ishte para 20 vjetve vetëm një ëndërr e largët, një vegim,

ne i shohim sot të realizuara. Ne kemi ndjekur hap pas hapi me syt e ballit dhe të zemrës transformimin madhështor të jetës dhe rritjen e fuqishme të atdheut, që kryshequr nga shoku Enver Hoxha, me luftë dhe përpjekje të paepura të klasës sonë punëtore, të fshatarësisë dhe të inteligjencës popullore të vëndit; kemi ndjerë thellë pathosin heroik të luftës për shëmbjen e së vjetrës dhe ngadhënjimin e së resë në këtë ishull të sulmuar nga dallgë dhe piratë siç është Shqipëria jonë e rrethuar nga armiq pa skrupull imperialistë e revizionistë dhe ndjenjat e gëzimit e të entuziazmit tonë i kemi shprehur në vargje, në ngjyra, në tinguj dhe në bronx e në mermer, në vepra që rritin e transformojnë ndërgjegjen e popullit dhe e frymëzojnë atë për fitore gjithënjë më të mëdha në rrugën madhështore të socializmit.

Kjo ka qënë dhe është për ne një punë e nderuar, të cilën ne ja kushtojmë, në radhë të parë, udhëheqëses dhe mësonjësës sonë të madhe Partisë që, me dritën e saj marksiste-leniniste, na tregoi që në fillim rrugën fisnike të shkrimtarit dhe të artistit në shërbim të popullit. Ç'është e vërtetë, fitorja e parë e frontit tonë letrar-artistik ishte pikërisht ajo që punonjësit e këtij fronti, ndonse vinin nga shkolla të ndryshme dhe, nëpër ta, kish edhe të atillë që kishin rënë me ndonjë krijim të tyre në pozitë e estetikës idealiste, mundnë të bënin shumë shpejt kthesë rrënjësore në botëkuptimin e tyre dhe të përqafonin pa rezervë vijën ideologjike e politike të partisë, marksizëm-leninizmin.

Në këtë rrugë të lavdishme, radhët tona u shtuan nga viti në vit me forca të reja; për pasojë, u rrit krijimtaria në letërsi, në artet figurative, në muzikë dhe kjo solli, sikundër ish e natyrshme, në ngritjen e vazhduar të cilësisë, në zgjerimin dhe larminë e tematikës, në trajtimin me sukses të të gjitha gjinive letrare e artistike. Kapërximi brëndë njëzet vjetve nga tregimi i shkurtër apo skeçi teatral të romani e të drama, nga gjinia e lehtë e muzikës të simfonia dhe opera, nga peizazhi e portreti te kompozicioni dhe skulptura monumentale, pa iu mërguar traditave më të mira që trashëgonim, po, përkundrazi, duke i shpurë më tej ato dhe duke pasur gjithmonë në plan të parë përmbajtjen e shëndoshë ideologjike të veprave — ky kapërxim përbën një hap kolosal përpara, një fitore të madhe, e cila nuk mund të arrihej veçse në kushtet e revolucionit të thellë ekonomik, shoqëror e kultural që u krye në vëndin tonë nën udhëheqjen marksiste-leniniste të Partisë.

Në jubileun e gëzuar të 20-vjetorit të organizatës sonë, shpërblimi më i madh për ne punonjësit e letërsisë dhe të arteve, është vlerësimi që i bën punës sonë njëzetvjeçare

Komiteti Qëndror i Partisë në plenumin e tij të XV-të, është besimi që ushqen ai, edhe për të arthmen, në fuqinë dhe talentin tonë krijonjës.

Ne i jemi thëllësisht mirënjohës Partisë dhe i premtojmë se këtë mirënjohje tonën, ashtu si dhe dashurinë dhe besnikërinë tonë tradicionale ndaj saj, do të vazhdojmë ta shprehim, në mënyra më konkrete dhe me forcë më të madhe, në krijimet tona të arthme dhe në zbatimin e përpiktë, revolucionar, të të gjitha detyrave që na shtron plenumi XV i Komitetit Qëndror.

Përvoja 20 vjeçare e Lidhjes dhe fitoret e arritura janë pa dyshim një bazë e shëndoshë për marshime të reja, drejt të cilave na frymëzon dashuria ndaj Atdheut, na ndrit e na udhëheq, me besnikëri shëmbëllore ndaj marksizëm-leninizmit, Partia jonë e lavdishme e Punës me shokun Enver Hoxha në krye.

## Për një hov të ri në letërsinë dhe artet tona të realizmit socialist \*)

Të dashur shokë,

Jemi pak më shumë se një muaj mbas Plenumit XV të K.Q. të Partisë, Plenum që iu kushtua çështjeve të letërsisë dhe arteve tona të realizmit socialist, ngritjes së rolit të tyre për edukimin komunist të masave, zhvillimit të gjithanëshëm të tyre në sasi e cilësi, thellimit të karakterit revolucionar dhe kombëtar të tyre, luftës që letërsisë dhe arteve u takon të bëjnë në frontin e madh ideologjik, në të cilin, në Shqipëri, marksizëm-leninizmi është angazhuar kundër ideologjisë borgjeze dhe pjellës më të rrezikëshme të saj, revizionizmit modern.

Gjatë kësaj kohe të shkurtër pas Plenumit XV, ne kemi vënë re interesin e madh që kanë treguar shkrimtarët dhe artistët tanë, dhe jo vetëm ata, po gjithë populli, për **Raportin** e Byrosë Politike, mbajtur nga Sekretari i K.Q. të Partisë, shoku Ramiz Alia, dhe aprovimin e plotë që ky **Raport** shkencor gjen kudo tek ne. Interesi i masave për problemet tona letrare dhe artistike nuk është tanimë diçka e panjohur në jetën e atdheut tonë socialist. Po kjo mund të quhet një gjë vërtet e re në Shqipëri, ku në të kaluarën prapambetja e madhe, analfabetizmi e varfëria, zor se linin të tjerë të preokupohen për këto çështje, veç një grushti njerzish që kishin fatin të merren me to. Edhe këta, me buzën të plasur, më shpesh diskutonin midis tyre jo mbi lulëzimin e artit e të letërsisë, po mbi problemin e «shterpësisë letrare».

Në Pukë, Migjeni përpiquej t'u japë nxënësve njohuritë fillore dhe sidomos t'u japë zemër për jetën, po këta nxënës a e dinin vallë se me kë kishin të bëjnë? A tingëlluan më ndonjë mbrëmje kulturele të Pukës vargjet për «Shkëndijën» që po xixëllonte te «qiella arbënore», për «Diellin (alegorik)», të cilit poeti i ndjente ngrohtësinë nga larg? A u dëgjua atje protesta e poetit ndaj artit në shërbim të klasave në fuqi, ndaj «rubinëve» të «metresave»?

\*) Referat mbajtur në Plenumin e Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve.

Nuk po e zë rastësisht me gojë emrin e Pukës. Në ato male të Dukagjinit sot, ku sharrat automatike bëjnë punën e dhjetra e qindra punëtorëve, ku pyjeve nuk enden më shtojzovallet, po buçasin maqinat, ku lahuta apo çiftelia ia ka marrë me kohë këngës së Partisë dhe të socializmit, atje, sigurisht, sot bisedohet edhe për rrugët që ka ndjekur letërsia dhe arti ynë i ri këto njëzet e një vjet që shkuan, për perspektivën që atyre u është çelur, për detyrat që u dalin jo vetëm artistëve dhe shkrimtarëve mjeshhtë, po edhe amatorëve, që ta shpien me hov të ri përpara artin, letërsinë tonë të realizmit socialist. Njerzit mblidhen në aktive partie të rretheve, ata mblidhen nëpër organizatat bazë të partisë, mblidhen në artin dhe letërsinë tonë. S'është vetëm gjithë Partia, s'janë vetëm të 50.000 komunistët, që merren me këtë problem të madh të ndërtimit kultural dhe të kalitjes së njeriut të ri, është populli i gjithë që mendon për letërsinë, për artin e vet.

Nuk mund të rrija pa kujtuar këtë fakt të ri dhe kaq të rëndësishëm në krye të fjalës sime, për arësyen se, ndër ne, arti jo vetëm i drejtohet popullit, të cilit i përket, po arti ka filluar të jetë një preokupim i masave. Dhe këtu është një nga çfaqjet e forcës dhe dinamizmit të tij, një nga arësytet e hovit që ai njohu këto njëzet e një vjet dhe e hovit të ri që ai ka për të njohur në të ardhëmen.

Shkrimtarët dhe artistët e kanë pritur me gëzimin dhe interesimin më të madh Plenumin e K.Q. të Partisë mbi letërsinë dhe artet. Qenë disa muaj që ky Plenum përgatitej. Gjatë këtyre muajve, secili prej nesh, në mënyrë veçanërisht të përqëndruar, mendoi tek problemet e letërsisë dhe arteve tona, tek sukseset dhe dobësitë, tek e nesërmja e tyre. Secili ka menduar edhe për vete të vet, për rrugën që ka ndjekur, rezultatet që ka arritur, perspektivën që i çel zhvillimi i mbarë kulturës në vendin tonë, që i çel puna që ai vetë ka bërë, pjekuria ideologjike që ka fituar. Kështu, secili prej nesh ka ndërë detyrat dhe përgjegjësitë personale dhe të kolektivit.

Asnjëherë, në historinë e vet, arti dhe letërsia jonë s'kanë qenë më të vetëdijshëm të detyrave dhe mundësive të tyre, as edhe gjatë kohës së ndritur të Rilindjes, që u karakterizua nga një patriotizëm i rrallë dhe nga një besim jo i zakonshëm në fatet e Shqipërisë. Po në se ahëre, fatet e atdheut të robëruar i bashkonin njerzit me idetë dhe ndjenjat e lirisë dhe pamvarësisë, e kështu edhe për një të ardhëme «të qytetëruar», si thuhej ahëre, sot, një Parti e madhe, e pajisur fort me ideologjinë më të përparuar të kohëve, me shkencën e ndërtimit të së ardhëmes, na ka bashkuar ne, njerzit e artit dhe letërsisë, duke na mbrujtur me ideologjinë e saj, dhe na ka bërë veçanërisht të ve-



Presidiumi i mbledhjes

tëdijshëm të kërkesave që ka ndaj nesh epoka. Forca jonë është ky bashkim. Ai shpjegon sukseset tona të gjertanishme, ai premtion hovin e ri me të cilin do të kapërxejmë në të ardhëmen e krijimtarisë sonë, ai është krenaria jonë.

Ne jemi këtu më se dy qind shkrimtarë dhe artistë, pjesëtarë të Lidhjes sonë, po në Shqipëri janë edhe disa qindra e mijra njerëz të tjerë të artit, të cilët, anëtarë ose jo partie qofshin, kanë përqafuar idealet e Partisë dhe punojnë për kalitjen e ndërgjegjes komuniste të masave. Kjo ushtri, që tani jo e vogël e njerëzve të artit, karakterizohet prej besnikërisë ndaj çështjes së komunizmit. Problemet e letërsisë dhe arteve tona që ngriti Partia në plenumin e fundit të Komitetit të saj Qëndror, ja përse kanë gjetur atë jehonë në secilin prej nesh dhe tek ne të gjithë. Kjo është një garanci e vërtetë për realizimin e detyrave që na shtron koha dhe na sqaron Partia.

\* \* \*

Unë, shokë, nuk do të flas gjatë për sukseset e arritura këto dy dekada nga letërsia dhe arti ynë i realizmit socialist. Ne kemi pasur rastin të flasim dhe të tjera herë për to dhe veçanërisht të shkruajmë. Pastaj, Partia tha fjalën e vet për këto suksese në Plenumin XV.

Në se do ta karakterizojmë shkurt gjendjen e sotme në letërsinë dhe artet e Shqipërisë, duhet të themi, ashtu si ç'u përcaktua në Raportin e B.P., se ata «u vunë në rrugën e realizmit socialist, u bënë plotësisht letërsi dhe arte socialiste». Kjo ka një rëndësi të veçantë të vihet në dukje, duke pasur parasysh se revolucionet kulturele nuk janë si revolucionet politike, po kërkojnë një kohë më të gjatë për t'u zhvilluar e për t'u kryer. Për t'u kryer procesi i kapër-

ximit të letërsisë sonë nga pozitat e djeshme patriotike dhe demokratike të një letërsie që, ndonse ishte në luftë me letërsinë e artin zyrtar dhe me ideologjinë zyrtare të feudoborgjezisë, sapo kishte nisur ta theksojë karakterin e vet revolucionar demokratik, për të kaluar nga pozitat e një Noli apo të një Migjeni, në pozitat e hapta dhe të plotë socialiste, u deshën disa vjet. Shenjat e pjekurisë që dha letërsia jonë e re me romanet e dramet e saj të para në vitet 1949-1950, ishin shenjat që ne po bënim sulmin për ta marrë kalanë, për të krijuar një letërsi dhe art të realizmit socialist në çfaqjet sa më të gjera, jo më vetëm në poezi, po dhe në prozë, edhe në dramë, edhe në artet figurative, edhe në muzikë, për të kapërxyer edhe në kinema.

Pjekuria që nisi të duket në letërsinë dhe artet tona të viteve që shënova, tanimë është realitet. Kjo pjekuri, edhe në një revolucion të madh artistik si ky që bëmë dhe po kryejmë ne, s'mund të vinte me një vepër e me dy. Ajo kërkonte dukjen e disa veprave, të cilat, në gjinitë më të ndryshme, mund të mateshin me disa prej krijimeve të çuara të së kaluarës sonë letrare dhe artistike; ajo kërkonte gjithashtu, që niveli i përgjithshëm i krijimtarisë sonë letrare dhe artistike të ngrihej. Krahasimi më i thjeshtë që do të bëhej midis numurit të ndonjë reviste apo gazete letrare dhe kulture të së kaluarës me të sotmet, do ta tregonte menjëherë këtë. Dhe mjaft të kujtohem për ndonjë ekspozitë apo koncert të së kaluarës dhe ta krahasojmë me të sotmet.

Po, sikundër thuhet në Raportin e Byrosë Politike të K.Q. të P.P.Sh. «karakteristika themelore që dallon letërsinë dhe artet tona të reja është pastërtia ideologjike, fryma luftarake e revolucionare që i përshkon ato, si dhe fryma e shëndoshë kombëtare.»

Tallaze të mëdha ka njohur bota dhe veçanërisht bota socialiste këtë pjesë shekulli që ne ndërtonim në Shqipëri një letërsi dhe art të realizmit socialist. Tradhëtia titiste më 1948 çilte rrugën e një devijimi të madh ideologjik, që në fushën e artit dhe të letërsisë jo vetëm do të bëhej nga më të rrezikshmit, po ku do të kërkonte të gjejë edhe një mbështetje të veçantë. Një mbështetje të tillë ai devijim e gjet, fjala vjen, në një numur letrarësh dhe artistësh gjatë kundërvolucionit hungarez tetë vjet më vonë. Dhe ne konstatojmë me dhimbje e neveri në të njëjtën kohë, se si disa nga përfaqësuesit më të njohur të realizmit socialist në B.S. e gjetiu u kthyen në shërbetorë të revizionizmit, morën përsipër të njollosin artin e tyre, për të mbështetur një politikë renegate, që i solli kaq dëme B.S. vetë, kampit të socializmit dhe çështjes së komunizmit nëpër botë.

Është merita jonë, — dhe këtë e themi me ballin lart, — që, ndonse të rinj fort, të rinj në mjeshtërinë artistike dhe të rinj në luftën ideologjike, duke na u dashur të krijojmë të parat drama e romane të letërsisë sonë të re, të parat opera e sinfoni në historinë e muzikës shqiptare, të parat tablo ku të zënë vendin e nderit punëtori dhe fshatari i Shqipërisë, të xhirojmë të parat metra film, të emërojmë profesioniste të parat trupa të teatrit apo baletit, — është merita jonë, që, ndonse kaq të rinj, ne i qëndruam luftës së madhe ideologjike dhe i qëndruam fort. Kjo i detyrohet Partisë sonë marksiste-leniniste, i detyrohet udhëheqjes së lavdishme të Partisë sonë, shokut Enver Hoxha, të cilët idetë e tyre i çelnikosën në lufta legjendare.

Epoka e re që lindi në Shqipëri, nga një revolucion që shpartalloi së gjithash një ndër çerdhet më të molepsura të reaktionit në Evropë, kjo epokë bëri të lindë një parti të re, e cila u farkëtua në zjarrin e betejave me feudo-borgjezinë dhe fashizmin, me imperializmin, me çdo devijim sado të vogël apo të madh në radhët e veta. Merita jonë është se këtë parti dhe idealet e saj i përqaftuam me gjithë zemër, me gjithë shpirt. Dhe ja përse krijuam një art të ri, me gjithë zemër e me gjithë shpirt të ri, socialist.

«Epopeja e Ballit kombëtar» dhe «Para Agimit», «Prishtina» dhe «Ringjallja», «Ata nuk ishin vetëm», «Halili dhe Hajria» dhe «Toka jonë», «Tana» dhe «Kënet»; lirika të Çaçit, Varfit, Skënderit, Qafëzezit, Agollit, Gurakuqit, D. Siliqit e Balës; «Shekulli im» dhe «Përse mendohen këta male», «Hasta la vista», «Një vjeshtë me stuhi»; novela dhe tregime të Sakos, Andonit, Xhuvanit, Dedes, Xoxes, «Lumi i vdekur»; drama si «Familja e peshkatarit», «Shtëpia në bulevard», «Doktor Aleks», «Hijet e natës», drama të tjera të Brojës, Levonjës, Lucës; satirat e Bulkës, të Milotit, Bubanit, Çomorës, «Karnavalet e Korçës»; puna e R. Brahimit në kritikën letrare; vepra të skulpturës si «Enver Hoxha» dhe «Vojo Kushi» në Tiranë, monumenti i «Leninit» po në kryeqytet, ai i «Skënderbeut» në Krujë, i «Kristoforidhit» në Elbasan, skulptura të tjera, të Lllazarit, Manas, Hadërit; tablo si «Refugjatët» e Buzës, «Tregimi nga Lufta nacional-çlirimtare» i Zajmit, «Partizani» i Stamos, «Punëtori» i Kilicës dhe piktura të tjera, të Kacelit, Madhit, Papës, Shoshit; grafika të S. Markos e Dilos, karikatura të Bumçit; operat «Mrika» dhe «Lulja e kujtimit», baletet «Halili dhe Hajria» dhe «Delina», këngë të Dungut, Kongolit, Avrazit, Grimcit, K. Uçit, Prodanit; filma të krijuar prej Kekos, Dhamos, Hakanit, Gjikkës; puna e arqitektëve si Lufi, S. K. Luarasi, Strazimiri, Dobi, Mosko, Pistoli, Kolevica etj, — ja disa nga veprat dhe emrat e ta-

lenteve të shumta të letërsisë dhe arteve tona të këtyre dy dekadave. Vetëm ky rrjeshtim titujsh e emrash, që pa dyshim është i mangët, jep një ide të punës së madhe që është bërë gjer më sot, të rezultateve të çmueshme që janë arritur, të traditës realiste socialiste që krijoi vërtet me sulm, në këto dy dekada, letërsia dhe arti ynë i ri.

Megjithëse ne këtu flasim për artin dhe letërsinë origjinale, nuk duhet të harrojmë punën që kanë bërë përkthetnjësit, për të na dhënë shqip disa nga veprat më të rëndësishme të letërsisë botërore. Veprat e përkthyerat me dinjitet të lartë artistik, me punën mbi gjuhën dhe stilet, hyjnë në përpjekjet e çuara letrare të një vendi. E çmuar është puna e Cacit, Kutelit, Poradecit, S. P. Luarasit, Kokonës, Ficos, P. Gjeçit etj në fushën e gjerë të përkthimeve tona.

Ata që i kanë vënë në skenë apo i kanë lojtur veprat tona, është zakoni të quhen «artistë ekzekutues», po të gjithë ne e çmojmë rolin e tyre krijues. Një pjesë e suksesit të shumë veprave tona i kushtohet edhe punës së regjizorëve, si Stillu, Spahivogli, M. Luarasi, Mani, Oktrova, të aktorëve si Popi, Kovaçi, Gjoka, Frashëri, Logoreci, të socialistëve si Kraja, Mula, Xhemali dhe plot të tjerë që nuk i përmenda, të dirigjentëve si Krantja, Teqja e Gjoni.

Është bërë një punë kolosale e përbashkët, e shkrimtarëve dhe artistëve të gjithë kategorive, për t'u krijuar, në këto dy dekada, një letërsi dhe art shqiptar i realizmit socialist. Të gjithë së bashku, ne kemi ditur të mbështetemi fort në traditat tona kombëtare dhe në ato ndër-kombëtare, të frymëzuar nga përpjekja e lavdishme e popullit tonë për ndërtimin e socializmit, të ndriçuar e të udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme marksiste-leniniste. Këtë rrugë do të ndjekim ne edhe në hovin tonë të ri.

\* \* \*

Karakteristika më e rëndësishme e letërsisë dhe arteve tona është pastërtia ideologjike, fryma e partisë dhe fryma e shëndoshë kombëtare e tyre. Kjo është edhe pasuria më e çmuar, forca e tyre themelore për t'u bërë edukuese të masave dhe për të mbajtur edhe ato lart flamurin e luftës kundër ideologjisë armike. Dhe kur ne ngrejmë zërin kundër ndonjë gabimi, gabim që na cënon tamam atë pastërti për të cilën krenohemi, këtë e bëjmë se marksizëm-leninizmi na ka mësuar dhe jeta na ka provuar se vigjilenca është një pjesë e luftës ideologjike, se kjo luftë është e përditëshme dhe e çdo çasti, se pa këtë luftë nuk mund të ruajmë e të forcojmë asgjë të çmuar që krijuam.

Kemi hyrë në një fazë pjekurie të dukëshme të letërsisë dhe arteve tona, po jemi akoma në fillim për zhvillimin e disa gjinive e llojeve, si fjala vjen drama, opera, simfonia, filmi etj. Ne duhet të marrim përvojën e huaj për më se një gjini, si fjala vjen për muzikën e lehtë, artin e të pikturuarit, të vënies në skenë, të skenareve kinematografike. Mungesat që ende ndjehen në mjeshtërinë artistike, amatorizmi që disaherë vijon të karakterizojë një pjesë të krijimtarisë sonë, dobësia ende e ndieshme e kritikës sonë letrare dhe artistike, e rrahjes së mendimit tonë estetik, e pastaj rrethimi gjeografik, mjetet aq të shumta të propagandës armike që na rrethon, të gjitha këto a nuk na tregojnë, në radhë të parë e mbi të gjitha, rrugën e vigjilencës dhe të luftës së papajtueshme ideologjike që duhet të ndjekim si shkrimtarë dhe artistë?

Unë fola për pastërtinë ideologjike të artit dhe letërsisë sonë, për frymën revolucionare dhe luftarake që i karakterizojnë ato në themel. Nuk po flas për disa gabime që kemi njohur në krijimtarinë tonë të këtyre viteve të fundit, veçanërisht me disa drama, po edhe me vepra të prozës, me disa këngë dhe manifestime të huaja në fushën e muzikës së lehtë. Nuk po merrem konkretisht me këto dështime, për të cilat kemi biseduar e diskutuar dhe që përmenden edhe në Raportin e Byrosë Politike të K.Q. të P.P.Sh. mbi letërsinë dhe artet. Po a nuk duhet të bëjmë ne disa pyetje të tilla përpara dështimeve dhe shkarjeve tona? P. sh.: përse disa shokë, që kanë krijuar vepra të mira dhe të talentuara, që me krijimtarinë e tyre kanë treguar se janë në rrugën e drejtë të realizmit socialist, krijuan edhe ndonjë vepër ideologjikisht të shtrembër? Përse ne të tjerët dhe veçanërisht shokët që drejtojnë Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, organet e shtypit të kësaj Lidhje, apo sektorë të ndryshëm të punës letrare e artistike, lejuan të botohen dhe të çfaqen vepra me të meta ideologjike disaherë themelore?

Nuk është fjala, më duket mua, për gabime të veçanta vetëm, po edhe për një përgjegjësi kolektive. Në Raportin e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë mbi letërsinë dhe artet, thuhet se gabime të tilla «nuk do të kishin ndodhur nëqoftëse shokët komunistë, kuadrot dhe të gjithë punonjësit e këtij fronti do të punonin duke u nisur nga mësimet e partisë dhe jo nga simpatitë apo antipatitë personale». Aty flitet për «një farë indiferentizmi që vihet re disaherë në radhët e shkrimtarëve dhe artistëve». Aty i tërhiqet veçanërisht vërejtja Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve për «orientimin ideologjik të problematikës së Lidhjes dhe kalitjen ideologjike të anëtarëve të saj», që ndonse «në përgjithësi ka qenë e mirë, po në disa raste ajo nuk

ka qenë në nivelin e duhur dhe është bërë me gabime». Unë si kryetar i kësaj organizate dhe kështu edhe shokët e mi të Kryesisë e të Komitetit Drejtues, ata të seksioneve të Lidhjes dhe veçanërisht ata që kanë drejtuar redaksitë e organeve të shtypit të Lidhjes, revistën «Nëndori» dhe gazetën «Drita», kemi një përgjegjësi të drejtpërdrejtë për këtë. Ka pasur mundësi që ne të gjithë të punojmë më mirë, të tregohemi më parimorë e më vigjilentë.

Më lejoni ta analizoj edhe më tej këtë çështje.

Sikundër vihet në dukje në **Raportin** e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë letërsia dhe artet tona sot janë duke bërë përpjekje të meritueshme për paraqitjen e thellë të realitetit, për theksimin e karakterit të tyre realist. Në fakt, një prej karakteristikave të letërsisë sonë të sotme, në krahasim me atë të para Luftës nacional-çlirimtare, është se tendencat realiste që kishin nisur të zhvillohen ahëre në letërsinë tonë, pas luftës, me triumfin e metodës së realizmit socialist, triumfuan edhe ato. Zbulimi i realitetit në art, është, ndër të tjera, zbulimi i kontradiktave që janë në gjirin e shoqërisë vetë, të çfarëdo lloji qofshin këto kontradikta, antagoniste dhe jo antagoniste. Ja përse «letërsia dhe artet nuk mund të kuptohen pa frymën e tyre kritike kundër çdo gjëje të huaj, të prapambetur e reaktionare që pengon ecjen përpara të shoqërisë sonë», thuhet në **Raportin** e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë mbi letërsinë dhe artet.

Në të vërtetë, letërsisë sonë të realizmit socialist nuk i ka munguar fryma kritike. Edhe në himnet me të cilat poezia jonë e re i ka thurë lavdinë epokës që inauguroam, edhe aty fryma kritike, — dhe e rrebtë kritike, — ndaj botës së errësirës prej së cilës dolëm dhe që ende jeton përtej kufinjve tona, ajo frymë kritike s'ka munguar. Po me zhvillimin e prozës dhe dramës, zhvillim që është një nga fenomenet më të rëndësishme të jetës së letërsisë sonë të re, është vetë jeta e shoqërisë shqiptare të gjithë kohëve dhe veçanërisht të kohës sonë, që ka nisur të hyjë me vrull në letërsi. Është karakteristikë e një drame, fjala vjen, që të vërë në skenë ndeshjet e mëdha të jetës. Po ç'është një ndeshje, në mos lufta midis së resë dhe së vjetrës? Dhe çfarë mund të triumfojë në artin progresist dhe në artin e realizmit socialist veçanërisht, veçse e reja kundër së vjetrës? Triumfi i së resë nuk është diçka artificiale, që arti e krijon vetë dhe që jeta s'e ka. Triumfi i së resë është një realitet i përditshëm, që karakterizon jetën në zhvillimin e saj të papëmbajtur, dhe që pastaj vjen e pasqyrohet në art. Po triumfi i së resë bëhet vetëm përmes mohimit të së vjetrës dhe kapërximit të saj, dhe është tamam ky mohim dhe ky kapërxim që përbën thelbin kritik të artit, i cili,

për të pohuar, duhet të mohojë, — të tregojë se si e vjetëra shembet, duke treguar se si triumfon e reja.

Zhvillimi i gjinive të mëdha në letërsi, — dhe duhet të themi edhe në artet shqiptare, — nuk kishte si të bëhej pa një paraqitje më të gjithanëshme të jetës në veprat tona. Ky qe, dhe vazhdon të jetë, një si vërshim i jetës në letërsi dhe arte. Janë tipat më të ndryshëm të njeriut shqiptar të gjithë kohëve dhe veçanërisht të kohës sonë, që filluan të vërshojnë nëpër veprat e reja dhe të marrin jetë aty. Janë ambientet më të ndryshme shqiptare që u rikrijuan në letërsi dhe arte. Kjo është bërë duke e parë jetën me syrin marksist-leninist dhe duke e trajtuar atë në pajtim me interesat e ndërtimit socialist. Kjo frymë kritike, sa më e qartë dhe më e drejtë ka qenë, aq edhe në mënyrë më të thellë e ka paraqitur jetën në zhvillimin e saj dialektik. Dhe kur ne themi që të thellohem në realitetin tonë, që ta paraqitim atë me vërtetësinë më të plotë në veprat tona, që të jemi edhe më të zot për të zbuluar të renë që lind apo zhvillohet, për ta vënë atë sa më shumë e më mirë në reliev, çfarë kuptojmë tjetër veçse jetën e kësaj së reje, domethënë luftën e saj për të lindur, për t'u zhvilluar, për të triumfuar? Kjo luftë a nuk bëhet me të vjetrën që do të zhduket dhe duhet të zhduket? Është tamam kjo luftë që paraqitet edhe në letërsi e art. Fryma kritike e artit tonë ka qëndruar dhe qëndron në zbulimin e kontradiktave të vërteta të jetës dhe në trajtimin e drejtë të këtyre.

Po këto vjet, që letërsia dhe arti ynë, posaçërisht me zhvillimin e gjinive të gjata të dramës dhe të prozës, nisën ta trajtojnë jetën në mënyrë më të gjithanëshme e më të thellë, kur letërsisë dhe arteve tona u është shtruar si detyrë historike e zhvillimit të tyre thellimi i tendencës realiste, tamam këto vjet ngjanë, në B.S. dhe në vende të tjera socialiste, lëkundjet e mëdha revizioniste edhe në fushën e artit e të letërsisë. Ideologët dhe estetët borgjezë kishin disa dhjetra vjet, që, pasi mohuan së pari përpjekjen e re artistike në vendin e parë socialist në botë, — si ç'kishin mohuar edhe përpjekjen vetë për ndërtimin e socializmit, — u orvatën të tregojnë se nga kjo përpjekje nuk lindi ndonjë art i vërtetë, po «një mjet i thjeshtë propagande pa shije dhe pa vlera». Duke injoruar me hile sukseset e mëdha të realizmit socialist në B.S. e në botë, ata, masën e veprave letrare e artistike me vlera modeste ose pa vlera të vërteta, u përpoqën ta paraqitin si rezultat të përpjekjeve për artin e ri. Provoni që kohës së Shekspir-it t'i hiqni Shekspirin dhe, për të çmuar dramaturgjinë e asaj kohe, të injoroni «Hamletin», «Makbethin», «Mbretin Lir» etj. Po të bëni këtë gjë, ju mund të përfundoni se ajo kohë nuk kishte dramaturgj. Merret me mend se sa

mund të çmohet poezia e djeshme sovjetike, fjala vjen, po të injorohet, midis të tjerave, vepra e një Majakovski dhe poezia e asaj kohe të përfaqësohet vetëm nga Kirsanovët. Tek afirmimi i së resë, tek triumfi i saj në art, ideologët dhe estetët e borgjezisë nuk panë të vërtetën e jetës të pasqyruar nga arti, po, me syun të mësuar nga realizmi i tyre i pashpresë kritik, panë një «himn të fryrë» të realitetit socialist.

Kështu edhe revizionistët i mohuan realizmit socialist qëndrimin e tij kritik ndaj realitetit, jo për tjetër gjë, po sepse realizmi socialist kishte pohuar ndërtimin e shoqërisë së re. Dhe ja Solzhenicinët e Tvardovskët, që me veprat e tyre artistike dhanë kushtimin për të vënë në qëndër të letërsisë sovjetike jo luftën për socializmin, po luftën kundër kohës së «kultit të individit», d.m.th. luftën kundër asaj që ishte ndërtuar në B.S. Orientalimi i artit për të kritikuar kohën e Stalinit, ç'donte të thotë tjetër veçse luftë kundër sistemit socialist, i cili duhej diskredituar, përpara se t'i çilej varri në B.S.? Dhe himnizimi i bujshëm i kohës së Hrushovit dhe i shokëve të tij, që zuri vend në letërsinë dhe artin sovjetik, ç'donte të thotë tjetër veçse duartrokitje e kthesës drejt kapitalizmit, që po përpiqen revizionistët të kryejnë në B.S.? Për të vënë në zbatim këto detyra të reja, arti revizionist bëri të vetën, nga njëra anë, metodën e realizmit kritik, me të cilën mund të çkallmohet, po të mos ndreqesh, dhe, nga ana tjetër, metodën e romantizmit reacionar, që nuk vështron më nga e ardhmja, po nga e djeshmja, që rron me nostalgjinë e së kaluarës, duke dashur të bëjë për ideal të shoqërisë mënyrën e të jetuarit në Perëndim.

Këto janë disa nga rrethanat ndërkombëtare, në të cilat letërsia dhe artet tona theksojnë karakterin e tyre realist. Në këto rrethana, merita e shkrimtarëve dhe artistëve tanë është se kanë ruajtur të pastër krijimtarinë e tyre dhe e kanë zhvilluar atë drejt, në rrugën e realizmit socialist, kanë ditur ta mbajnë lart flamurin që përpiqen ta hedhin poshtë revizionistët. Po ne s'mund të harrojmë se jemi një letërsi dhe art i ri, me kuadro të reja dhe eksperiencë përgjithësisht të re. Dhe fakt është se luftën që duhet të bëjmë, në fushën e mendimit estetik, kundër revizionizmit, këtë luftë e kemi bërë fare pak gjer më sot. Në se, lherë pas here, disa shokë shkrimtarë ose artistë i kanë trajtuar problemet e luftës kundër revizionizmit në letërsi dhe art, njerzit tanë që merren me filozofinë ende nuk janë hedhur në problemet estetike, megjithëse këto janë probleme të mëdha e nga më pasionantet e ditës. Po kështu edhe një numur jo i vogël pedagogësh, që japin mësimin e letërsisë nëpër

shkollat tona të mesme dhe të larta. Mungesa e ndieshme ndër ne e kësaj lufte, rrezikon të çarmatosë vigjilencën kundër depërtimit të ndikimeve të huaja, veçanërisht revizioniste, në artin dhe letërsinë tonë. Dhe në se në artin dhe letërsinë tonë kemi pasur disa vepra që botën dhe problemet shqiptare nuk i kanë parë me syrin e realizmit socialist, po me syrin e realizmit kritik, apo që kanë pohuar qëndrime humaniste borgjeze kundrejt armikut fashist, nuk mund të themi se kjo ka ardhur pa një ndikim të huaj. Dhe një tolerencë apo një lloj indiferentizmi që ka ekzistuar nganjëherë ndër ne kundrejt veprës së gabuar të ndonjë shoku, ka qenë një nënveftësim i ndikimeve të huaja.

\* \* \*

Detyrë e madhe për letërsinë dhe artin tonë është lufta kundër ideologjisë borgjeze dhe revizioniste në tërë çfaqjet e saj.

Tanimë revizionizmi në letërsi dhe art mund të themi se, në kaq vende, e ka hequr edhe maskën e paturpësisë. Fjalori vetë që përdorin estetët revizionistë, ka nisur të huajë nga fjalori i estetëve gjer klerikalë të borgjezisë. Ata citojnë aq shpesh priftërinjtë apo filosofët katolikë, sa dhe Marksën. Ata janë duke folur me të madhe për «trashendencën» në art dhe duke paragonuar me të madhe me «trashendencën» kristiane. Libri i fundit i Garodisë, që sapo doli nga shtypi, ka nëntitullin: «Një marksist i drejtohet Konqilit». Qëllimi i të quajturit marksist, është «që të ndërtojmë së bashku (me Konqilin, me Vatikanin, — Dh. Sh.) dhe pa prapamendime qytetin e përbashkët dhe të ardhmen e njeriut, i cili të mos jetë i copëtuar nga asnjë dimension i tij». Thirrje Papës për të ndërtuar sëbashku me të «të ardhmen», «pa prapamendim»! Logjika revizioniste «parajsën» shkon e kërkon tamam në Vatikan. Mund të shohim fare mirë pra, se në shërbim të çfarë «të ardhmeje» revizionistët kërkojnë ta vënë artin dhe letërsinë, qoftë kur betohen për «realizmin socialist», si në B.S. sot, qoftë kur trumbejnë «realizmin pa cak», si gjetiu. Romani i fundit i Aragonit, «La mise à mort», mund të na jepte një shembull të ri të këtij «realizmi», me botën gati të halucinuar, që aty paraqitet dhe ku është aq e vështirë të ndjekësh fillin e ngjarjeve, sa edhe fillin e mendimeve. Çoroditja a nuk është një pozitë ideologjike, qoftë edhe e halucinuar? Kritika revizioniste shqyptoi me këtë rast fjalën «individualizëm», veçse kuptimin e kësaj fjale nuk e kërkoi te marksizmi, po të fjalori Larus.

Tani revizionistët janë duke sulmuar përkufizimin e

artit si «pasqyrim të realitetit». Ata pretendojnë se arti nuk është një pasqyrim i thjeshtë i realitetit, me që artisti, në veprën që krijon, bën diçka të re, së cilës i jep vulën personale, vulë pa të cilën art nuk ka. Po kur estetika marksiste-leniniste ka pretenduar ndonjëherë se arti është një pasqyrim i thjeshtë i realitetit? A nuk është ngritur kurdoherë estetika jonë kundër fotografimit të realitetit dhe kundër naturalizmit? Qëllimi është këtu: si idealistë që janë fundi i fundit, këta pseudo-materialistë, revizionistët, duan që faktori objektiv i artit, realiteti që aty pasqyrohet, të quhet sekondar, dhe faktori subjektiv në art, persona krijuese, faktor primar, në mos i vetmi. Dhe këtë nuk e bëjnë me një qëllim të thjeshtë, po që të mund të përlligjin nga pikëpamja «marksiste», se artisti mund të bëjë ç'të dojë me realitetin, se realiteti, me një fjalë, është në mëshirë të artistit. Në se ne thomi që kubizmi dhe abstrakcionizmi janë çfaqje të dekadentizmit borgjez në art dhe një antirealizëm, revizionistët pretendojnë se shpikja e fotografisë e paska bërë gjoja «të kotë» pasqyrimin e realitetit objektiv nga arti i pikturës apo i skulpturës, dhe orvaten të provojnë se kubizmi dhe abstrakcionizmi, me copëtimin apo dizintegrimin e realitetit dhe pastaj me orvatjen për të mos pasur asgjë nga realiteti objektiv në art, duke e shpënë gjer në çfrenim anën subjektive të krijimit artistik, s'kanë bërë gjë tjetër veçse kanë krijuar pikturën apo skulpturën që «kërkonte koha», dhe ky është një «realizëm».

I mërzhitur nga realiteti, artisti individualist borgjez ka arritur në kulmin e qëndrimit anarqik ndaj krijimtarisë artistike. Borgjezia është e kënaqur që arti të bëhet lojë dhe të mos pasqyrojë asgjë, sepse, në kohën tonë, pasqyrimi i realitetit në art mund të bëhet keq i rrezikshëm, qoftë se fytyra e borgjezisë nuk është aspak e bukur për të pasqyruar, qoftë se pasqyrimi i epokës revolucionare është belaja mbi të gjitha.

Revizionistët, duke dashur të nënvleftësojnë faktin se arti është një pasqyrim i realitetit, duan t'i heqin atij karakterin njohës, karakter pa të cilin arti s'mund të ketë asnjë funksion edukues dhe militant progresist, po bëhet një lojë e thjeshtë për të çmërzhitur artistin dhe për të hutuar popullin, për t'i larguar të dy nga lufta shoqërore kundër borgjezisë. Ata janë duke e quajtur artin «punë», sepse arti është edhe një prodhim e një mënyrë të prodhuari. Po ky përkufizim është i pamjaftueshëm, tamam sepse kërkon, — në gojë të antimarksistëve veçanërisht, — të mos vihet në pah karakteri thellësisht njohës i artit. Luftohet pra për një art pa brendi dhe për një estetikë që të përlligjë dekadentizmin borgjez. Me përkufizimin e artit si «punë», artin e karakterizojnë kryesisht si një

veprimtari dhe nuk vihet theksi te kuptimi dhe funksionin i kësaj pune. Në fakt, arti dekadent borgjez, piktura dhe skulptura e tij, po edhe muzika (fjala vjen ajo «konkrete») s'janë tjetër veçse tërë një veprimtari e çoroditur, një e ashtuquajtur «punë», e cila, në dukje, nuk i vë ndonjë qëllim të madh vetes, po vetëm të bubisë njerzit. Arti dekadent borgjez ra në duart e marifetçinjve zakonisht pa zanat. Borgjezia mbetet shtang përpara «punës» së tyre, revizionistët përpiqen të bëhen teoricienët e kësaj «punë».

\* \* \*

Asnjëherë më shumë se këto vjet, borgjezia nuk i ka provuar më mirë aftësitë e propagandës së vet dhe dividentët që mund të nxjerrë edhe nga mendimi estetik dhe arti. Po edhe ne kemi pasur rastin si asnjëherë tjetër të njohim rrezikun e propagandës armike, veçanërisht edhe në fushën e mendimit estetik dhe artit. Dhe të bëjmë edhe më mirë tonin mësimin e madh të Partisë për luftën e parreshtur që duhet të zhvillojmë kundër ideologjisë së huaj.

Borgjezia rron me tregëtinë, me tregëtinë edhe të mendimit dhe artit. Ajo përpiqet që gjithëcka prodhon, të kalojë si më e mira nga gjithëcka prodhohet në botë. Kur është fjala për popujt e vegjël, ku letërsia dhe arti nuk janë sa duhet të zhvilluar, kuptohet se malli borgjez do të nisët me predispozitën se e ka më lehtë të shitet. Kjo është e kuptueshme dhe kjo ngjet shpesh. Po ne jemi një vend socialist, që kemi artin tonë shqiptar të realizmit socialist dhe mendimin tonë estetik, që është estetika marksiste-leniniste.

Estetika marksiste-leniniste mbron parimin se arti i një kombi nuk mund të zhvillohet në mënyrë vërtet origjinale, po të braktisë karakterin e tij kombëtar.

Një nga vetijat themelore që e dallon letërsinë dhe artin tonë të realizmit socialist, thuhet në **Raportin** e Byrosë Politike të K. Q. të Partisë është edhe «**fryma e shëndoshë kombëtare**». Dhe kjo është një nga meritat më të mëdha të shkrimtarëve dhe artistëve tanë në punën e tyre të dy dekadave që shkuan: se ata ditën ta bëjnë realitet fjalën e Leninit, që arti i vërtetë i një vendi nuk mund të krijohet veçse duke u bazuar në traditën kombëtare, pa harruar natyrisht edhe traditën ndërkombëtare. Partia jonë e dënoi me kohë denigrimin e kulturës kombëtare prej veglave të titizmit kozmopolit, kurse, nga ana tjetër, ajo kishte dënuar gjunjëzimin ndaj kulturës perëndimore, që të çonte domosdo në kozmopolitizëm. Luftën kundër sektarizmit dhe kundër oportunitizmit në fushën e kulturës dhe të artit, Partia

jonë e ka mbajtur që në krye të herës dhe kjo që një fitore historike, që e vuri kulturën dhe artin tonë në rrugën e madhe të treguar nga Lenini. Vlerësimi i gjithanshëm i traditave që është bërë në Shqipëri këto 21 vjet, këtë dëshmon. Këtë dëshmon ngritja e letërsisë dhe arteve tona socialiste.

Kështu letërsia dhe artet tona nuk janë të çdo vendi dhe kohe, po të një vendi dhe kohe të caktuar: ato janë letërsi dhe arte shqiptare, të Shqipërisë socialiste, — janë socialiste nga përmbajtja dhe kombëtare nga forma. Kjo nuk është një çështje e thjeshtë për zhvillimin e letërsisë dhe artit tonë, si dhe për zhvillimin e mendimit estetik ndër ne. Këtu lidhen e zgjidhen disa nga problemet më të rëndësishme të letërsisë dhe arteve tona. Le të marrim, ndër të tjera, një shembull nga muzika.

Në Raportin e Byrosë Politike të K. Q. të Partisë thuhet se «çështja e bazës kombëtare të muzikës sonë në përgjithësi, të një baze kombëtare në kushtet e reja të ndërtimit socialist, është në radhë të parë çështja e brendisë socialiste të artit tonë muzikor». Pra, së pari, çështja e formës kombëtare nuk është vetëm një çështje forme, po është edhe vetë çështja e brendisë socialiste të artit. Kur ne kemi ngritur zërin kundër folklorizmit, që është vënë re disa herë në muzikë, s'e kemi pasur thjeshtësisht me një imitim pak a shumë formal të muzikës sonë tradicionale, po e kemi ngritur zërin veçanërisht edhe se, duke imituar në të tillë mënyrë muzikën tonë tradicionale, duke rënë në folklorizëm, ne kemi sjellë në muzikën tonë të re një brendi të vjetër, e cila nuk i përshtatet kohës sonë. Do të ishte njësoj sikur në letërsi, duke përdorur vargjet dhe mjetet e ndryshme popullore, ne t'i mbushnim ato edhe me orët e zranat, tamam kur flasim për bujqit tanë të rinj kooperativistë. Dhe në fakt, kemi një folklorizëm të tillë në disa krijime poetike, sidomos amatore, ku nuk mungon një idilizim anakronik i fshatit të ri shqiptar. Kujtoni posaçërisht tekstet e disa këngëve.

Ndërsa, nga njëra anë, ne nuk jemi për një imitim qorr të traditës dhe për qëndrimin tek tradita, nga ana tjetër ne jemi për marrjen e eksperiencës ndërkombëtare, përmes veprave dhe shkollave të mëdha të artit dhe letërsisë që ka njohur njerëzimi.

Kultura botërore nuk është e mbyllur. Rezultatet e çmuara të saj u përkasin gjithë popujve. Dhe kur përkthejmë shqip Homerin apo Danten, Balzakun apo Tolstoin, kur vemë në skenë Verdin apo Bizënë, Çajkovskin apo Smetanën, ne tregojmë se arti i madh botëror i përket edhe shqiptarit, i cili di ta çmojë atë dhe di ta bëjë mjet për të pasuruar kulturën e tij. Veç jemi ne që zgjedhim nga arti botëror, duke ditur se ç'i duhet më së pari popullit

tonë, çfarë mund të shartohet më mirë me traditën tonë. Ky nuk është dhe nuk duhet të jetë një utilitarizëm vulgar, dhe as është e duhet të përfundojë në një çfaqje sektarizmi, po është një domosdo që vjen prej kushteve dhe çastit historik ku jetojmë, si ndërtonjës të socializmit dhe krijonjës të artit të realizmit socialist.

Le të marrim edhe një shembull tjetër nga muzika. Për të krijuar operën tonë të re, ku do ta merrnim ne eksperiencën? A do të rrëmbeheshim pas operës së çëçitit të fundit që i servirin borgjezisë evropiane artistët në shërbim të saj, apo do të drejtoheshim tek eksperiencia e madhe e operës klasike dhe tek ata që këtë eksperiencë pozitive e shpunë përpara edhe në shekullin tonë? Rruga për ne ishte e qartë dhe ne e zgjodhëm drejt atë rrugë, kur u ndikuam nga eksperiencia klasike botërore dhe nga ajo sovjetike. Po duke e marrë këtë eksperiencë, ne kemi bërë në të njëjtën kohë edhe një përpjekje serioze për të vënë në bazën e muzikës sonë operistike muzikën tonë tradicionale dhe për të trajtuar në këtë gjini jetën tonë shqiptare të djeshme dhe të sotme. Kështu ne kemi bërë një përpjekje të parë për një operë shqiptare, e cila të jetë vërtet origjinale, të ketë tiparet tona kombëtare të muzikës dhe t'i përshtatet kohës në të cilën kjo operë krijohet. Është një shembull i qartë i krijimit të muzikës sonë të realizmit socialist.

Le të përmendim edhe një shembull negativ. Kur dënuam sentimentalizmin bajat, që merrnim nga muzika e lehtë evropiane e viteve '30 disa këngë tonat, ne deshëm që, në muzikën e lehtë shqiptare, bashkë me eksperiencën e format e huaja, të mos hyjë edhe një brendi që është në kundërshtim me botëkuptimin dhe shijen e njeriut të ri shqiptar ndërtonjës të socializmit. Po kështu edhe me histerizmat e muzikës së lehtë të sotme të perëndimit, të cilat s'kanë gjë të përbashkët me vrullin e jetës së kohëve moderne, po me modën e fundit të të gulçiturit të borgjezisë.

Të mbështeturit në traditën kombëtare dhe në atë ndërkombëtare, për ne s'ka qenë një çështje e thjeshtë, po një mënyrë e thellë e ndërtimit të kulturës dhe artit. Letërsia dhe artet tona kanë merita të mëdha në këtë drejtim. Ne kemi përfituar shumë nga eksperiencia sovjetike e ndërtimit të një arti dhe letërsie të realizmit socialist. Po ne kemi ditur gjithashtu të vëmë mirë në zbatim porosinë e Partisë, që eksperiencën sovjetike ta bluajmë, të dimë ta bëjmë tonën, ashtu si ç'bëri vetë Partia për të përfituar nga eksperiencia sovjetike në çdo fushë tjetër të ndërtimit socialist. Ne vepruam kështu në mënyrë krijonjëse. Dhe tamam kjo bëri që letërsia dhe arti ynë të ecin përpara me vrull dhe të ruajmë e të zhvillojmë drejt tipa-

ret origjinale të një arti dhe letërsie shqiptare të realizmit socialist. Veprat shabllone, edhe në se ekzistojnë, — çdo gjë nuk vete si në katër rrota në marrjen e eksperiencës së huaj, — ato vepra koha i harron shpejt ose vonë.

Ne, me të drejtë, thomi se arti dhe letërsia jonë këto dy dekada që kaluan, u treguan novatore. Novatorizmi i tyre qëndroi në radhë të parë, pa dyshim, në brendinë e re socialiste që hyri në artin dhe letërsinë tonë. Dhe kështu mund të dallosh në mënyrë të qartë Migjenin prej Ll. Siliqit, Postolin prej Gjatës, Mion prej Zajmit, Konon e «**Kroit të fshatit tonë**» prej Konos së «**Marshit partizan**», Paskalin e «**Ushtarit të panjohur**» nga Paskali i «**Vojo Kushit**». Po, sigurisht, ka diçka të përbashkët midis «**Ushtarit të panjohur**» dhe «**Vojo Kushit**», është e njëjta pamje fatose; e megjithatë, po të vështrosh më me kujdes, do të zbulosh se tek i pari ke një njeri të kohëve të kaluara, i cili përtërihet, zhvillohet dhe shkon më tej tek i dyti, që është fatosi i ditëve tona. Tradita dhe e reja janë në lidhje dialektike, e reja është një vazhdë e së vjetrës, po dhe një kapërxim i saj. Tamam ashtu si ç'e ka thënë shoku Enver: novatorizmi nuk është çkëputje nga tradita.

Partia e ka ngritur kurdoherë me forcë çështjen e krijimit të një arti dhe letërsie shqiptare të realizmit socialist, që të jenë në vazhdim të traditës së madhe popullore dhe të kultivuar të artit dhe letërsisë sonë të djeshme, nëqoftëse duam të kemi një art dhe letërsi vërtet origjinale, një pasurim të vërtetë të kulturës sonë, nëqoftëse duam që populli ynë të sjellë kontributin e vet në thesarin e kulturës socialiste botërore. **Raporti** i Byrosë Politike të K.Q. të Partisë mbi letërsinë dhe artet e thekson veçanërisht këtë çështje dhe kjo bëhet edhe me një qëllim tjetër, që është binjak i të parit: duke krijuar një letërsi dhe art tipik shqiptar, kozmopolitizmi nuk gjeti shesh të favorshëm në letërsinë dhe artin tonë, të cilët, duke qenë kombëtarë, fituan edhe të drejtën e ndërkombëtarësisë së tyre; duke ndjekur këtë rrugë, edhe në të ardhëmen, ne do të jemi të aftë të luftojmë kundër kozmopolitizmit në letërsi dhe art, d.m.th. të luftojmë ndikimet e huaja të dëmshme, të vijojmë edhe më me forcë luftën kundër artit dekadent borgjez dhe bishtit të tij revizionist. „

Nëqoftëse themi që arti dhe letërsia jonë duhet të mbështeten edhe sot e kësaj dite, edhe nesër, në traditën e tyre popullore dhe të kultivuar, këtë çështje nuk duhet ta shohim në mënyrë mekanike, po në tërë kompleksitetin e saj, dhe duhet ta zgjidhim në kushtet konkrete të zhvillimit të artit dhe letërsisë sonë në çastin historik të dhënë.

Së pari, mendoj se nuk duhet të harrojmë që në këto dy dekada, ose më mirë që nga Lufta nacional-çlirimtare e

këndeje, në Shqipëri u krijua një traditë e re dhe shumë e pasur, popullore dhe e kultivuar, në letërsinë dhe artin tonë. Kjo është tradita më e përparuar që u krijua ndonjëherë në Shqipëri në fushën e artit e të letërsisë. Po qëllon, — dhe ka qëlluar edhe tek ne, — që disa përfaqësues të brezave të reja të artistëve dhe letrarëve, duke dashur të sjellin diçka të re, të cilën pa tjetër duhet ta sjellin, në se do të përlligjin vetë qenien e tyre si artistë dhe letrarë, ata qëllon t'ia kundërvënë krijimtarinë e tyre krijimtarisë së djeshme, në mënyrë që ajo të mos paraqitet si një kapërxim dialektik, po si një mohim radikal i krijimtarisë së djeshme. Është e sigurtë se, nëqoftëqë kemi krijuar diçka me vlerë, këtë e kemi bërë vetëm si vazhdues më të përparuar të një tradite që gjetëm dhe jo duke prerë marrëdhëniet me traditën. Eksperiencia e këtyre dy dekadave në rrugën e realizmit socialist, është një eksperiencë shumë e çmuar për hovin e ri që duhet të bëjnë paskëtaj letërsia dhe arti ynë i ri. Në se ne mund të themi se një etapë e re dhe e shkëlqyer po çelet sot në historinë e realizmit socialist në Shqipëri, një etapë e parë e shkëlqyer duhet të themi se ishte edhe kjo që sapo kaluam. Kjo qe etapa e sulmit të parë të madh për artin dhe letërsinë e re shqiptare.

Kur është fjala për t'u mbështetur në letërsinë dhe artin tonë popullor dhe klasik, mund të bëhet pyetja se ç'mund të përfitojmë akoma prej tyre, tanimë që kemi kapërxyer plotësisht në rrugën e realizmit socialist. Pasuria jonë letrare dhe artistike e së kaluarës, popullore ose e kultivuar, për vetë faktin që në të është pasqyruar jeta shqiptare e kohëve të ndryshme, aspiratat, botëkuptimi, ngjarjet e mëdha të historisë, hallet e gëzimet e përditëshme, dufi poetik i shqiptarit, vetë gjuha e tij me pasuritë e saj të pashterëshme, mjete artistike të tij, që u krijuan nga breza të tëra artistësh anonimë ose të njohur, këto dhe të tjera, mbeten thesare ku letërsia dhe arti i çdo kohe dhe i çdo epoke mund dhe duhet të përfitojnë. Le të mos harrojmë asnjëherë Gorkin se si fliste për letërsinë popullore, si për burimin e madh tek i cili duhet të drejtohem kurdoherë.

Sot kur populli ka marrë fuqinë në dorë dhe kur masat e gjera kanë et për fjalën e bukur, duan të zhvillojnë shijen muzikore, pëlqejnë të kenë një pikturë ose të ndalen para një statuje, letërsia dhe arti edhe më shumë duhet të përfitojnë nga mjetet kombëtare të shprehjes artistike, që të mund të bëhen më komunikojëse për masat. Kjo sigurisht nuk do të thotë të bjerë artisti dhe letrari në folklorizëm apo në përsëritje të klasikëve, të përdorë mekanikisht mjetet kombëtare të shprehjes artistike. Arti i vërtetë është i papërsëritshëm. Prandaj artisti duhet të dijë të

ngrihet më lart se tradita e trashëguar dhe të krijojë traditën që do të lërë trashëgim, duhet të dijë ta luajë si krijonjës rolin e tij. Kështu arti do të rritet bashkë me kohën dhe masat popullore do të rriten shpirtërisht bashkë me të, do të zhvillojnë ndjenjat e tyre estetike dhe do të edukohen e formohen si njerëz të kohëve të reja për kohë edhe më të reja.

\* \* \*

Ne jemi në një fazë të jetës sonë kombëtare, kur ndërtimi i bazave të socializmit mori fund dhe kur ecim drejt ndërtimit të plotë të socializmit, duke u mbështetur së pari në forcat tona, kur në atdheun tonë janë krijuar mundësi të mëdha për një hov të ri e të gjithanshëm në zhvillimin e jetës materiale dhe kulturele. «Thirrja» që i bënë atypari Partia dhe Qeveria popullit, për Planin e IV pesëvjeçar, që do të nisë mot, është një dokument i madh, në të cilin tregohet se si, me rritjen e kapacitetit dhe të cilësisë së punës në tërë sektorët e jetës, ne kemi mundësi dhe duhet në radhë të parë të mbështetemi për një këcim të ri pesëvjeçar, që do t'i sjellë aq ndryshime jetës sonë.

S'ka dyshim se, gjer tani, ne kemi arritur në letërsi dhe arte rezultate të çmuara në rritjen e sasisë dhe të cilësisë në tërë gjinitë. Shumëzimi dhe zhvillimi i kuadrove, mundësia për të pasur ngaditë kuadro edhe më mirë e më shpejt të përgatitura, e shpjegon këtë. Këtë e shpjegon edhe kërkesa gjithëmonë në rritje e masave të lexonjësve dhe të artdashësve. Këtë e shpjegon edhe konkurrenca, si të thuash, që na bën letërsia e huaj që përkthejmë, arti i huaj që njohim, veçanërisht veprat e klasikëve të letërsisë dhe artit botëror, me të cilat ka nisur të familiarizohet mirë populli ynë. Sot nuk mund të krijosh më çfarëdo dhe sidokudo në Shqipëri. Dhe disa çfaqje neglijimi artistik që kemi njohur e kritikuar, fjala vjen në tekstet për këngë apo në libretet tona, gjendja me të vërtetë e dobët e estradave, për të cilat flitet posaçërisht në **Raportin** e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë mbi letërsinë dhe artet, dobësitë dhe amatorizmi që vihen re akoma në skenat tona profesioniste dhe veçanërisht në emisionet teatrale të Radios, materialet vërtet të dobëta që zënë vend disaherë te gazeta «Drita» dhe në organe të tjera që botojnë letërsi, ngutja për të botuar që shohim jo vetëm te letrarët e rinj, po edhe te disa me eksperiencë, librat e paka dhe shpesh të dobëta që shkruhen për fëmijët, gjithë këto janë të meta që duhet t'i kapërcejmë me punë dhe vëmendje.

A mund të jetë ky pesëvjeçar që vjen ai kur tek ne të marrin fund gjithë çfaqjet e tilla? Kjo nuk më duket e mundëshme. Po që këtë pesëvjeçar që vjen, në frymën e

përgjithëshme të ndërtimit socialist të vendit, ne duhet të bëjmë një punë edhe më të ndieshme për të forcuar mjeshhtërinë artistike, për të ngritur cilësinë e veprave, për të mos lejuar që «halltura» të gjejë vend në skenat dhe shtypin e radion tonë, kjo më duket e mundëshme. Kjo do të bëhet jo vetëm me shembullën përditë e më serioze të anëtarëve dhe kandidatëve të Lidhjes, me një punë më serioze të artistëve dhe trupave profesioniste, po edhe duke mos u inkurajuar financiarisht «halltura», duke mos lejuar që tekste pa farë kuptimi dhe bukurie të bëhen nxitje kompozimi, që lokalet publike dhe vitrinat e dyqaneve të mos mbushen me tablo dhe punime artistike të prodhuara për shkak të një keqkuptimi tregëtar dhe artistik, që librat shkollorë dhe veçanërisht antologjitë për fëmijët të mos mbushen me këndime në prozë e në vargje të krijuara me porosi nga njerëz që s'janë artistë, ose të zgjedhura pa shije, që muzika jonë dhe pjesët tona teatrale të mos luhen në mënyrë të çfarëdoshme, që botimi i një libri t'i ngajë më shumë një evenimenti në jetën e shkrimtarit e bile edhe të vendit, se sa një të kaluar radhe, që një numur gazete apo reviste të ndjehet se qe rezultati i një pune të vëmendëshme, mirë të organizuar, etj, etj.

Qëndrimi serioz ndaj artit është jetësor për artin. Pjekuria që kanë fituar letërsia dhe artet tona, shpjegohen me një punë vërtet serioze të shkrimtarëve dhe artistëve tanë të çqar, po edhe me një ndërgjegje më të madhe të fituar nga kolektivi. Kjo ndërgjegje pune ka nevojë të rritet edhe më shumë. Vepra si «**Lumi i vdekur**», nuk mund të shkruhen pa një punë këmbëngulëse. Dhe rezultate si ai i koreografisë së baletit «**Halili dhe Hajria**» nuk mund të arrihen pa një punë të tillë të koreografit dhe të trupës. Sa keq na vjen ne kur vëmë re se prapa talentit, s'qëndron edhe durimi për një stil dhe gjuhë më të punuar, për një ndërtim më të pjekur dhe harmonik, për një varg dhe strofë vërtet të kalitur. Romane dhe vepra të ndryshme poetike vuajnë jo nga mungesa e talentit dhe e frymëzimit, po nga mungesa e një pune të kujdesëshme dhe të mbaruar. Po në qoftëse veprave tona të djeshme u falej disi ngutja, sepse në vitrinat e librarive tona dukeshin ende fort pak libra origjinale, sot kjo ngutje përlligjet me zor, kurse nesër ajo ka për të qenë e pafalëshme.

Problem nga më të vështirët në punën e shkrimtarëve, më duket se mbetet gjer më sot problemi i gjuhës. Rruga e njëzimit që mori shqipja në të dy dialektet e saj, ka shkuar përpara shumë. Ortografia e gegërishtes dhe e toskërishtes janë afruar gati në maksimum, kurse trajtat morfologjike që përdorin të dy dialektet me shkrim kanë arritur gjithashtu një afrim të madh. Po në se nuk janë të lejueshme luhatjet ortografike aq të tepëruara që vihen re midis nje-

rëzve tanë të pendës, gjithaq të palejueshme mendoj se janë edhe trajtat nëndialektore që nuk i qas më gjuha e shkrimit. Si mund të shkruajmë sot gegërisht, «unë **mujta** me ardhë», dhe toskërisht, «u **bëti** kjo punë»? ( E kam fjalën për gjuhën e auktorit dhe jo të personazheve). Shkrimtarët duhet të mendohen seriozisht kur marrin përsipër ta pasurojnë gjuhën me anë të dialekteve dhe nëndialekteve nga ata vinë, dhe jo të shkruajnë si flasin në shtëpi. Pasurimi i gjuhës letrare me anë të dialekteve dhe nëndialekteve mbetet një detyrë e madhe, veçanërisht në fazën e tanishme të zhvillimit të shqipes. Ky pasurim bëhet kryesisht me anë të fjalorit. Po a thua se mund të pasurohet fjalori i shqipes së shkruar, nëqoftëse ne zëvendësojmë në mënyrë të prerë në veprat tona fjalë si «pëshpërita» apo «mërmërita» me një fjalë si «mëlmita»? Futja e kësaj fjale pak të njohur në gjuhën e shkrimit, është një pasurim; po nxjerrja pa arësye nga gjuha e shkrimit e fjalëve «mërmërita» ose «pëshpërita», zëvendësimi radikal i tyre, është një varfërim. Këtu e pëson në radhë të parë vetë stili i auktorit, i cili merr një ngjyrë të panevojëshme dialektore. Një shkrimtar si Sh. Musaraj, më duket se, me ndihën e zhvilluar të gjuhës, gjen zakonisht se ç'duhet të sjellë nga dialekti, kurse gjuha e J. Xoxës, e një pasurie jo të zakonshme, mendoj se stilin e tij e ngarkon dhe i jep një ngjyrë jo sa duhet të sotme.

Sigurisht edhe piktorët kanë një problem jo të vogël gjuhe, kur është fjala të zbulojnë ngjyrat më të cilat arti i tyre të jetë më pranë popullit. Njohja e dekorimit popullor, studimi i tij në shkollë dhe studimi shkencor i tij, kujtoj se do të ishte një rrugë drejt zbulimit të mjeteve pikturore dhe të disa mjeteve të tjera artistike të plastikës sonë të trashëguar, që duhet të bëjë të sajat piktura jonë e re. Në **Raportin** e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë përmendet veçanërisht «**kërkesa që piktura të afrohet edhe më shumë me masat**», si «**një nga detyrat më të rëndësishme e më të vështira që dalin para artit tonë figurativ**». Aty bëhet thirrje që në pikturë «**të marrin zhvillim më të madh tablotë kompozicionale**». Kuptohet se kjo kërkon një punë të veçantë për ngritjen e mjeshtërisë artistike. Puna e gjertanishme në këtë drejtim dhe puna që po bëhet nga Instituti i Lartë i Arteve Figurative, e lejon zhvillimin e hovshëm të tablosë kompozicionale tek ne. Duke qenë kryesisht gjini narrative dhe objekt muzeu ose lokalesh të mëdha shtetërore e publike, tabloja kompozicionale është edhe një nga gjinitë më të afërta për popullin. Me anë të riprodhimeve, ajo shumëzohet dhe mund të bëhet e të gjithëve. Mendimi im është se, për ta afuar edhe më shumë popullin nga piktura, do të ishte me vend të përpiqemi të zhvillojmë në mënyrë më të gjerë edhe grafikën, e cila, më lehtë se as-

një tjetër gjini e artit plastik, mund të hyjë në çdo kënd të jetës dhe në çdo shtëpi. Kjo nuk do të thotë që të lëmë pas dore gjinitë e tjera.

Trajtimi i gjinive është një problem jo vetëm i zhvillimit të artit pra, po edhe i afrimit sa më të madh të artit me popullin, një çështje, si të thuash, e gjuhës artistike, duke qenë një çështje komunikimi me masat.

Kur flasim për komunikimin e artit me popullin, nuk duhet të harrojmë asnjëherë porosinë e Partisë dhe veçanërisht të shokut Enver, që arti të jetë i thjeshtë në të kuptuar, që ai t'u flasë masave në mënyrën më të drejtpërdrejtë e më të çiltër, duke trajtuar megjithatë problemet e mendimet më të mëdha të jetës sonë dhe jo duke u marrë me cikërima. Ka qenë kurdoherë një vetijë e artit qartësia e tij dhe kështu ka për të qenë dhe në të ardhëmen.

\* \* \*

Më lejoni tani të ndalem, në problemin më të rëndësishëm që ngrihet në **Raportin** e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë mbi letërsinë dhe artet.

«**Pasqyrimi më i gjerë e më i thellë i luftës, i jetës dhe i punës së popullit, i idealeve dhe aspiratave të tij, i aktualitetit, është problemi kryesor që duhet të tërheqë vëmendjen e shkrimtarëve dhe artistëve tanë**», theksohet në atë **Raport**. Aty tregohet se ç'kuptojmë ne me temë aktuale, duke u vënë në dukje se edhe tema e Luftës nacional-çlirimtare ka qenë dhe mbetet aktuale për ne. Duke treguar dhe çmuar se si letërsia dhe arti ynë i ri u bënë plotësisht një letërsi dhe art i realizmit socialist, sepse trajtuan problemet e mëdha të jetës sonë shqiptare, sepse pasqyruan ndër të tjera Luftën nacional-çlirimtare dhe transformimet revolucionare që ngjanë në Shqipëri me ndërtimin socialist të vendit, Partia vë në dukje se, «**me gjithë këtë, nuk mund të thuhet se letërsia dhe artet e kanë kryer plotësisht detyrën e tyre për pasqyrimin e aktualitetit dhe sidomos të realitetit të ditëve tona**», se «**ndërtimi i socializmit, problemet e mëdha e të rëndësishme që kanë preokupuar e preokupojnë masat punonjëse për ngritjen e jetës së re, me gjithë disa rezultate që janë arritur në disa gjini të arteve e veçanërisht në artet figurative, nuk e kanë zënë akoma vendin e merituar në letërsi dhe arte**». Kështu, fjala vjen, njeriu i punës, zë akoma një vend të vogël në krijimtarinë tonë, kurse «**kjo duhet të jetë temë themelore, kryesore e arteve dhe letërsisë që militojnë për ndërtimin e socializmit**».

Njeriu i ri shqiptar ia ka ndërruar faqen atdheut, duke treguar cilësi të larta si punëtor në transformimet e bujqësisë socialiste, në ngritjen e kaq dhe kaq industrive të reja, në një mori racionalizimesh që treguan kulturën e gjerë

teknike dhe teorike të fituar nga punëtori ynë, në projektimin së fundit të disa fabrikave dhe hidrocentraleve, etj.

Puna është bërë faktori i madh transformonjës i njeriut në çdo fushë të veprimtarisë shoqërore; bukuria e punës, heroika e saj, frymëzimi që buron prej saj për masat popullore, duhet të bëhet objekt i madh frymëzimi i letërsisë dhe artit tonë në dekadat që vinë. Të gjithë ne e kuptojmë se hovi i ri që do ta karakterizojë letërsinë dhe artin tonë pas Plenumit historik të K.Q. të Partisë mbi letërsinë dhe artet, ka për të ardhur, së pari, me «pasqyrimin e plotë dhe në aspektet e saj më tipike» të temës së punës.

**Raporti** i Byrosë Politike të K.Q. të Partisë flet veçanërisht mbi Plenumin e Korrikut të K.Q. të Partisë, lidhur me edukimin e masave, mbi «luftën kundër mbeturinave dhe çfaqjeve të huaja, kundër zakoneve e traditave konservatore, kundër çdo ndikimi të ideologjisë borgjeze dhe revizioniste» dhe mbi rolin që duhet të lozin letërsia dhe arti në këtë luftë. Në **Raport** flitet veçanërisht edhe për pasqyrimin e jetës së fshatit tonë të ri, «për ndjekjen e procesit që zhvillohet jo vetvetiu, por në luftë kundër pengesave e vështirësive të shumta, kundër forcës së zakonit dhe traditës».

Këto shembulla dhe të tjera që mund të merreshin, tregojnë së pari se çfarë rëndësie ka për letërsinë dhe artin tonë pasqyrimi i jetës aktuale të popullit, se si në këtë mënyrë letërsia dhe arti do ta lozin më plotësisht rolin e tyre edukonjës për kalitjen e njeriut të ri, se si ato, si ç'është e natyrëshme për çdo letërsi dhe art progresist dhe revolucionar, do të jenë më plotësisht përfaqësuese të kohës që i lindi, do ta pasqyrojnë këtë kohë dhe do të dëshmojnë për të ndër shekuj, dhe kështu do të sjellin çka mund të sjellin vërtet të re në historinë e kulturës shqiptare. Nga ana tjetër, ato shembulla dhe të tjera si ato, tregojnë se çfarë rëndësie i jep Partia pasqyrimin të realitetit me vërtetësinë më të madhe historike, thellimit të realitetit në letërsinë dhe artin tonë socialist. Këtë kërkon vetë çasti historik i zhvillimit të letërsisë dhe arteve tona, si ç'e pamë më lart, dhe ja se në çfarë drejtimi na orienton Partia për të zbatuar këtë detyrë historike, — të jemi plotësisht të kohës.

Plani i ri pesëvjeçar i ndërtimit të ekonomisë dhe kulturës sonë socialiste, mund dhe duhet të bëhet një mbështetje e madhe e një burim i madh frymëzimi për hovin e ri që pritet nga arti dhe letërsia jonë. Mënyra me të cilën është pritur dhe diskutuar nga punonjësit «Thirrja» e K.Q. të Partisë dhe e Qeverisë për Planin IV pesëvjeçar, tregon se çfarë entuziazmi i rrallë i frymëzon masat për të ardhmen që ato do të ndërtojnë, me çfarë kompetence, ndërgjegje të lartë detyre, patriotizmi dhe shpirti revolucionar ato

mendojnë për të ardhmen e atdheut. Letërsia dhe arti kanë aty një burim të pashtershëm.

Kështu, arti dhe letërsia, duke u zhvilluar në mënyrë të gjithanëshme e duke u thelluar sa më shumë në jetën e re, do të lozin plotësisht rolin e tyre në funksion të ndërtimit socialist, do të jenë në ballë të luftës ideologjike për kalitjen e njeriut të ri dhe mbrojtjen e fitoreve të revolucionit. Kështu do të zhvillohet edhe më tej karakteri kombëtar i letërsisë dhe artit që ne krijojmë, dhe ky do të jetë edhe kontributi e roli që i përket letërsisë dhe artit tonë në fushën ndërkombëtare, si pasqyra të vërteta të jetës së një vendi socialist në ndërtim.

**Raporti** i Byrosë Politike të K.Q. të Partisë vë gishtin mbi disa dobësi të letërsisë dhe artit tonë në trajtimin e temës së re, dhe këto janë së pari «mosnjohja e thellë e jetës dhe e proceseve të zhvillimit të saj», «moskapja e asaj që është kryesore në procesin e zhvillimit të jetës, sidomos të dallimit të asaj që është e re dhe që përfaqëson tendencën përparimtare të fenomeneve». Shpejtësia me anë të së cilës zhvillohet jeta dhe shtjellohen fenomenet e reja gjatë ndërtimit socialist, nuk duhet me asnjëfarë mënyre ta huttojë apo ta çkurajojë artistin, të bëjë që të lindin përlligje, sipas të cilave e tashmeja nuk mund të kapet dhe duhet të kalojë një kohë pa ajo të bëhet objekt për artin. Pikëpamje të tilla, që mund t'i kemi dëgjuar ndonjëherë edhe midis nesh, janë në kundërshtim me praktikën shekullore të artit botëror dhe të atij shqiptar, dhe veçanërisht me praktikën e realizmit socialist. Shembulli i letërsisë shqipe të Rilindjes, që jep **Raporti** i Byrosë Politike të K.Q. të Partisë, duke treguar se si ajo letërsi u vu në shërbim të problemeve të mëdha të kohës në Shqipëri, është një shembull i shkëlqyer. Në **Raport** përcaktohet në mënyrë shkencore, se si «kalimi i letërsisë sonë nga pozitë romantike përparimtare e demokratike në pozitë realiste», u bë «nën ndikimin e fortë të trajtimit të temës aktuale», ç'prej Naimit të Migjeni. Dhe aty zbulohet pikëpamja antimarksiste e revizionistëve modernë, që përpiqen ta çkëputin artin nga lufta aktive politike, që predikojnë «pavarësinë» e tij nga kjo luftë, që përpiqen ta fshehin pozitën klasore të artit dhe flasin për një «art mbiklasor».

Vendi që kanë zënë disa herë në letërsinë tonë të këtyre viteve të fundit temat e vogla, të para shpesh nga një kënd shumë i ngushtë, ja një e metë që ne e kemi shënuar me kohë në mbledhjet e në kritikën tonë. Ky është një fakt ndër të tjerë i moskapjes sa duhet të problemeve thelbësore të jetës sonë në letërsi.

Partia na tregon si gjithëherët, se «në qëndër të vëmendjes së letërsisë dhe arteve tona duhet të jenë heronjtë e kohës sonë» dhe se në këtë drejtim ne jemi akoma shumë

borxh. Komunisti dhe partizani që shembën regjimin e feudo-borgjezisë, ndërtonjësit e socializmit që e bënë Shqipërinë një vend të përparuar, janë krijesat më tipike të kohës sonë, pa të cilat transformimet revolucionare të Shqipërisë së re nuk mund të ngjanin, pra edhe s'mund të kuptohen, me mungesën e të cilave nuk do të mund të shkruhej asnjë faqe e historisë së popullit tonë këtë çerek shekulli dhe nuk do të kishte një art dhe letërsi të kësaj kohe. Dhe arti e letërsia jonë janë dhe do të zhvillohen si art dhe letërsi realiste tamam sepse paraqitin realitetin si ç'është. Pa dyshim, në realitetin shqiptar të këtij çerek shekulli nuk kanë munguar as feudalët, as borgjezët, as ballistët, diversantët, antimarksistët e ngjyrave të ndryshme; po se mos janë këta që i kanë dhënë vulën historisë sonë të këtij çerek shekulli? Ata nuk kanë munguar të bëhen objekt i artit dhe letërsisë, po tamam për t'u treguar falimentin e tyre historik dhe për t'u treguar se si ky faliment nuk erdhi prej vetiu, po sepse heronj të rinj lindi koha, që morën në dorë fatet e kombit, sepse Partia jonë u bë protagoniste e jetës së re të popullit me forcën e marksizëm-leninizmit, me forcën e njohjes së proceseve historike që u zhvilluan e po zhvillohen në gjirin e shoqërisë shqiptare. Ja përse njeriu i ri, si dhe fenomenet e reja të shoqërisë sonë, janë vënë dhe duhet të vihen edhe më plotësisht në epiqëndër të krijimtarisë sonë letrare dhe artistike.

Njeriu i ri është njeri i gjallë e që zhvillohet, që kapërxen vetveten duke u përmirësuar, duke fituar më shumë eksperiencë revolucionare, më shumë kulturë, më shumë teknikë. Hiperbolizimi i tij disa herë në art nuk është një gjë e re që solli realizmi socialist, po një gjë esencialisht realiste për çdo metodë letrare dhe artistike. Skënderbeu u bë legjendar dhe arti s'ka se si të mos e shohë edhe përmes hiperbolës. Trimërive të tij, koha u dha atë bukurinë e patinën e saj, bukuri të cilën arti e zhvillon, e rrit. Po nuk është fjala që letërsia dhe arti ynë të zhvillohen përmes hiperbolës. Kur ne flasim për heroin pozitiv, nuk flasim për skematizimin dhe ilustrimin e realitetit përmes skalitjes së njeriut të ri, po për vënien në dukje të tipareve madhështore të heroit të epokës sonë. Në fakt, kur kemi ditur ta japim me vërtetësi luftën e tij për të renë, luftë epike nga më se një anë, ne kemi ditur të jemi edhe realistë. Po kjo lidhet edhe me mundësitë e një letërsie e arti, dhe niveli i përgjithëshëm i letërsisë e artit tonë, ndonëse shumë më i ngritur se dje, mbetet mesatar; prandaj edhe duhet ta ngrejmë akoma më shumë këtë nivel. Kjo lidhet edhe me shkallën e zhvillimit të tendencës realiste të një letërsie dhe arti, dhe eksperiencia jonë kombëtare në këtë drejtim është akoma e re; prandaj duhet të bëhemi njohës edhe më të thellë të realitetit. Kjo lidhet edhe me talentin, dhe

veprat e mëdha të talentuara nuk janë ato që bëjnë shumicën në letërsinë dhe artin e çdo kohe dhe vendi, po asnjëri nuk duhet të harrojë se talenti zhvillohet me punë dhe ndrydhet me çkëputjen nga jeta.

Ne Partia na ka mësuar që t'i bëjmë luftë të paprerë skematizmit, të mos kënaqemi me pak, të thellohem në proceset e jetës. Shoku Enver Hoxha, duke folur në Plenumin XV të K.Q., vuri në dukje se si shkrimtari dhe artisti duhet të jenë studjonjës të palodhur të jetës, duhet ta njohin jetën në tërë skutat e saj, duhet të dokumentohen mbi gjithëçka pohojnë, duke jetuar me popullin, duke vëzhguar çdo gjë, duke rënuar edhe nëpër arkiva po ta lypë nevoja, pa humbur asnjëherë perspektivën, që u jep njohja e marksizëm-leninizmit. Pra është fjala për një njohje vërtet shkencore të realitetit, në se duam që letërsia dhe arti ynë ta pasqyrojnë atë me vërtetësinë e thellësinë më të plotë.

Skematizimi i jetës dhe i heronjve, kur nuk do të thotë mungesë talenti, mjeshtërie apo frymëzimi, do të thotë gjithëmonë mungesë njohje të realitetit. Njohja e realitetit, nga ana tjetër, na rrit mjeshtërinë, duke na mprehur syun, na rrit frymëzimin, duke na pasuruar mendjen, ajo na ushqen talentin.

Njohja e jetës mbetet detyra themelore e secilit prej nesh. Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve është përpjekur t'i ndihmojë anëtarët e kandidatët e saj, duke u siguruar orare të reduktuara dhe leje krijonjëse, për të pasur më shumë kohë që të studiojnë, të prodhojnë e veçanërisht të jenë në kontakt me jetën e re që zhvillohet. Po mund të themi se akoma pak prej atyre që kanë marrë leje krijonjëse e kanë përdorë këtë leje ose një pjesë të saj duke u futur në fabrika e kantiere, duke vajtur në kooperativa e ferma dhe kudo zjen puna ndërtimore. Nga shkrimtarët dhe artistët profesionistë, vetëm ndonjëri e ka bërë këtë. Dhe me shumë të drejtë Komiteti i Partisë i Qytetit të Tiranës ka vënë në dukje se shkrimtarët, që në shumicën dërmuese banojnë në kryeqytet, mbi jetën aq të pasur ndërtonjëse të kryeqytetit s'kanë shkruar, sepse kanë bërë pak që ta njohin nga pranë.

Mbetet detyrë e jona, që ne ta organizojmë të gjithë së bashku, në mënyrat më të ndryshme, kontaktin aktiv me jetën e masave që ndërtojnë socializmin në fshat dhe në qytet. Hovi i ri që duhet të marrin letërsia dhe artet tona, e kërkon pa tjetër këtë. Këtë e lejon shumëzimi dhe zhvillimi i kuadrove dhe eksperiencia që kemi fituar tanimë në fuqinë e krijimtarisë letrare dhe artistike.

\* \* \*

Organizata jonë mbushi këtë vjeshtë 20 vjetorin e saj. Në tetor 1945 u krijua Lidhja e Shkrimtarëve, e para shoqatë e njerëzve të letërsisë në historinë e vendit. Më 1957

ajo u bashkua me Lidhjen e Artistëve, që ishte krijuar më 1952, dhe kështu u themelua Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, që përmledh në gjirin e saj më se 200 anëtarë dhe kandidatë shkrimtarë, kompozitorë, piktorë dhe skulptorë.

Jemi ende një organizatë modeste në numur dhe për detyrat e mëdha që kemi. Po nuk jemi më një organizatë aq e vogël dhe me aq pak njerëz të kualifikuar që ishim në vitet 1945 apo 1952. Shumë talente të reja kanë pasuruar dhe do të pasurojnë me ritme edhe më të shpejta radhët tona. Krijimi i universitetit dhe i instituteve të larta të studimeve artistike, u bënë dhe do të bëhen edhe më shumë në të ardhëmen, një faktor shumë i rëndësishëm për shtimin dhe kualifikimin e kuadrove tona. Zhvillimi e thellimi i gjithanshëm i kulturës rrit jo vetëm numurin e lexuesve dhe të artdashësve, rrit kërkesat për një letërsi dhe art më të cilësuar, po, duke zhvilluar lëvizjen amatore të artit dhe letërsisë, lëvizje që sot është shumë e gjerë, sjell në radhët tona përditë e më shumë talente. Kjo është perspektiva e madhe e shoqatës sonë.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, këto dy dekada, e ka kryer me nder punën e saj delikate dhe të vështirë. Ashtu sikundër thuhet në **Raportin** e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë, shoqata jonë «ka lojtur një rol të shënuar në grumbullimin, mobilizimin dhe edukimin e letrarëve dhe artistëve të vendit tonë, në orientimin dhe përkrahjen që u ka dhënë atyre për realizimin e detyrës së tyre të madhe e fisnike.» Ky vlerësim i anëve pozitive të punës sonë, ne na vlen shumë për një drejtim edhe më të mirë të letërsisë dhe arteve në të ardhëmen. Po ne na vlen gjithaq kritika e punës sonë që është bërë në **Raportin** e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë dhe për të cilën fola më lart në këtë referat. Veprimtaria jonë ka pasur edhe «të meta serioze», thuhet në atë **Raport**, të meta që «shpjegohen, përveç të tjerave, edhe me mungesën e një pune të organizuar mirë në udhëheqjen e kësaj organizate dhe në aparatit e saj.» Kjo kështu ka ndikuar që ne të mos kemi zbuluar me kohë disa të meta ideologjike që janë vënë re në botimet ose në repertoret tona, të mos kemi luftuar sa duhet kundër disa çfaqjeve të huaja që janë vënë re në muzikën tonë të lehtë, etj. E dobët ka qenë puna e Lidhjes për diskutimet letrare dhe artistike, dhe po kështu ka qenë e pamjaftueshme puna e organeve tona të shtypit për rrahjen e problemeve të letërsisë dhe arteve. Unë, si kryetar i kësaj Organizate, ndjej një përgjegjësi të madhe ndaj këtyre të metave dhe premtoj se, bashkë me shokët e mi të Kryesisë dhe të Komitetit Drejtues, me ndihmën e ju të gjithëve, do të bëjmë gjithë përpjekjet që ato të reduktohen dhe të eliminohen.

S'ka asnjë dyshim se, që Lidhja të mund të jetë si dhe sa duhet në krye të detyrave delikate dhe të vështira të saj, ajo ka nevojë të jetë së pari e organizuar më mirë. Një organizim më i mirë i Lidhjes kërkon pa tjetër që jo vetëm sekcionet dhe redaksitë e saj të funksionojnë si duhet, po që anëtarët dhe kandidatët e Lidhjes, cilëtdo qofshin këta, me ose pa përgjegjësi të caktuara, të jenë të gatshëm për të kryer detyrat e tyre ndaj Shoqatës.

Duhet shënuar se ekziston ndër anëtarët dhe kandidatët e Lidhjes një tendencë për të mos qenë të gatshëm ose për t'iu mënjanuar detyrave që kanë ndaj Shoqatës. Më se një herë e kemi pasur zor t'i ngarkojmë shokët, fjala vjen, për një referat apo për një diskutim krijonjës. Sigurisht, këto janë punë që duan kohë dhe që duan një farë kompetence. Dhe tamam ata shokë, të cilët përpiqen t'u shmangen këtyre punëve, kur nuk ngrejnjë arësytën e kohës, ngrejnjë atë të kompetencës. Po ngado që ta shohësh këtë çështje, duhet thënë se nuk është mirë që një pjesë të kohës të mos ua kushtojmë detyrave që kemi ndaj Lidhjes, kurse, pa dyshim, është keq që shokët tanë të mos studiojnë sa duhet dhe ta ndjejnjë veten të përgatitur në mënyrë të pamjaftueshme për të marrë gjallërisht pjesë në punimet e Organizatës. Kështu mund të vesh re se një numur jo i vogël shokësh nuk merr pjesë gjallërisht në punimet tona. Objektivisht ta marrësh, kjo mund të flasë për atë indiferentizëm që përmendet në **Raportin** e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë mbi letërsinë dhe artet, dhe ky indiferentizëm duhet të mos gjejë vend midis nesh.

Organizata jonë ka detyra të mëdha për edukimin ideo-profesional të shkrimtarëve, kompozitorëve, piktorëve dhe skulptorëve dhe, në përgjithësi, për zhvillimin e mendimit estetik në Shqipëri, për gjallërimin e jetës letrare dhe artistike të gjithë vendit. Lidhja ka bërë punë në këto drejtime, po në mund të bënim një punë edhe më të frutëshme nëqoftëse do të mobilizonim sa dhe si duhet gjithë anëtarët dhe kandidatët e Organizatës. Shokët janë treguar zakonisht të gatshëm për të marrë pjesë në mbrëmjet letrare dhe artistike, po, si ç'e thashë më lart, jo për rrahjen e mendimeve dhe diskutimin e veprave.

Është e vërtetë se shkrimtari dhe artisti nuk mund të jetë domosdo edhe një specialist i estetikës, i teorisë apo i historisë letrare dhe artistike, apo një kritik letrar dhe artistik. Po është e vërtetë gjithashtu se shkrimtarët dhe artistët duhet të jenë të pajisur më së miri nga ana ideo-profesionale dhe se ata janë nga më të aftët që mund të rrahin problemet e krijimtarisë së tyre, të çmojnë veprat, si nga brendia ashtu dhe nga forma, të jenë pra të parët që ta gjallërojnë mendimin kritik letrar e artistik dhe jetën let-

rare e artistike të vendit. Ajo që ne kemi bërë në këtë drejtim nuk është e pakë, po prapë mbetet e pamjaftueshme.

E pamjaftueshme mund të themi se është puna që bëjnë një numur i kuadrove tona për ngritjen e tyre ideologjike. Puna personale që bën secili në këtë drejtim është, pa dyshim, puna bazë. Çfarëdo kursesh që të ngriheshin, nuk mund ta zëvendësonin leximin dhe studimin individual. Pa ngritjen ideologjike dhe kulturele, secili prej nesh rrezikon së pari talentin e tij. Shkrimtarët dhe artistët duhet të lakmojnë të jenë në lartësinë e kulturës së kohës, të mos e ndërpresin për asnjë çast vëmendjen ndaj problemeve të mëdha ideologjike që preokupojnë vendin tonë sot, si ç'janë problemet e luftës kundër revizionizmit, problemet e zhvillimit dhe thellimit të revolucionit kultural në tërë sferat, duke nisur nga arësimi, nga lufta për jetë më të kulturuar në fshat, dhe duke vijuar posaçërisht me problemet e shumta dhe aq delikate të vetë krijimtarisë letrare dhe artistike. Vetëm në këtë mënyrë secili prej nesh do të bëhet një militant i vërtetë ideologjik, ashtu sikundër e kërkon epoka jonë, ashtu si ç'na porosit Partia. Nga ana e vet, Lidhja duhet ta gjallërojë punën për diskutimet krijuese, plenumet mbi çështje të ndryshme të krijimtarisë, rrahjen në shtyp të problemeve të letërsisë dhe artit, zhvillimin e luftës kundër armiqve borgjezë dhe revizionistë të realizmit socialist dhe të estetikës marksiste-leniniste.

Ne shokë jemi përpara një jubileu të madh, jubileu i 25 vjetorit të Partisë. Mot do të mbushet plot një çerek shekulli që u themelua Partia jonë e lavdishme nga biri i saj i madh, shoku Enver Hoxha. Në një çerek shekulli, populli shqiptar i udhëhequr nga Partia, ka bërë aq shumë, sa do të ishin dashur shekuj që të bëheshin nën regjimet e së kaluarës. Kjo qe një epope e pashoqe lufte dhe ndërtimi në historinë e Shqipërisë. Shqipëria, vend gati i panjohur dhe shpesh i përbuzur ose i marrë nëpër këmbë në Evropë dhe në botë, u bë një shtet i fortë sovran, me një prestigj që mund t'ia kenë zili në arenën ndërkombëtare, shtet i përparuar socialist, me ritme nga më të lartat në zhvillimin ekonomik e kultural, shembull i gjallë i luftës për lirinë, pamvarësinë dhe progresin shoqëror, kundër imperializmit, kështjellë e patundur e luftës për pastërtinë e marksizëm-leninizmit dhe për idealet komuniste. 25 vjetori i Partisë do të kurorëzojë një çerek shekulli lufte dhe punë heroike.

Ne shkrimtarët dhe artistët jemi shumë të lumtur për kontributin modest që kemi dhënë në ngritjen dhe forcimin e atdheut tonë socialist, duke shtrënguar radhët tona rreth Partisë sonë të dashur dhe duke ndjekur mësimet e saj. Sukseset tona të sotme i kushtohen Partisë, udhëheqjes së urtë dhe largpamëse të saj. Sukseset tona të ardhëshme,

asaj do t'i kushtohen gjithashtu. Ne jemi krenarë që kemi qenë gjer më sot ushtarë besnikë të socializmit, me parti ose pa parti qofshim, dhe kështu do të qëndrojmë krenarë e të gatshëm edhe në të ardhëmen, kudo dhe sido që ta kërkojë koha dhe Partia. Kjo besnikëri, patriotizmi dhe zëlli komunist, është dhe do të jetë në thelb e në themel të veprave tona.

Plenumi i XV i K.Q. të Partisë për çështjet e letërsisë dhe të artit, u mbajt në vigjiljen e 25 vjetorit të Partisë. Në vigjiljen e këtij 25 vjetori, ne jemi të lumtur t'i premtojmë Partisë se do t'i realizojmë detyrat me të cilat na ngarkon ajo në punën tonë për zhvillimin me një hov të ri të letërsisë dhe arteve tona, në Planin IV dhe në planet e tjera pesëvjeçare, për edukimin dhe kalitjen e njeriut të ri në atdheun tonë socialist. Ne jemi të ndërgjegjshëm të këtyre detyrave historike dhe unë jam i bindur se i kemi forcat për t'i kryer edhe një herë me nder detyrat tona ndaj Partisë dhe popullit. Konkursi i madh që ka shpallur Qeveria në fushën e letërsisë dhe arteve, me rastin e 25 vjetorit të themelimit të Partisë, ka për të qenë prova e parë e përpjekjes sonë për t'i vënë në jetë detyrat me të cilat na ngarkon Plenumi XV i K.Q. Unë jam i bindur dhe uroj me gjithë zemër që këtë provë të parë të madhe ne ta kalojmë me suksesin më të plotë. Konkursi është bërë që tani një mjet i fortë nxitje dhe frymëzimi për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve tona.

Plenumi XV i K.Q. të Partisë koïncidoi me 20 vjetorin e themelimit të Shoqatës sonë. Çmimi i veçantë që iu bë në atë plenum punës sonë, nderi me të cilin po e gëzon sot punën e Lidhjes Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës, janë sigurisht për ne ndere të mëdha. Ne falënderojmë edhe një herë Partinë me këtë rast, falënderojmë Presidiumin e Kuvendit Popullor, dhe u premtojmë atyre se do të vëmë të gjitha forcat tona për t'i shpënë edhe më me vrull përpara letërsinë dhe artet tona të realizmit socialist.

Rroftë letërsia dhe arti shqiptar i realizmit socialist!

Lavdi marksizëm-leninizmit triumfonjës!

Rroftë K.Q. i Partisë së Punës të Shqipërisë, i udhëhequr nga shoku ynë i madh Enver Hoxha!

**DH. S. SHUTERIQI**

28.XI.1965

## Nga diskutimet në plenum

Shkrimtarë dhe artistë të ndryshëm morën fjalën në plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Me diskutimet e tyre ata plotësuan referatin kryesor të mbajtur nga shoku Dhimitër S. Shuteriqi. Ata trajtuan probleme nga më të ndryshmet që kanë të bëjnë si me krijimtarinë artistike ashtu dhe me organizimin sa më të mirë të punës së organizatës së tyre. Problemet u analizuan në frymën e mësimave dhe direktivave të plenumit të 15 të K.Q. të P.P.Sh. Diskutantët shprehën entuziazmin dhe gatishmërinë për t'i vënë në jetë në veprat e tyre sa më parë dhe sa më mirë fjalët e partisë. Problemi i pastërtisë ideologjike të artit tonë dhe i luftës kundër pikëpamjeve revizioniste në art, ai i trajtimit të temës aktuale, problemi i lidhjes së artistëve me jetën e gjallë të popullit, ai i mbështetjes së fuqishme të krijimtarisë artistike në atë që u quajt «bazë kombëtare», rritja e cilësisë së veprave letrare dhe artistike, problemi i zhvillimit të gjinive të mëdha, organizimi më i efektshëm i punës edukative të kuadrove të reja artistike, qenë disa nga problemet e rrahura nga diskutantët.

### Sterjo Spasse

Duke marrë fjalën në plenum, shkrimtari S. Spasse, tha: «Raporti i Byrosë Politike të K.Q. të P.P.Sh. në plenumin e 15-të të K.Q. bashkë me forcat e reja që na përtërin, na dha edhe një festë të madhe, një festë të përherëshme të letërsisë e të arteve, festë që ka pushtuar këto javë tërë Shqipërinë».

Pasi foli, më poshtë, për sukseset që ka arritur letërsia jonë këto vjetët e fundit, sidomos në krijimin e disa figurave të shkëlqyera herojsh pozitive, shkrimtari S. Spasse u ndal më shumë në disa probleme që kanë të bëjnë me beletristikën tonë të sotme. Ndërmjet të tjerave ai tha:

«Desha të kufizohem në prozën e gjatë me tematikë ndërtimin e socializmit, me tematikë aktuale, pse edhe më aktuale se çdo problem tjetër letrar është pasqyrimi i aktualitetit, si na këshillon kurdoherë Partia jonë.

«Karakteristika e parë e kësaj proze të gjatë me tematikë ndërtimin e socializmit është fakti se prozatorët

tanë më të mirë janë përpjekur të vënë në qendër të krijimtarisë së tyre atë fenomen të mrekullueshëm të epokës sonë që është zgjimi tek njeriu i personalitetit njerëzor, i dinjitetit njerëzor. Shihni romanet e novelat që pasqyrojnë fshatin e ri: aty nuk ke më fshatarë skllëvër e të shtypur si Pilo Shpiragu e Mehmet Mullixhiu, e Zelë Lekolas ose si I Handakosuri, aty fshatarët i gjen zotër të tokës, zotër të të mirave materiale e shpirtërore, janë ata vetë që vendosin për fatin e tyre gjer që në novelat e para: Kujtoni Basho Gorin, që pret djathtas e majtas — edhe pse pret shtrembër, — me atë personalitet të krijuar fill pas çlirimit; kujtoni ata fshatarë të romanit «Kënetë», që zbresin grumbuj-grumbuj nga fshatrat vullnetarisht për t'iu vënë gjoks në baltovinave të kënetës së Maliqit, me shpresa të reja, me ideale të reja.



Pamje nga salla gjatë zhvillimit të plenumit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë (Foto: M. Progonati)

«Një karakteristikë tjetër e prozës së gjatë me tematikë aktuale është se prozatorët tanë e kanë kuptuar se burimi i përparimit është puna; se karakteri i njeriut duhet kërkuar në vështirësitë e aktivitetit të tij e se ky njeri i ri formohet e zbulohet gjatë procesit të punës. Me këtë koncept ideo-artistik të karakterit të njeriut të ri lidhen ndryshimet kualitative të të gjithë letërsisë sonë. Puna në prozën tonë të gjatë nuk është vetëm sfondi i zhvillimit të veprimeve, por ajo pasqyrohet edhe si një forcë që formon e që transformon karaktere. Vetë lulëzimi i romaneve e i novelave me tematikë krejt aktuale tregon qëndrimin e ri kundrejt punës, rritjen e njerëzve të rij. Dhe kur flasim për njerëz të rij, për njerëz të kohës, nuk mund të nisemi nga një gjë abstrakte, nga një

e paqënë në ndërtimin e jetës reale. Njeriu i kohës — si të themi — vështron nga tërë anët; tek secili prej nesh jeton një pjesëzë e fytyrës së tij poliedrike; të gjithë ne kemi shqetësimet, karakteristikat e tij, gabimet e hyqet e tij në dozë të ndryshme. Prandaj në një vepër artistike, ky njeri i kohës duhet të jetë real, njeri i jetës së përditëshme, i lidhur organikisht me ambientin e vet, me shoqërinë, me filosofinë, me ideologjinë e kohës sonë. Një njeri i tillë për shëmbëll, u formua gjatë punës së vrullëshme për tharjen e kënetës së Maliqit, e ky njeri, sot në tribunën e letërsisë sonë quhet **komunisti Stavri Lara**. Me ndryshimet e mëdha të fshatit të Labërisë, në punë e sipër ndryshoi edhe vesi parazit i fshatarit lab, që quhet **Çobë Rrapushi!** Çfletësoni edhe faqet e novelave e të romaneve të tjera me temë aktuale e do të gjeni plot personazhe të ndryshuar në procesin e punës. Vetëm se duhet theksuar se për fat të keq proza jonë e gjatë shumë pak i ka pasqyruar këta heroj të rij të lindur në procesin e punës nënë udhëheqjen e Partisë sonë. Realiteti ynë socialist na ka dhënë shumë shembuj fare konkretë të heroit të ri të krijuar në procesin e punës: Le të kujtojmë ndonjë prej tyre. Pistoleta e tunelit të Dajtit dhe të hidrocentraleve të Ulzës, Shkopetit e të Bistricës ka rritur e ka kalitur plot njerëz të rij të kohës. Njerës të tillë të rij në procesin e punës kanë dalë me dhjetra, me qindra e me mijëra nëpër uzinat e nëpër fabrikat tona, nëpër shkollat e nëpër fshatrat tona. Këta heroj realë nuk bëjnë në prodhim atë që **mund** të bëjnë, por bëjnë atë që **duhet** bërë. Ata kanë kërkesa shumë të mëdha ndaj vetes.

«Por përsëri po e theksoj, megjithë sukseset e mëdha të prozës sonë të gjatë, ajo ende s'ka mundur t'i skalisë këta heroj realë në heroj të letërsisë artistike. Nga se ka ardhur kjo?

«Shkaqet mund të jenë të shumtë, por shkaku kryesor është ai, që theksohet me aqë forcë në raportin e Byrosë Politike mbi letërsinë e artet mbajtur nga shoku Ramiz Alija: njohja jo e plotë e realitetit, lidhja jonë e pamjaftueshme me aktualitetin. E vërteta është se ne ende nuk kemi arritur ta njohim si duhet e të shkrihemi me realitetin e shumëanëshëm të ndërtimit të socializmit, ne ende s'kemi arritur të kuptojmë sa duhet kontradiktat e brendëshme të rritjes së heroit të ri; ne ende s'kemi arritur të kuptojmë kontradiktat jo antagonistike të këtij procesi të madh e të vrullshëm të ecjes përpara të shoqërisë sonë socialiste.

«Pas këtij vlerësimi të madh e pas këtij popullarizimi të gjerë që i bëri Partia jonë letërsisë dhe arteve e pas këtij raporti programatik për ne, prozatorëve tanë, si gjithë shkrimtarëve e artistëve, nuk u mbetet tjetër gjë veç-

se të bëjnë çdo përpjekje për të bashkuar eksperiencën e tyre relativisht të gjatë a të shkurtër dhe talentin e tyre me njohjen sa më të mirë të jetës së re shqiptare, të aktualitetit tonë, që të sjellin në tribunën e nderit të letërsisë sonë njeriun e ri të kohës sonë, njeriun e ndërtimit të socializmit.»

### Llazar Siliqi

Poeti Llazar Siliqi duke bërë fjalë për partishmërinë e veprave tona, kërkoi nga shkrimtarët dhe artistët një kalitje edhe më të madhe ideologjike në mënyrë që ata të jenë në gjëndje të kryejnë ashtu siç duhet detyrën e tyre të lartë të edukonjësit të njeriut të ri socialist.

«Vetëm pak ditë ma parë, — tha ai, — më 26 të nëndorit, u mbushën 60 vjet qysh nga dita kur Lenini formuloi parimin bazë të artit të ri socialist, parimin e partishmënisë. Dhe asht krenari për ne që sot, — kur ky parim goditet nga estetët borgjezë si nana e të gjitha të këqijave dhe shpallet nga teoricienët revizionistë si një parim i vjetëruem, që i ka ikë koha, — asht krenari për ne që Partia jonë e ngriti në plenumin e saj të XV edhe ma nalt, me forcë e vendosmëni, flamurin përherë të ri të artit të partishëm, flamurin e realizmit socialist. Vit mbas viti, me konsequencën dhe qëndrimin parimor që e karakterizon, Partia jonë ka drejtue me sukses revolucionin e madh kultural, ka naltue të përpërlyem flamurin e artit socialist, ka udhëheqë me kujdes të veçantë, me zotësi e mprehtësi sektorin e letërsisë dhe arteve, një nga sektorët shumë të randësishëm, por edhe shumë të vështirë e të ndërlikuem.

«Partia na ka edukue ne shkrimtarëve dhe artistëve me qëndrimin e ri ndaj punës, që na t'ia nënshtrojmë çdo gja çështjes së revolucionit, na ka mësue të synojmë gjithmonë të kapim hallkën kryesore, ajo ka kritikue në kohën e duhur çdo çfaqje të gabueme në lamën e letërsisë dhe arteve, ka kritikue me të drejtë çdo indiferentizëm ndaj problemeve ideore, na ka ngritë e na ka mësue të ecim me të dyja kambët, tue u mbështetë në traditat tona kombëtare dhe në traditat e artit të madh botënor të të gjitha kohëve, ajo ka luftue që t'i presë rrugën dhe t'i mbyllë çdo shteg ideologjisë së huej borgjeze dhe revizioniste, që ban përpjekje të depërtojë, tue përdorë mënyrat ma të stërhollueme.

«Dhe goditjet kryesore të ideologjisë së huej drejtohen në radhë të parë kundër dy shtyllave mbajtëse themelore të godinës së artit të realizmit socialist — kundër parimit leninist të partishmënisë dhe kundër parimit të udhëheqjes së letërsisë dhe arteve nga ana e Partisë.

«Estetët borgjezë e revizionistë propagandojnë deheroizimin e artit, orvaten të pushkatojnë heroin e luftave revolucionare, ndërtesin heroik të jetës së re socialiste, tue inkurajue me të gjitha mënyrat jo paraqitjen e jetës, që ndërtohet me mund e heroizëm, por paraqitjen e të metave të shoqnisë e anëve të zeza të jetës, ata predikojnë një art jo militant luftarak, por kapitullant e pacifist, tue vjellë vner kundër veprave të vërteta revolucionare dhe tue ngritë në qiell veprat, ku në emën të thellimit të realizmit, të realizmit pa cak e pa anë, anmiku del human e revolucionari — frikacak e shpirtvogël. Ata bartinë një interpretim formal e kozmopolit të novatorizmit, tue u përpjekë t'i mohojnë artit socialist karakterin e tij thellësisht novator».

Pasi foli për nevojën e kalimit në mënyrë më të gjerë në gjinitë e mëdha, poeti Llazar Siliqi, u ndal më gjatë në problemet që lindin lidhur me trajtimin e temës aktuale në artet tona. Ndërmjet të tjerash ai tha:

«Padyshim paraqitja me vërtetësi e jetës asht një detyrë themelore për gjithë ne shkrimtarët dhe artistët. Këte gja e nënvizoi edhe raporti i Byrosë Politike të K.Q. të Partisë mbajtë nga shoku Ramiz Alia. Dhe plotësimi i kësaj detyre, që lidhet drejt për së drejti me procesin e gjatë, të vështirë e të koklavitun të transformimit të botës shpirtnore të njerëzve, pra me rolin e letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave, bahet i mundshëm vetëm në qoftë se na, ashtu si na mëson Partia, bajmë përpjekje përherë e ma të mëdha për njohjen e thellë të jetës. Të gjitha ato që thuhën në lidhje me detyrën e njohjes së jetës, të gjitha format që propozohen dhe të gjitha kritikak që na bahen për të metat tona në këtë fushë janë të drejta.

«Krahas kalitjes ideopolitike, krahas njohjes së ambjenteve dhe objekteve të ndryshme, krahas studimit të materialeve e dokumentave, që na interesojnë në rastin konkret, një randësi të dorës së parë ka **kontakti shpirtnor** me njerëzit, që shkrimtari të mos e ndjejë asnjëherë e në asnjë rrethanë vehten të huej apo vizitues midis njerëzve, që shkrimtari të bisedojë lirisht me ta për jetën e për vdekjen, për punën e për dashurinë, për gëzimet e për hidhërimet, për shpresat e për andrrimet. Dhe shkrimtari këte e ban çdo ditë e në shoqni të punonjësve ma të ndryshëm».

Poeti Llazar Siliqi foli pastaj për sukseset e arritura nga letërsia dhe artet tona në krijimin e individualiteteve krijuese. Ai tha: «Një nga sukseset ma të shënueme, gja që dëshmon për vitalitetin e letërsisë sonë të re, asht padyshim krijimi i individualiteteve krijuese. Në larminë e këtyne individualiteteve asht bukurija e artit, se edhe

kjo larmi asht një përgjigje konkrete kundër akuzave të atyne, që e kanë halë në sy realizmin socialist dhe që thërrasin për uniformitet të letërsisë së realizmit socialist. Ndaj duhet, mendoj, t'i kritikojmë me të drejtë ato tendenca uniformiteti, që vihen re në mjaft poezi të debutantëve, të cilat botohen në faqet e organeve tona, ndaj, nga ana tjetër, në të njajtën kohë, nuk na takon neve ta bajmë mizën buell, siç ka ndodhë, për fat të keq, kohë ma parë, në vlerësimin e poezisë. Na kemi sot në të gjitha gjinitë një larmi stilesh që na gëzon.

«Ndryshojnë nga njeni tjetri dhe shquhen menjëherë nga dora e tyne, njohësi i pasionuem i jetës së fshatit Sterjo Spasse apo ndërtesuesi mjeshtëror i tregimeve Dhimtër Shuteriqi, dallohet penda e shkathtë, që vizaton tablo plot kontraste, e Petro Markos nga penda elegante e stilistit Shevqet Musaraj, na shquejmë menjëherë prozën e Fatmir Gjatës për tabllotë reale dhe për lirizmin e humorin e saj të natyrshëm nga proza e tregimtarit të qetë e të njerëzishëm Dalan Shaplo, rrjedh si lumë i gjanë e i ngadalshëm Jakov Xoxa dhe njihet shkrimi konçiz i prozatorit Dhimitër Xhuvani, të rrëmben forca epike e poezisë së Kolë Jakovës dhe të nxit fantazinë figurativiteti i poezisë së Ismail Kadaresë, e ndryshme asht thirrja revolucionare e poezisë së Andrea Varfit nga biseda e drejtpërdrejtë dhe e përzemërt e poezisë së Dritëro Agollit.»

Duke u ndalur në mënyrë të veçantë në problemet që kanë të bajnë me poezinë tonë të re, Llazar Siliqi tha:

«Mbasi jemi në fushën e poezisë, dëshroj të shtoj diçka në lidhje me përpjekjet edhe ma të mëdha, që duhet të bajmë të gjithë na poetët për ta ba poezinë edhe ma aktive në pasqyrimin e veprës së madhe ndërtimtare të popullit tonë si dhe në trajtimin e temës ndërkombëtare.

«Këto ditë, ndërsa po pregatisja një parathanje për një botim frengjisht të poezisë së Naim Frashërit, rilexova edhe një herë një pjesë të madhe të veprës së Naimit. Më rrëmbeu edhe një herë, e me forcë të re, pastërtija dhe zjarri i ndjenjave të poetit, dëshira e tij për ta pa atdheun me të vërtetë të zhvilluem e të përparuem. Ja ku na tingëllojnë nga largësija gati shekullore në kohën kur populli ynë ban çmos ta begatojë këtë tokë të trashëgueme nga stërgjyshët tanë, bash si për të marrë pjesë në përpjekjet tona, vargjet e Naimit.

**Edhe dheu, që na ep drithë, sido ta kemi punuar,  
nukë pjell mirë si duam, po s'e patmë plehëruar.**

«Folkloristi dhe patrioti i vjetër shqiptar Spiro Dine, bashkëkohës i Naimit, shkroi dikur se qëkurse doli Naimi:

ra një vesë e u zbut dheu,  
edhe fara, që ka mbjellë  
shumë lule do të pjellë

«Me të vërtetë shumë lule çelën qysh atëherë në kopshtin e poezisë shqipe nën kujdesjet e kopshtarit të zellshëm, Partisë sonë të Punës, dhe këto lule do të kenë përherë nevojë edhe për atë erë flladitëse e gjallënuese, që asht poezija naimjane, që asht poezija e gjithë pararendësve tanë të lavdishëm. Pjesëmarrja aktive e poezisë në jetën e popullit asht, pra, një traditë e vjetër edhe e re dhe s'ka dyshim se na të gjithë do të vemë të gjitha forcat për ta çue edhe ma përpara poezinë tonë qytetare.»

### Ali Abdihoxha

Diskutimin e tij Ali Abdihoxha ja kushtoi problemit delikat e shumë të rëndësishëm të edukimit ideo-estetik të popullit tonë. Pasi foli për orvatjet e pafat të teori-cienëve borgjezë dhe revizionistë për të mohuar gjallërinë dhe forcën e artit të realizmit socialist, pasi vuri në dukje rëndësinë që ka edukimi i shijeve të shëndosha e të drejta të lexonjësi dhe spektatori ynë, shoku Ali Abdihoxha tha në mes të tjerave:

«Shumë nisma e fillime të mira, apo shkarje e gabime, shumë thyerje e përmbysje të parimeve të estetikës marksiste-leniniste si dhe të metodës së realizmit socialist, shpesh e kanë burimin në kriteret e shijes estetike.

«Prandaj problemi i edukimit të mjerëzve tanë me shije të shëndoshë, duhet të jetë gjithmonë në qendër të vemendjes të kritikëve, estetëve, shkrimtarëve dhe i të gjithë artistëve tanë, qofshin këta piktorë, skulptorë, kompozitorë, skenografë apo artistë skene.

«Sigurisht në këtë betejë të ashpër ideore, në kon-ditat e rrethimit kapitalist e revizionist, duke pasur parasysh natyrën e disa gjinive të artit, të cilat penetronë në shumë mënyra, bile edhe me anë të efiirit, ne nuk mund të qëndronim të paprekshëm. Vigjilenca e lufta jonë duhet të jenë në rend të ditës, sepse penetrimi ideo-artistik, paraqet vazhdimisht rreziqe. Ai mund të futet në forma të ndryshme, pasi dhe vetë format e artit, nga natyra e tyre specifike, janë të shumta, shpesh mjaft elastike dhe shpesh të vështira për të kuptuar përmbajtjen që kamuflojnë pas termave moderne plot efekt, gjoja të kohës si, p.sh., «humanizmi i ri» «stili i kohës» etj.

«Le të marrim, p.sh., rolin edukues të artit kinematografik. Kinematografia është mjeti më i fuqishëm nga pikëpamja e propagandës. Kinematografia që mbështetet mbi metodën më të përsosur të realizmit socialist, bëhet një armë e fuqishme për propagandimin e ideve komuniste, faktor i rëndësishëm për edukimin e masave.

«Por roli propagandist i kinematografisë borgjeze nga pikëpamja negative jo gjithmonë është i kapshëm dhe i dukshëm aty për aty. Shpesh herë forma e teknika e përsosur, bëhen shkak që të mbulojnë përmbajtjen jo të shëndoshë të ideve që përshkojnë ndonjë film. Në fakt dikush mund të pyesë, për çfarë propagande mund të bëhet fjalë, p.sh., në filmat me tematikë intime? Kjo pyetje do të ishte e tepërt, po të kemi parasysh lidhjet e shumëanëshme të artit me politikën. Mos vallë rastësisht në shumë filma perëndimorë seksi dhe teoria e mbinjeriut, e njeriut jashtë klasave e shoqërisë, e njeriut apolitik, që s'ka asnjë detyrim ndaj shoqërisë, është ngritur në kult? Sigurisht jo! Kjo është një teori e tërë që borgjezia e transmeton përmes artit të bukur e sintetik të kinematografisë, mbi njeriun jo si kategori shoqërore, veprimet e të cilit kondicionohen nga faktorët e raportet shoqërore, por si kategori biologjike, veprimet e të cilit kondicionohen e motivohen vetëm nga impulset e seksit e nga lufta e egër për egzistencë. Sa larg janë këto filma nga jeta, qëllimet e nga përmbajtja e artit tonë, ku vetë parimi i partishmërisë, p.sh., i ve artit për detyrë të zbulojë çka është e mirë të njeriut, të ngrëjë në pah në radhë të parë luftën aktive të masave për socializëm, dhe ta kthejë kështu artin kinematografik, si pjesë përbërëse të çështjes së përgjithshme revolucionare.

«Apo të marrim tematikën e problematikën e disa filmave perëndimorë. Çfarë ndodh ngandonjëherë? Çfaqen filma gjoja me tematikë historike, apo mitologjike, por që në të vërtetë janë aktualizuar sipas dëshirës dhe aspiratave të borgjezisë. Sa për shtrembërimet që i bëjnë këta filma fakteve historikë, ky do të ishte gjynahu më i vogël. Ata shkojnë më larg. Ndonjeri ngrën në kult fenomene e sisteme të atilla shoqërore, të cilat kanë dalë me kohë nga arena e historisë. Ka dhe më keq. Borgjezia bën filma që trajtojnë subjekte mitologjike 4 shekuj p. erës së re, po që në të vërtetë përligjin kolonializmin e orëve të fundit.

«Kundër shijes së huaj dhe të keqe duhet të mobilizohen të gjitha forcat tona letrare-artistike-kritike dhe arsimore. Nuk do të ishte e mjaftë të thonim, bie fjala për kinematografinë, se mjeti më i sigurtë do të ishte prodhimi i filmave shqiptarë më mirë dhe më shumë. As

edhe rigoroziteti në zgjedhjen e filmave të huaj. Këto po se po, janë të domosdoshme. Gjëndje analoge, ndonse në masë më të vogël, paraqitet edhe në botimet e letërsisë së huaj. Duke i dhënë vëndin e parë letërsisë dhe artit kombëtar, kjo s'do të thotë se botime e filma të huaj s'do të ketë, pasi një privim i tillë që do t'u bënim njerëzve tanë si dhe mbyllja në guackën tonë do të ishte jo vetëm një veprim i pa drejtë, por dhe një mendim i pa pjekur, i rrëmbyer e sektant. Detyrë e madhe i bie në këtë drejtim shkollës sonë, mësuesve e pedagogëve tanë, kritikës dhe estetëve tanë, të cilët jo vetëm duhet të edukojnë njerëz me dashuri ndaj artit dhe letërsisë kombëtare, por edhe njerëz me shije të atillë, që të mprehë vështrimin kritik të rinisë sonë ndaj veprave të artit e të letërsisë së përkthyer, të filmit të huaj etj. Shkolla dhe shtypi ynë, kryesisht ai letrar, duhet të punojnë në mënyrë të atillë, që njerëzit tanë të jenë në gjëndje të gjykojnë vetë ç'është mirë dhe ç'është keq, të zhvillojnë tek ata ndjenjën e asimilimit të drejtë e të protestës për anët e dobëta të veprave. Atëhere, midis radhëve tona do të shtrohet problemi jo të kritikojmë veprat e gabuara, që u përmendën në referatin e Shokut Ramiz Alia në plenumin e XV-të të partisë, por para së gjithash, dhe ky do të ishte qëllimi i ynë final, të krijojmë një situatë të shëndoshë ku të mos lejojmë që vepra të atilla të shkruhen tek ne ose të shkruhen sa më pak.

«Sot ne kemi një letërsi dhe art shqiptar, që jo vetëm me përmbajtjen e tij novatore, si letërsi e socializmit, por edhe me nivelin e mjeteve artistike, mund të mburremi para botës dhe mund të qëndrojmë ballë hapur pa na u skuqur faqja. Tashmë ne kemi krijuar notën tonë shqiptare, fjalën tonë shqiptare në këtë sektor të rëndësishëm ideologjik dhe me të drejtë Partia dhe populli presin nga ne vepra më të mëdha në dobi të edukimit të masave punjësë.

### Kolë Jakova

Dramaturgu Kolë Jakova, pasi foli për zhvillimin e dramaturgjisë sonë të re gjatë këtyre vjetëve të fundit, u ndal në problemin e repertorit të teatrove tona. Midis të tjerave ai tha:

«Në raportin e Byrosë Politike i jepet rëndësi e madhe repertorit nacional, qoftë në teatrot dramatike, qoftë në teatrin e operas dhe estradat tona. Kjo asht shumë e drejtë. Partia kurdohetëri i ka dhanë rëndësinë e duhur repertorit nacional për teatrot tona. Pa një repertor të tillë nuk mund të ketë teatro me fizionomi nacionale. Mandej, si i

thonë një fjale, kërkush s'ta kruen shpinën ma mirë se dora jote, kërkush nuk i qan hallet e nevojat e tua ma mirë se ti vetë. Veç kësaj, teatri asht deri diku një pasqyrë ku populli ka dëshirë të shikojë në radhë të parë vetveten e mandej të tjerët. Populli ynë i mrekullueshëm pa tjetër ka dëshirë të shofë në teatër heroikën e tij, problemet që e preokupojnë, veprat e mëdha që ka krye e kryen dita ditës, ka dëshirë të shikojë Luftën e tij nacional-çlirimtare dhe përpjekjet e të parëve të tij për liri, pavarësi dhe tokë. Teatri, i ndihmuem doemos nga dramaturgët tanë, me ato mundësitë e veta e ka krye përgjithësisht mirë këte detyrë të Partisë dhe të popullit. Dramaturgjia jonë e re, megjithëse pa një traditë për të qenë, u rrit nga viti në vit dhe repertori (flas këtu për teatrin dramatik) u pasunue me vepra të reja e të mira.»

Duke folur në mënyrë të veçantë për cilësitë ideo-artistike të veprave të dramaturgëve tanë, shoku Kolë Jakova, ndër të tjera, tha:

«Gjithmonë në veprat tona do të mbetet primare përmbajtja e shëndoshë. Për këtë nuk ka diskutim. Një yepër me përmbajtje të shtrembër ideopolitike asht e damëshme, edukon keq dhe populli vetë në radhë të parë nuk e qas. Në raportin e Byrosë Politike kritikohen me të drejtë disa nga pjesët dramatike që kishin një përmbajtje jo të drejtë, një shtrembërim të realitetit tonë. Me të drejtë raporti i quen këto si aksidente: aksidente të tilla mund të na ngajnë të gjithëve, nëqoftëse nuk do t'i vërejmë thellë veprat tona, nëqoftëse do të influencohemi nga ai i ashtuquejtuni «modernizëm» nën maskën e të cilit shpesh fshihet një frymë e sëmure e rrymave dekadente dhe revizioniste, të cilat sot janë përhapë dhe bajnë zhurmë kudo. Humanizmi mbiklasor, arti për art, deformimi i formës, nihilizmi, dëshpërimi, heqja e frymës revolucionare artit, aventurizmi dhe izma të këtij kallëpi nuk kanë kurgja të përbashkët me artin e shëndoshë, me artin e kuptueshëm për masat, me artin që i mbush zemrat me optimizëm dhe i edukon ato me shije të nalta artistike. Arti kërkon thjeshtësi. Sa ma i lartë të jetë, aq ma i thjeshtë do të paraqitet. Kur nuk e thue dot thjesht ate që të vlon përbrenda, kot përpiqesh ta ngatërrosh e ta bajsh të pakuptueshme, kot u lyp ndihmë figurave ekstravagante. Kur s'e thue thjesht, do të thotë se nuk ke frymëzim. Përmbajtja dhe forma formojnë një unitet të pandamë, plotësojnë njëra-tjetrën. Pra nuk mjafton përmbajtja e shëndoshë e veprës për me e ba ate një vepër për të qenë. Bile ate përmbajtje mund ta përçudnojë fare mirë vetë forma dhe ta bajë të pavlefëshme, mos edhe të damëshme.

«Shija artistike e popullit tonë asht ngritë. Dikur publiku na i falte deklaratat e hapuna dhe axhitacionin ndër

veprat tona. Na i falte mjaft mëkate. Por tashti nxanësi i klasave të fundit të shkollës së mesme të flet si bilbil për ligjet e brendëshme të dramës, për skenat, personazhet dhe të jep mendim për vlerën e veprës. Brezi i ri që po rritet asht i pamëshirshëm në këte drejtim, nuk t'i fal të metat dhe mëkatet, por t'i thotë copë. E sot në shkollë të mesme e përpjetë ka me dhjetra mijë në Tiranë e me qindra mijë në vendin tonë që formojnë një opinion publik të ngritun. Jo rrallë kritika jonë e injoron këte opinion dhe jep mendime edhe në kundërshtim me te për ndonjë vepër. Kjo sigurisht asht krejt e gabueme.»

Më poshtë, Kolë Jakova foli për nevojën e zotërimit dhe përsosmërinë e mjeshhtërisë artistike nga ana e dramaturgëve tanë. Ai kërkoi nga ana tjetër më tepër kujdes prej tyre në kapjen e problemeve qëndrore, kardinale të aktualitetit tonë dhe në pasurimin e veprave tona me idetë e lartë socialiste në mënyrë që ato të militojnë me forcë në edukimin e drejtë e të shëndoshë të punonjësve dhe në ndërtimin e plotë të socializmit në vëndin tonë. Një rëndësi të posaçme i dha shoku Kolë Jakova edhe anës emocionale të dramave tona, të cilat, — tha ai, — duhet të prekin zemrat e spektatorëve tanë të shumtë. Një pjesë të mirë të diskutimit dramaturgu ynë i mirënjohur ia kushtoi problemit të njohjes së realitetit dhe rëndësisë që ka kjo për shkrimtarët dhe artistët tanë.

«Nuk mjafton, tha ai, të jesh i frymëzuem, të kesh një ide të lartë, por duhet të dish ta shprehësh këtë në dramë. Së pari duhet të njohësh atë realitet për të cilin je frymëzue dhe ta njohësh në thellësi. Njohja e çastit shumë shumë mund të japë dorë për fluturime poetike, por jo për dramë. Drama i do kambët në tokë. Të gjithë artet i duen kambët në tokë, por drama sidomos i do të nguluna thellë, ndryshe s'ta pranon publiku, sidomos kur drama trajton një problem aktual. Jeta e sotme paraqet larmi dhe zhvillim të papamë ndonjëherë. Ajo ecën shpejt. Problemi i njohjes së jetës bëhet gjithnjë ma i domosdoshëm».

### Ibrahim Uruçi

Duke marrë fjalën në plenum, shoku Ibrahim Uruçi foli në radhë të parë për vlerën e madhe që kanë për letërsinë dhe artet tona materialet e plenumit të 15 të K.Q. të Partisë.

«Mësimet e Partisë në çështjet e letërsisë dhe artit, — tha ai, — kanë qënë dhe do të jenë për ne tërë jetën fener ndriçues në rrugën tonë krijuese, sepse pa udhëheqjen e Partisë nuk mund të ketë art që t'i shërbejë me të vërtetë popullit, socializmit dhe komunizmit. Ne që jemi mbledhur në këtë plenum pune të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artis-

tëve, e ndjejmë veten jo vetëm të rrethuar nga kujdesi i Partisë, por njëkohësisht, secili prej nesh, komunist dhe pa parti, mendon si e si t'i kuptojë më thellë çështjet që shtron plenumi i 15-të i K.Q. të P.P.Sh. në raportin e Byrosë Politike «Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave»

Më poshtë, si zëvendës kryeredaktor i revistës «Nëndori», ai shprehu bindjen e tij se kolegju i revistës në fjalë do të dijë të nxjerrë mësimet e duhura dhe të vlefshme nga kritikrat dhe vërejtjet që i janë bërë.

«Ne, — tha ai, — aprovojmë plotësisht kritikën që iu bë revistës «Nëndori» në plenumin e 15-të të K.Q. në lidhje me materialet e dobëta artistikisht dhe ideologjikisht që kemi botuar. Ne do të vemë të gjitha forcat që revista «Nëndori», — ashtu siç thotë plenumi i K.Q. «të lozë një rol shumë të madh në pasqyrimin e jetës artistike e kulture të vëndit tonë, në orientimin dhe nxitjen e shkrimtarëve që të përmbushin detyrat e tyre, në zhvillimin e kritikës parimore letraro-artistike, në trajtimin e problemeve ideo-artistike që ka fronti ynë i letërsisë dhe arteve si edhe në luftën kundër revizionizmit në letërsi dhe arte».

Pastaj, dramaturgu Ibrahim Uruçi u ndal në disa probleme që kanë të bëjnë me dramën dhe teatrot tona. Ndër të tjera ai tha:

«Kam qënë dhe jam i mendimit se veprat me temë aktuale përbëjnë shpirtin e dramaturgjisë dhe të repertorit të teatrot tona. Është e vërtetë që dramaturgjia jonë ka krijuar pjesë me dinjitet, pjesë që janë mirëpritur nga publiku për frymën e tyre revolucionare, për karakterin e tyre edukativ, për rëndësinë e problemeve që kanë pasqyruar si edhe për vlerat e tyre artistike. Me gjithë këto suksese, në Raportin e Byrosë Politike thuhet: «Në dramaturgji, përveç nevojës për më shumë drama e komedi të një niveli më të lartë artistik, detyra bazë është ecja me vendosmëri në rrugën e thellimit të tendencave realiste nëpërmjet kapërcimit të çfaqjeve romantiko-sentimentaliste që vihen re akoma në këtë fushë».

«Që të jesh realist nuk duhet kurrë të ndash vërtetësinë e jetës nga vërtetësia artistike ose t'i vesh ato përballë reciprokisht. Mosnjohja e realitetit ka bërë që në disa drama tona të zenë vend disa situata të jashtëzakonëshme, subjekte të thurur me marifete, me efekte për t'u marrë nëndjen spektatorëve etj. Disa herë harrohet se konfliktet duhet të jenë realë dhe origjinalë, kurse konvencionet përdoren në një mënyrë t'atillë që nuk besohen nga asnjë. Ata nuk i shërbejnë realizmit, ata perceptohen shtrembër për të krijuar idera fallso. P.sh., ngritja nga varri i partizanit në «Drama e një partizani pa emër». Unë mendoj se nga të gjithë ne duhen vlerësuar shumë fjalët

e Çehovit që thotë: «Duhet që jeta të paraqitet ashtu siç është dhe njerëzit ashtu siç janë dhe jo të zmadhuar». Po e njohe mirë realitetin, po u frymëzove prej tij, atëherë çdo gjë do të shkojë natyrshëm, çdo gjë do të jetë e besueshme dhe në skenë do të kemi njerëz dhe jo kukulla. Shkrimtarët e mëdhenj kanë shkruar gjithëmonë mbi vërtetësinë e jetës, prandaj janë edhe të mëdhenj.

«Sa për repertorin e teatrove, dihet se fytyra e një teatri krijohet me pjesë nacionale. Pra është e natyrshme që entuziazmi i gjithë kolektivit duhet të jetë për këto pjesë. Sigurisht, jo për ato pjesë që qëndrojnë me paterica. Që të vlerësohesh pjesë nacionale, nuk mjafton interesi i të lexuarit, por i zbërthimit të saj, i njohjes mirë të elementeve artistike që ka përdorë autori dhe, ajo që ka më rëndësi, njohja nga gjithë kolektivi i materialit jetësor që përdor autori. Nganjëherë bindemi se të vesh një pjesë nacionale është gjë e lehtë, por harrojmë se është më zor t'i thuash, si aktor, spektatorit se unë jam X fshatar lab, se sa i ndonjë kombësie tjetër. Personazheve të huaj ua kanë bërë karakteristikat sa e sa veta, kurse këtyre tanëve aktori dhe regjizori ua bën për të parën herë. Mirëpo e keqja qëndron nga një herë që në premierë karakteristika e personazhit del e kjartë, kurse mbas 7-8 çfaqjeve fillon e bëhet me njolla dhe luhet sa për të kaluar radhën. Mua më duket se ka ardhë koha që të kërkojmë me këmbëngulje që çfaqja e 10-të e një pjese të jetë më e mirë se premiera.

«Plenumi i 15-të i K.Q. të entuziazmon dhe të nxit për një punë më të mirë në të gjithë sektorët e artit dhe letërsisë. Njëkohësisht edhe njëherë Partia na thotë se veprat e mira bëhen duke i dhënë rëndësi të dorës parë kalitjes sonë ideologjike.»

### Fadil Kraja

Poeti Fadil Kraja foli në diskutimin e tij për forcën edukative të letërsisë sonë të re. Ai tha se sidomos rinia dhe ajo shkollore, në mënyrë të veçantë, është shumë e interesuar për letërsinë tonë të realizmit socialist dhe entuziazmohet për çdo sukses të ri të kësaj letërsie, të çdo gjinie goftë. «Kjo, — tha ai, — duket jo vetëm në libraritë, ku nxënësit dhe studentët rrinë në radhë për me ble një libër të ri, jo vetëm nëpër biblioteka ku numuri ma i madh i lexuesve përbahe nga nxanës e studentë, por edhe në seriozitetin që u japin ata rrethve letrare, diskutimeve të hapta të ndonjë veprë dhe sidomos në dëshirën e madhe që kanë me u njohë për së afërmi me shkrimtarë, me ndëgjue nga goja e tyre deklamime nga punimet e reja, me i bombardue me pyetje shpesh herë shumë interesante rreth problemeve të letërsisë që i preokupojnë ata».

Duke folur më poshtë në lidhje me pasqyrimin e letërsisë sonë në tekstet shkollore, shoku Fadil Kraja tha:

«Shkrimtarët vijnë rrallë tek nxanësit. Kjo asht e natyrshme, sepse jo vetëm nxanësit duen të takohen me ta dhe, së fundi, jo vetëm këtë punë kanë shkrimtarët. Ata që jetojnë me nxanësit, ata që duhet t'u përgjigjen ma tepër pyetjeve të tyre janë mësuesit e letërsisë, një ndër ta dhe unë. Kur Ll. Siliqi recitoi para tyre poemën e mirënjohun «Mësuesi», nxanësit më pyetën të nesërmen: «Pse kjo poemë dhe poema tjetër «Ringjallja» ose «Pranvera e madhe» nuk janë në antologji? Jam i mendimit (dhe ky asht mendimi i shumë mësuesve) se antologjia që kanë vetë në dorë nxanësit e shkollave të mesme nuk përfaqëson krejt sukseset e letërsisë së sotme të realizmit socialist.»

### Agim Shehu

Poeti Agim Shehu e përqëndroi diskutimin e tij rreth një problemi të rëndësishëm për letërsinë dhe artet në përgjithësi, rreth problemit të pasqyrimin të realitetit nëpërmjet motiveve të mëdha, kardinale të shoqërisë, nëpërmjet tiparit kryesor të kohës. Ai tha:

«Veprat e letërsisë artistike që çfletosim përditë, të çdo kohe e të çdo populli qofshin, përveç si vepra letrare, ato janë në të njëjtën kohë dhe analë historike, ku epokat zbulojnë fytyrat e tyre me problemet e tyre kardinale. Dhe mund ta njohim e ta konceptojmë fare mirë historinë, jetën në luftë të brezave (aq sa është shtrirja e letërsisë), pikërisht për faktin se aty, në më të mirat vepra artistike, shkrimtarët kanë pasqyruar thellësisht realitetin e tyre historik, tendencën kryesore dialektike të kohës, nervin dhe zemrën e popujve. Pasqyrimi i thellë i realitetit, pra, siç u theksua shumë në plenumin e K.Q. e siç u përmënd edhe në referatin e djeshëm, ka qënë dhe mbetet si çështje kryesore, nga e cila varet karakteri i vërtetë militant i letërsisë, dinjiteti i saj, dhe, për pasojë, jeta e gjatë e saj në shërbim të njerëzve.

«Sikur të kujtojmë për një çast letërsinë e ndritur të Rilindjes, ç'e përbën trungun kryesor të saj, si u ngjeshën ata të gjithë, me atë patriotizëm të flaktë, pas trungut kryesor, që qe problemi kryesor i kohës. «Erdhi dit' e Arbërit» — thërret De Rada, «Arriti dit' e lirisë» — profetizon Naimi. «Erdhi dita të ngresh kokë» — jep kushtrim Çajupi. «Po vjen lirimi i Atdheut» — buçet Mjeda. . . Këtë thanë dhe malet. Ky qe problemi kyç. Mbi këtë trung qëndroi flamuri që u ngrit në ballkonin e Vlorës.

«Të tillë principialitet ka pasur letërsia jonë. Atë ajo zhvillon edhe sot, si letërsi e realizmit socialist.

Dhe nëqoftëse tipari kryesor i kohës tek ne është fitorja e socializmit në luftë të rreptë, mposhtja me heroizëm e pengesave të jashtme dhe vështirësive të brendëshme, ky mendim qëndror duhet të përshkojë letërsinë tonë, t'i vërë vulën asaj, që shkrimtarët t'u lënë brezave t'ardhmë heroizmin e rrallë të kësaj kohe, për të cilën ata, aq sa do jenë krenarë, do kërkojnë dhe llogari. Letërsia jonë e sotme socialiste, gjatë më se dy dekadash, e ndriçuar dhe e ndihmuar fuqimisht nga Partia, duke u zgjeruar si kurrë ndonjëherë në gjerësi, ka dhënë edhe në thellësi shumë vepra me dinjitet artistik, vepra ku kumbon realiteti ynë i bukur dhe i ashpër, ku pasqyrohet nervi dhe pulsi i socializmit. Pse, p.sh., është bërë aq i dashur romani «Këneta»? Kush i harron ato skena pune të heroizmit masiv popullor për tharjen e kënetës, rrugën plot dritë e zigzake vetëtime të Stavri Larës, të atij komunisti, aq model sa dhe tokësor, në mes reaksionit dhe të vështirësive?

«Punonjësit tanë i duan dhe i lexojnë me endje të tilla vepra, ku heroizmi buron nga vështirësitë reale të jetës së tyre të përditëshme. Dhe kjo ka filozofinë e saj të thjeshtë. Ata që, siç thotë poeti, e hanë shkëmbin si tortë, aq të ndërgjegjshëm për vështirësitë sa dhe të sigurtë për fitoret, këta tanimë janë mësuar me vështirësitë në të gjitha frontet, këto janë bërë e po bëhen jetike për ta, të zakonëshme, të pranueshme e të kapërxyshme. Prandaj letërsia reale kontemporane, ajo që pasqyron plotësisht dhe artistikisht realitetin tonë socialist, ajo është kurdoherë e dashur, interesante dhe edukuese, ajo rezonon plotësisht me botën e punës të lexonjësve, me ëndrat e tyre interesante, bisadat dhe mendimin e brendëshëm. Sot, puna në socializëm, është bërë dhe po bëhet çdo ditë e më shumë një pjesë e sferës së ndërgjegjes socialiste të punonjësve tanë. Ndaj, siç thotë Gorki, puna duhet të na bëhet hero kryesor i veprave tona. Letërsia jonë ka treguar me vepra dinjitoze se është e aftë për ndërmarrje të tilla, kur shkrimtari e sheh realitetin siç është, me sytë e punëtorit.»

Më poshtë, shoku Agim Shehu foli për nevojën e kalitjes së mëtejshme ideologjike të shkrimtarëve dhe artistëve tanë, në mënyrë që, — siç u shpreh ai, — «ata të jenë të përgatitur që mendimet t'i derdhin nëpër një filtër të pastër ideologjik».

«Sado i frymëzuar dhe me talent që të jesh, vazhdoi ai më tutje, po s'u forcua mirë kjo, vepra s'del dot n'orbitë, do të ketë dështime të dhimbëshme, si veprat që janë kritikuar me të drejtë, sepse, ashtu si na mëson Partia, edhe letërsia duhet të luftojë në frontin ideologjik dhëmb për dhëmb me ideologjinë borgjeze revizioniste.»

## Andon Kuqali

Shoku Andon Kuqali foli në përgjithësi për punën që ka bërë gazeta «Drita» gjatë këtyre vjetëve. Ai tha:

«Gazeta «Drita» ka pasqyruar veprimtarinë letrare e artistike të vendit tonë duke botuar tregime, poezi, fragmente nga romanet e dramat e reja, riprodhime të veprave të reja të arteve figurative etj».

Ai vuri në dukje se puna kryesore që ka bërë gazeta ka qenë botimi i artikujve kritikë mbi veprat e reja letrare e artistike. Një vend të rëndësishëm ka zënë kritika teatrale e kinematografike.

Gazeta ka ndihmuar për zbulimin e talenteve të rinj letrarë dhe për zhvillimin e kritikës muzikore e të arteve figurative, e cila më parë ka qënë shumë e rrallë dhe e dobët. Pastaj ai theksoi se, «siç thuhet edhe në raportin e Byrosë Politike të K.Q. të P.P.Sh., puna e gazetës sonë për trajtimin e problemeve të letërsisë e arteve dhe për formimin e drejtë të opinionit të masës është akoma e pamjaftueshme.»

«Të rrallë kanë qenë artikujt që shtrojnë probleme ideologjike. Botimi i artikujve të tillë që të luftojnë kundër pikpamjeve borgjeze e revizioniste në letërsi, art e kulturë, që të mbrojnë pozitën tonë marksiste-leniniste, është një nga detyrat kryesore të gazetës.»

«Me artikujt kritikë që ka botuar gazeta, në përgjithësi ka ndihmuar për vlerësimin e veprave letrare e artistike. Por të rrallë kanë qënë artikujt që janë thelluar siç duhet në problemet dhe redaksia nuk ka treguar gjithënjë vigjilencën e duhur kundër çfaqjeve të huaja që nxorën krye në disa vepra letrare. Në vënd që të zbuloheshin gabimet ideologjike e të luftoheshin, gazeta botoi për ndonjëherë prej këtyre veprave artikuj që i vlerësonin si të mira.»

«Në përgjithësi kritika letrare e artistike që është botuar në gazetë ka patur një karakter pak a shumë recensional: gazeta jonë ka për detyrë të mbajë qëndrim për çdo vepër letrare e artistike të rëndësishme që del.»

«Rrahjen e problemeve ne jemi përpjekur ta bëjmë edhe me anën e diskutimeve. Nga ato, doemos kemi patur përfitim, por nganjëherë kemi kaluar nga njëri ekstrem në tjetrin.»

Pastaj ai foli mbi prozën, fragmentet dhe poezinë që është botuar në gazetë, mbi temat që janë trajtuar. Pasi vuri në dukje se gazeta ka ndihmuar për zhvillimin e kritikës muzikore e të arteve figurative, ai tha se në këtë lëmë jemi ende prapa.

«Redaksia jonë, përfundoi ai, do të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndrequr gabimet, ta bëjë gazetën «Drita» një luftëtare të zjarrtë për artin e realizmit socialist, një ndihmëse të denjë të politikës së partisë në letërsi, arte e kulturë.»

## Kudret Velça

Pasi foli për nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të kritikës sonë të re letraro-artistike, shoku Kudret Velça u ndal në disa probleme që kanë të bëjnë në përgjithësi me artin tonë. Ndërmjet të tjerave, ai tha:

«Një nga kërkesat themelore të metodës së realizmit socialist është krijimi i tipikes, dhe kjo theksohet me të madhe në raportin e Byrosë Politike të K.Q. të P.P.Sh. Çështja e tipikes lidhet drejtpërsëdrejti me pasqyrimin e realitetit, pra me problemin kryesor të artit. Dobësitë ideore që vihen re në disa drama apo tregimet tona, dhe që janë kritikuar me të drejtë, përveç arsyeve të tjera që dihen, kanë rrjedhur edhe si shkak i largimit nga pasqyrimi i tipikes së jetës dhe të hedhurit pas fakteve, rasteve të veçanta duke harruar atë që është e përgjithëshme. Kjo do të thotë të largohesh nga kapja e esenciales në jetë. Krijimi i tipikes nuk ka rëndësi vetëm artistike, ajo ka rëndësi ideore. Tipikja është vëndi i manifestimit të artistikes e politikes, prandaj ka dhe rëndësi të madhe në letërsi e art. Nuk është e rastit që në estetikën e sotme revizioniste lihet mënjanë një parim i tillë i rëndësishëm i realizmit socialist. Është e vërtetë që në krijimin e tipikes dalin vështirësi. Këto vështirësi janë të dyanëshme. E para, duhet të krijohet unitet i tipikes, i së përgjithëshmes, i së ligjëshmes me individualen, të veçantën. Dhe, e dyta, duhet kuptuar që ky unitet nuk është një cilësi e formës artistike, një mjet teknik i sai, por një produkt i formës e përmbajtjes në marrëdhëniet e tyre reciproke. Në pasqyrimin me vërtetësi të jetës kërkohet kapja e atyre ngjarjeve, fenomeneve që janë esenciale, kryesore dhe jo çdo gjë që të bie në sy. Dhe kjo nuk është një çështje që i takon vetëm letërsisë e arteve. Ajo është një nga kërkesat kryesore të teorisë së njohjes të materializmit dialektik. Të pranosh vetëm faktin do të thotë ta njohësh fenomenin në sipërfaqe, kurse ta njohësh atë me rrënjë, do të thotë të njohësh thelbin e tij. Raporti i paraqitur nga Byroja Politike e K.Q. të P.P.Sh. na mëson se përderisa metoda e realizmit socialist mbështetet në paraqitjen e aspekteve esenciale të jetës, nuk duhet pranuar si rrugë realiste pasqyrimi i realitetit nëpërmjet kapjes së fakteve të thjeshta të jetës. Në problemin e kapjes së anëve kryesore në procesin e jetës duhet theksuar një moment tjetër i rëndësishëm që bën të dallohet tipikja e realizmit socialist nga tipikja e realizmit kritik. Aty theksohet dallimi që duhet të bëjë shkrimtari dhe artisti të asaj që është e re dhe që përfaqëson tendencën përparimtare të fenomenit. Këtu është kërkesa e perspektivës. Dihet se perspektiva nuk është e realizuar akoma në jetë, se po të qe e realizuar, nuk do qe më perspektivë. Por si mund ta pasqyrojë shkrimtari

këtë perspektivë në goftë se ai nuk njeh thellë jetën dhe teorinë marksiste-leniniste? Një nga arësyet që disa herë veprat me temë aktuale dalin të zbeta është edhe fakti se shkrimtari apo artisti subjektin nuk e ka nxjerrë duke e jetuar jetën, por të shkëputur nga ajo. Pasi e ka krijuar në kokë, edhe pse shpesh herë ajo temë, ai subjekt nuk i përshatet jetës sonë, është i marrë nga librat e huaja, shkohet në një qëndër pune dhe aty mblidhen shënimet e duhura, kështu që vepra letrare del gjysma mi e gjysma zog, sepse nuk arrihet të bëhet shkrirja e dy të kundërtave. Prandaj problemi i njohjes së jetës nuk duhet kuptuar i njëanshëm, vetëm me vajtjen poshtë, në terren, por edhe me komponentet e tjera që janë të domosdoshme për njohjen e jetës, me komponentin e njohjes teorike të saj.

«Nxjerrja e herojve të veprës nga vetë jeta dhe jo anashjelltas do të zgjidhë drejt edhe problemin e heroit pozitiv e negativ, problem që shtrohet në raport. Duhet të pranohet më të gjithë se letërsia e realizmit socialist edukon nëpërmjet heroit pozitiv, prandaj vendosja e këtij heroit në qëndër të veprës nuk është çështje artistike vetëm, por dhe çështje ideore. Duke mos u futur në analizën e saj, dua të theksoj se ngritja e këtij problemi në raport jo vetëm që ka rëndësi ideore, por ka rëndësi edhe direkt me formën artistike, me kompozicionin e veprës. Kjo edhe një herë tjetër thekson faktin se vendosja e personazheve në qëndrorë dhe periferikë, në kryesorë dhe episodikë nuk është një çështje thjesht letrare, por edhe një çështje ideologjike.»

## Resul Bedo

Shoku Resul Bedo, duke folur në emër të letrarëve ushtarakë, paraqiti sukseset e arritura prej tyre në lëmin e letërsisë dhe të artit. Ai tha:

«Mendojmë se bërthama e një letërsije artistike me tema ushtarake u krijua fill me daljen në dritë të gazetës «Luftëtari» dhe të revistës «10 Korriku». Ndër letrarët e parë që shkruan për pasardhësin e partizanit, për ushtarin, genë Qamil Guranjaku, Ali Abdihoxa, Luan Qafëzezi, Thoma Frashëri, Reshat Nepravishta, Halim Stolija, Safet Kurti e ndonjë tjetër, të cilët na dhanë skica, vjersha dhe tregime nga jeta e ushtrisë. Më vonë të tjerë letrarë shkruan për ushtrinë, midis tyre edhe shumë shkrimtarë. Ndërsa sot në ushtri ka 12 rrethe letrare të ngritura në disa garnizone dhe në shkolla ushtarake. Letrarët ushtarakë marshojnë me hapin e ushtarit dhe të detarit. Jeta në ushtëri është e pasur në veprime, në ndjenja në lidhje me kolektivin, në kalitjen e karaktereve; ajo është burim temash për të shkruar vepra letrare të rëndësishme, me përmbajtje të thellë dhe formë të bukur, vepra që ndihmojnë në eduki-

min patriotik të popullit dhe të ushtarakëve. Mundësitë për të shkruar për këtë temë janë në radhë të parë për letrarët që janë në ushtëri. Kjo nuk përjashton që shokët shkrimtarë të afirmuar të merren akoma dhe më tepër me trajtimin e temës ushtarake. Në gjirin e ushtërisë ka shembuj të lartë të heroizmit me të cilat mund të shkruhen tregime, poema, novela, drama dhe, pse jo, romane.»

Pastaj, shoku Resul Bedo foli për trajtimin e temës ushtarake në disa vepra të botuara kohët e fundit si edhe për nevojën që kjo temë të njihet më mirë e të trajtohet më gjerësisht nga shkrimtarët tanë.

### Baki Kongoli

Kompozitori Baki Kongoli, duke marrë fjalën në plenum tha ndërmjet të tjerave:

«Ne po e zhvillojmë plenumin tonë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në një atmosferë optimizmi, gjallërie dhe entuziazmi, me forca të përtëritura e me besim të patundur në vetvete për t'i kryer sa më mirë dhe me nder të gjitha detyrat e mëdha e të rëndësishme që shtroi Partia jonë në plenumin e 15-të të K.Q.

«Vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë, mësimet e këshillat e saja të urta, orientimi largpamës e kujdesi atëror kanë qënë dhe janë gjithmonë burim i pashtershëm frymëzimi për kompozitorët dhe muzikantët tanë. Duke festuar 20-vjetorin e themelimit të organizatës sonë në këto ditë plot me ngjarje të shënuara në jetën artistike, letrare e kulture të vëndit, na shkon fluturimthi para syve e mendjes sonë gjithë ajo rrugë e vështirë, po e lavdishme, që ka bërë muzika shqiptare gjatë këtyre 21 vjetëve të jetës sonë të lirë e të pavarur. Dhe kur mendojmë se nga meloditë e para, nga format e vogla, si marshet, këngët e punës e krijimet e tjera të thjeshta që dolën gjatë ditëve të para të çlirimit të vëndit, sot kemi në repertor tri opera, tri sinfoni, dy balete klasike, shtatë opereta dhe një numur të konsiderueshëm vepra të tjera vokale e instrumentale të formave dhe gjinive të ndryshme, kemi të drejtë të entuziazmohemi e të jemi optimistë. Këtë optimizëm e besim të patundur na e ngjalli dhe na e përforcoi dhe më shumë Partia jonë në plenumin e saj të 15-të. Duke i bërë një analizë të thellë e shkencore gjithë punës krijuese të shkrimtarëve, kompozitorëve, piktorëve dhe skulptorëve plenumi i K.Q. shtroi një sërë detyrash të cilat janë një program madhështor pune për të gjithë njerëzit tanë të letërsisë e arteve, të cilët talentin e aftësitë e tyre krijojnë ia kanë kushtuar kauzës së shënjtë të Partisë dhe popullit, ndërtimit të socializmit dhe edukimit komunist të masave.

«Si problem të rëndësishëm dhe si një nga detyrat krye-

sore për kompozitorët, plenumi shtroi çështjen se «përsa i përket muzikës, detyrë themelore është mbështetja tek muzika popullore, tek folklori ynë, i cili është një pasuri e paçmueshme dhe burim frymëzimi për kompozitorët tanë.

«Praktika e punës krijuese ka treguar gjithmonë se një vepër muzikore del e goditur dhe e frymëzuar, atëherë kur kompozitori jo vetëm e ka jetuar dhe e dashuruar temën që trajton, por ka asimiluar në mënyrë të vetëdijëshme intonacionet e muzikës së popullit të vet. Ky asimilim intonacionesh nuk bëhet vetëm duke lexuar librat e vëllimet e botuara me melodi popullore, por duke jetuar e kënduar bashkë me popullin, duke ndjerë e njohur së afërmi botën e tij të brendëshme, shijen, ndjenjat intime, aspiratat, gëzimin dhe optimizmin që ai i shpreh me aqë realizëm e vërtetësi në këngët dhe vallet popullore.»

Më poshtë, Baki Kongoli, pasi foli për nevojën e kalitjes së mëtejshme të kompozitorëve tanë si dhe për luftën e prerë që i duhet bërë çdo ndikimi të huaj të dëmshëm të muzikës borgjeze e revizioniste, tha:

«Vetkuptohet se për krijimin e veprave muzikore të formave dhe gjinive të ndryshme me një nivel të ngritur artistik nuk mjafton vetëm njohja e studimi i thellë i folklorit. Motivët rithmike e melodike të këngëve dhe valleve tona popullore do të mbeteshin si një kapital i vdekur në kujtesën dhe fantazinë e kompozitorit në se ato nuk punohen e pasurohen dhe me kriter artistik të thelluar, ku teknika profesionale të shkrihet me ngjyrën, aromën, përmbajtjen e karakterin e muzikës popullore. Përvetësimi i aftësive teknike profesionale, zgjerimi i horizontit kultural, njohja e thellë dhe e shumëanëshme e mjeshtërisë së kompozicionit dhe e disiplinave të tjera artistike janë një problem po aq i rëndësishëm edhe aktual sa edhe njohja e folklorit.

«Nga ana tjetër, nevoja për opera dhe opereta të reja, për balete e gjini të tjera të skenës nga dita në ditë bëhet më e madhe. Tema aktuale, njeriu i kohës, lufta jonë nacional-çlirimtare, transformimet e mëdha ekonomike, sociale e kulture etj. duhet të pasqyrohen jo vetëm në këngët, kantatat e format e vogla, por edhe në gjinitë e skenës. Për konkursin e 25-vjetorit të Partisë sonë shumë kompozitorë ose kanë filluar të punojnë ose jetojnë me emocionet e ethëshme duke menduar se ç'temë të trajtojnë, çfarë subjekti apo libreti të gjejnë për një opera, për një balet, operetë, poemë koreografike etj. Në bisedat e përditëshme që bëjmë vazhdimisht për këto probleme na del gjithmonë preokupante çështja e libreteve. Ka patur raste që disa vepra skenike si balete, opera, opereta etj. me muzikë të mirë, të frymëzuar, të mos kenë patur jehonën e duhur në publik dhe jetë të gjatë në skenë për arsye të libreteve të dobëta. Ky problem duhet të na preokupojë më shumë të gjithëve

në të ardhmen. Do t'ishte shumë e dobishme dhe e nevojshme të organizoheshin konsulta dhe diskutime krijonjëse vetëm për librete, të praktikohej kontraktimi me poetë e shkrimtarë që prestohen për një punë të tillë.

«Është e ditur se jo çdo vepër letrare si tregim, novelë, roman, poemë etj. mund të ketë të dhënat e nevojshme për t'u kthyer në libret. Por megjithë këtë, ka ardhur koha që ne t'i kushtojmë një vëmëndje të posaçme krijimtarisë së shkrimtarëve dhe poetëve. tanë dhe me siguri do të gjejmë tema dhe subjekte interesante që do të mund të trajtoheshin fare mirë në librete e skenare për muzikën. Një punë e tillë, pra, nuk duhet lënë vetëm në inisiativën e kompozitorëve me libretistët, por të merret në shqyrtim e studim në perspektivë, si një aksion i madh me shumë rëndësi që ka të bëjë jo vetëm me pasurimin e mëtejshëm të reperitorit tonë nacional, por edhe me rritjen e rolit të muzikës për edukimin komunist të masave.»

Më poshtë, shoku Baki Kongoli u ndal në një problem tjetër të rëndësishëm të muzikës sonë, në atë të muzikës sonë të lehtë. Ndërmjet të tjerave ai tha:

«Për të pasqyruar sa më mirë romantikën revolucionare të kohës, vrullin dhe optimizmin e masave, ne duhet t'i kushtojmë në të ardhmen një vëmëndje e kujdes të veçantë krijimit të këngëve të reja të karakterit të marshit, këngëve revolucionare, këngëve kushtuar punës, atdheut, Partisë, paqes, miqësisë etj. Duhet thënë se gjatë këtyre kohëve të fundit kënga qytetare nuk është kultivuar sa duhet dhe është anuar pak si tepër në krijimin e këngës lirike e të muzikës së lehtë. Kjo ka ardhur dhe nga shkaku se deri tani festivalet e këngës, që janë organizuar duke filluar nga ai i radio-Tiranës e deri te ata të qyteteve të tjera të vëndit, kanë qënë në përgjithësi festivalet e muzikës së lehtë. Prandaj në plenumin e K.Q. u theksua me shumë të drejtë fakti se «janë krejt të pamjaftueshme këngët për masa dhe marshet e punës me të cilat punëtorët, fshatarët, rinia jonë heroike të shkojnë plot entuziazëm në frontin e punës ashtu si dikur me këngët partizane në gojë suleshin e fitonin mbi armiqtë. Rinia e qytetit dhe e fshatit, klasa jonë punëtore dhe mbarë populli, presin më shumë, presin këngë të tipit «Marshi partizan», «Në një dorë kazmën e në tjetrën pushkën», «Miqësia partizane», «Këngë për shokun Enver», «Prina parti», «Këngë e tekstilisteve» etj. etj.»

### Kristo Kono

Kompozitori Kristo Kono, në diskutimin e tij foli për aktivitetin e shkrimtarëve dhe artistëve të Korçës, për veptrat dhe sukseset e tyre. Pastaj, ai u ndal në një varg detyrash dhe vërejtjesh në lidhje me shkrimtarët dhe artistët e qytetit të tij. Ndërmjet të tjerave tha:

«Megjithë këto suksese që kemi patur gjer më sot në punën tonë krijonjëse, në disa drejtime kemi bërë pak. Prandaj, këtë mungesë ne duhet ta plotësojmë mbaskëtaj. Ne nuk e kemi kryer plotësisht dhe si duhet detyrën tonë për pasqyrimin sa më mirë të aktualitetit dhe sidomos të realitetit të ditëve tona, edhe përsa i përket luftës nacional-çlirimtare shumë pak kemi bërë. Duke vënë në dukje madhësinë dhe heroizmat e panumurta të kësaj epopeje të lavdishme të popullit tonë, ne do të ndihmojmë në kalitjen edhe më shumë të shpirtit luftarak e revolucionar të popullit tonë dhe veçanërisht të rinisë sonë, gjë që mbetet një detyrë aktuale me shumë rëndësi.

«Ne, mbaskëtaj, duhet të shkruajmë më shumë e më mirë edhe përsa i përket ndërtimit socialist, problemeve të mëdha e të rëndësishme që kanë preokupuar dhe preokupojnë masat tona punonjëse, për ngritjen e jetës së re; të shkruajmë për heroizmat e punonjësve tanë që punojnë dhe realizojnë detyrat që u cakton populli dhe Partia.

«Për një punë sa më të mirë në këtë drejtim na del detyrë që të njohim më mirë problemet aktuale të jetës dhe për këtë duhet të jemi në kontakt të afërt me punën dhe jetën e qytetit dhe të fshatit.

«Ne një punë të tillë e kemi filluar, duke marrë në partronazh ndërmarrje dhe kooperativa bujqësore dhe i kemi porositur shokët për të shkuar në bazë, qoftë për të ndihmuar atje, qoftë për të mbledhur material për punën e tyre krijonjëse.

«Detyra e jonë, në radhë të parë, është që të punojmë për ngritjen e mëtejshme të nivelit ideo-artistik të veprave tona, në mënyrë që ato t'u përgjigjen sa më shumë kërkesave të kohës dhe detyrave që na shtron Partia. Për këtë, çdo anëtar i Degës sonë duhet të përpiqet që të zhvillojë më tej aftësitë e tij ideo-profesionale, të punojë më me kujdes e të jetë më kërkues ndaj vetes. Në këtë drejtim, rëndësi të madhe ka diskutimi i veprave në mënyrë parimore dhe të thelluar. Gjithashtu, një ndihmë shumë e dobishme është organizimi i diskutimeve mbi problemet e ndryshme të letërsisë dhe artit.

«Dega jonë, kohë mbas kohe, ka organizuar diskutime të veprave të anëtarëve të saj. Në mjaft raste, këto diskutime kanë qënë të dobishme, megjithatë kjo punë nuk para ka shkuar si duhet. Për një punë më të mirë në të ardhmen, diskutimet të organizohen edhe në bashkëpunim me interesimin e Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve; kjo të bëhet në bazë të një plani të caktuar, duke marrë pjesë në diskutime edhe shokë të dërguar nga ana e Lidhjes.»

## Foto Stamo

Piktori Foto Stamo, pasi foli për rëndësinë që kanë materialet e plenumit të 15-të të K.Q. të P.P.Sh. për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe artit në vëndin tonë, e përqëndroi diskutimin e vet rreth problemit të trajtimit të temës aktuale. Ai tha:

«Krijimtaria në artet figurative, me gjithë se në këto vjetët e fundit dhe veçanërisht në veprat që u paraqitën në ekspozitën e 20-vjetorit të çlirimit, ka trajtuar disa aspekte të problemeve të mëdha të ndërtimit të socializmit siç janë veprat: «Minatorët», «Kooperativistët mbas pune», «Shkri-rësit e metalit», «Punëtorët studjojnë», «Vërsniku i republikës», portrete të njerëzve të rinj dhe heronjve, pezazhi i ri shqiptar etj., nuk ka pasqyruar akoma në mënyrë të gjithanëshme dhe në stil më të gjërë aspekte themelore, prandaj Partia e ngre me të drejtë çështjen e pasqyrimin të problemeve themelore. Hapi i bërë në këto vitet e fundit në kapjen dhe trajtimin e temës aktuale nga piktorët, skulptorët dhe grafistët tanë dhe lidhja e krijimtarisë së arteve figurative me tema të tilla, mendoj se është një hap me rëndësi dhe duhet ta konsiderojmë jo vetëm si një fillim të mirë të gjinive të mëdha të pikturës dhe skulpturës sonë, por edhe si një kthesë me rëndësi edhe në drejtim të temës aktuale, në drejtim të temës së ditëve tona. Krijimet për ekspozitën e 25-vjetorit të P.P.Sh. duhet ta forcojnë dhe konsolidojnë më shumë këtë kthesë drejt temës aktuale. Unë jam i sigurt se piktorët e skulptorët do ta bëjnë këtë. Partia jonë gjithënjë ka theksuar që në qendër të letërsisë dhe arteve të vendoset tema aktuale. Kjo është një kërkesë shumë e drejtë. Me trajtimin e temës aktuale nga piktorët, skulptorët dhe grafistët, do të forcohet më shumë karakteri militant i arteve figurative dhe, në këtë rast, veprimtaria jonë krijuese do të marrë një rëndësi më të madhe. Është e rëndësishme të kemi parasysh se tani që ne kemi hyrë më thellë në jetën e popullit, të mos shkëputemi, por ta forcojmë edhe më kontaktin me bazën për të marrë aspektet më tipike nga jeta dhe për t'i trajtuar ato në gjinitë e ndryshme të artit figurativ duke çfrytëzuar të gjitha mundësitë që kemi në dispozicion. Trajtimi i temës aktuale në artet figurative duhet të bëhet preokupacioni ynë, të mos tërhiqemi nga tema pa ndonjë rëndësi dhe të bindemi akoma më shumë se trajtimi i temës së ditëve tona është aktual dhe ze sot një vënd më kryesor. Me të drejtë bëhen vrejte nga punëtorët nga fshatarët, nga ushtarët, se ata nuk shikojnë shumë aspekte nga puna dhe jeta e tyre. Këto vrejte janë me vënd. Duhet të kuptojmë se krijimtaria jonë duhet të lidhet më shumë me jetën, të pasqyrojë kohën tonë, ndryshimet dhe ngjarjet që revolucionojnë dhe shpien përpara vëndin tonë»

Disa vjet më parë, një piktor punonte një peizazh dhe në këtë kishte vendosur edhe një fshatar me një gomar të ngarkuar me dru. Afër piktorit shkuan dy qytetarë. Në këtë kohë në qiell fluturonte një reaktiv. Qytetarët u afruan dhe pëshpëritën: «Hajde! hajde! tani është koha e reaktivit dhe piktori pikturon akoma gomarin!». Natyrisht piktori u shqetësua, por e pa se vërejtja ishte me vënd. Merni me vënd sa anakronik mund të jetë trajtimi i temave të ngushta, personale dhe pa ndonjë rëndësi shoqërore dhe politike.

«Puna jonë krijuese dhe misioni ynë i rëndësishëm kërkon një përgatitje jo vetëm artistike, por edhe ideopolitike, sepse krijimet tona nuk janë prona jonë, por, mbasi dalin nga duart tona, ato bëhen pronë e masave. Prandaj, ne duhet të kemi jo vetëm kujdes për atë që krijojmë, por të kemi përgjegjësi, sepse veprat tona luajnë një rol të rëndësishëm, rolin e edukonjësit. Për këtë përgatitja jonë ideologjike dhe artistike duhet të bëhet e kualifikuar».

## Odhise Paskali

Skulptori Odhise Paskali e përqëndroi diskutimin e vet në nevojën e lidhjes së artistit me popullin dhe mendimet e tij ai i ilustroi me një ngjarje interesante nga jeta e tij. Ai tha:

«Më lejoni të them shkurtimisht diçka që ka lidhje me frymën e këtyre ndjenjave dhe mendimeve që, në esencë, thonë këtë:

«Të krijojmë për popullin, të mësojmë nga populli.»

«Në muzgun e një dite vjeshte të vitit 1911 kaloi në rrugë para shtëpisë sime në Përmet, i vetëm, një komit i armatosur. Mua, djalë shtatëvjeçar, më bëri një përshtypje të thellë. Ishte i ri e madhështor, me flokë të gjata, gunë, fustanellë të lyrtë, tirq, opinga me xhufkë të madhe. N'ato ditë, ne kalamajtë këndonim «Për Mëmëdhenë». Zëra në mëhallë thanë: kaloi Nexhip Bënja.

«Më të ngrysur të ditës 28 Nëntor 1932, para monumentit të Luftëtarit Kombëtar të porsa inauguruar, sillej i emocionuar populli i Korçës. Një plakë, që mezi mbahesh më këmbë, tha duke qarë: «Korba, djali». «Ky është Nexhip Bënja» tha një zë nga populli. Mbete i habitur. Kritiku popull gjeti se kisha përfytyruar luftëtarin e lirisë, komitin Nexhip Bënja, heroin e fëminisë sime.

«Ja sepse, kur punoj me emocion, ndjenj për qark meje popullin, popullin që ka sy e ndjenja që nuk gabojnë.»

## Kristaq Rama

Skulptori Kristaq Rama foli për skulpturën monumentale dhe për shijen në rregullimin artistik të qyteteve tona. Ai, ndërmjet të tjerave, tha:

«Dihet se në formimin e profilit të një qyteti dhe rregullimin e tij artistik një rol të rëndësishëm luajnë monumentet, skulpturat dekorative dhe format e vogla arqitektonike. Nga vlerat e tyre, si i vendosim ato dhe sa i përgjigjen qëllimit, mvaret në një masë të madhe kultura e ndërtimeve tona në përgjithësi. Prandaj kjo çështje duhet studjuar seriozisht dhe mirë nga organet kompetente në planet rregullues dhe urbanistikë të qyteteve, që të mos ngjasë si në Shkodër ku shumë buste janë vendosur me nxitim dhe pa u menduar mirë.

«Përsa i përket skulpturës dekorative nuk kemi shumë për të thënë mbasi këtu pothuajse akoma nuk kemi filluar. Shembullin e parë në mashtab të madh, në këtë drejtim e dha Vlora. Si iniciativë ajo duhet përshëndetur, por në rrugën e bukur, plot lule e palma, nga Vlora në Skelë, u vendosën fare pa kriter një sërë skulpturash në çimento të rcalizuara keq dhe që nuk i përgjigjen kërkesave të skulpturës dekorative. Ato nuk janë as dekorative, as të kavalitetit dhe as monumentale. Përse ka ndodhur kjo? Sepse autorët janë ngutur dhe nuk kanë pasur të qartë specifikën, objektet, ambjentin që i rrethon dhe proporcionet e vendit ku janë vendosur, por kanë punuar në përgjithësi një punë që do të vihet diku. Këto skulptura në çimento, pjesërisht të thyera dhe të lyera me gëlqere, janë një kontrast i papëlqyeshëm në atë rrugë.»

Më poshtë duke përmendur problemin e materjaleve të forta dhe me ngjyrë lidhur me koloritin e qytetit, ai tha se skulpturat nuk duhet të jenë në çimento.

«Nuk dua të hyj në diskutimin delikat të ngjyrosjes së skulpturave, sepse edhe në qoftë se nuk do të interesohemi ne për këtë punë, kujdeset vetë natyra duke i dhënë me kohë gurit, bronxit dhe materjaleve të tjera, (përveç çimentos) atë ngjyrë të mrekullueshme që e bën skulpturën të amortizohet dhe të tingëllojë aqë mirë në ambjentin që e rrethon.»

### Çesk Zadeja

Kompozitori Çesk Zadeja ja kushtoi diskutimin e tij problemeve të ndryshme që kanë të bëjnë me lulëzimin e mëtejshëm të muzikës sonë. Ai tha:

«Perspektivat e mëdha që hapi plenumi i 15-të i Komitetit Qëndror të Partisë në lidhje me zhvillimin e letërsisë dhe arteve në edukimin komunist të masave na ven të gjithëve ne artistëve para disa problemeve jetësore. Them jetësore meqë të gjitha këto probleme lindin nga nevojat shpirtnore të masave tona, të cilat tashma e kanë ba kulturën dhe artin po aq të nevojshëm sa bukën dhe ajrin. Por vlera konkrete e këtij plenumi qëndron jo vetëm në faktin se ai i shtroi problemet në mënyrë të qartë, të pështetura

thellësisht në një platformë dialektike marksiste, por edhe në faktin se ai na mëson që të gjitha vështirësitë që na dalin përpara në rrugën delikate të krijimtarisë, t'i kalojmë në mënyrë të vendosun. Vetvetiu prandaj kuptohet se kjo forcë frymëzuese e shprehun në raportin e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë hap para nesh një horizont të gjanë dhe të qartë, ashtu si asht e qartë idea e realizmit socialist, e cila asht baza qëndrore e artit dhe e kulturës sonë kombëtare.

«Siç dihet, muzika jonë lindi së bashku me Republikën tonë. Ato u rritën së bashku dhe kjo qe edhe arsyeja historike që e bani këtë muzikë një ushqim shpirtnor për njerëzit e lirë, të cilët frymëzojnë muzikën e kompozitorëve tonë.

«Kjo mendoj asht edhe sekreti i forcës së artit tonë në përgjithësi, dhe i muzikës në veçanti.

«Arti ynë gjithnji u asht përgjegjë problemeve të kohës e në se ankohemi sot për cilësinë dhe sasinë, po thomi, të krijimtarisë sonë muzikore, kjo ndodh për faktin se jeta ecën shumë ma shpejt. Mendoj se muzika jonë do të eci me kohën, në qoftë se pika qëndrore e frymëzimit tonë do të jetë aktualiteti. Vendin qëndror në artin e realizmit socialist e zen përfytyrimi i kohës në të gjitha aspektet dhe, ma tepër se kudo, në ato ngjarje me një karakter dhe randësi popullore, siç asht ndërtimi socialist.»

Diskutimin e tij, shoku Çesk Zadeja e mbylli me një varg propozimesh për organizimin e një seri diskutimesh krijuese muzikore që do të ndihmonin në përparimin e këtij arti tek ne, për gjallërimin e kritikës muzikore, për seleksionimin më të kujdesëshëm të repertorit të Teatrit të Operas dhe të Baletit etj.

### Pandi Mele

Piktori Pandi Mele ja kushtoi diskutimin e vet problemeve që janë të lidhura me zhvillimin e grafikës sonë. Pasi vuri në dukje sukseset e arritura në këtë degë, në mënyrë të veçantë në atë të pllakatit e në grafikën e librit, e më pak në grafikën e lirë, shoku Pandi Mele, tha:

«Pllakati, sa delikat për vetë specifikën e tij, është po aq edhe i rëndësishëm për të tërhequr drejt tij masën, për ta bërë njeriun tonë të ri të jetojë e të punojë me frymën revolucionare që karakterizon epokën tonë. Koha ecën me hapin të shpejta, pra duhet jetuar e punuar me hapin e ritmin e saj.

«Mendoj se për ta çuar më tej këtë mjet luftarak, na duhet të punojmë më tepër, të studjojmë më shumë për t'u ngritur jo vetëm nga ana ideologjike, por edhe nga ana profesionale.

«Duke folur për mundësitë e zhvillimit të grafikës së lirë, mendoj se fusha e veprimit të saj është më e gjerë. Nuk duhet pritur ogranzimi i ekspozitave vjetore për të ekspozuar një sasi me tematikë nga jeta jonë apo nga lufta nacional-çlirimtare. Duke qëndruar sa më afër jetës, piktorët grafikë kanë mundësi të krijojnë seri me tema aktuale dhe t'i ekspozojnë në kohë. Është e freskët akoma jehona e aksionit të madh të rinisë për të cilin u shkrua mjaft në gjithë shtypin tonë, por nga piktorët u botuan pak punime dhe u mjaftua me hapjen e një ekspozite me punë të një autori. Vetë karakteri i kësaj dege të grafikës, e cila zotëron në vetvete një mundësi dhe diapozon më të gjerë në pasqyrimin e ngjarjeve, duhet të ngjallë tek grafistët ndjenjën e përgjegjësisë ndaj detyrave që shtron Plenumi i 15-të për artet tona.

«Rruga që ka ndjekur grafika e librit është e lidhur ngushtësisht me botimin e veprave letrare të autorëve tanë duke filluar nga gjinitë e mëdha, si romani, e deri tek novelat e tregimet.

«Edhe në këtë fushë të grafikës janë bërë hapa të dukshme. Piktorët ilustratorë, numuri i të cilëve është rritur, kanë krijuar kopertina dhe ilustrime të bukura, të cilat janë pëlqyer dhe kanë patur jehonë edhe në masën e gjërë të lexuesve. Megjithatë, duke studjuar me vëmendje raportin e Byrosë Politike të K.Q. të Partisë përpara nesh dalin detyra të mëdha për një paraqitje sa më të bukur dhe artistike të librit, të këtij mjeti të fuqishëm për edukimin ideologjik dhe estetik të masave. Këndeji lind edhe domosdoshmëria e thellimit jo vetëm të ngritjes profesionale nga çdo piktor ilustrator, por edhe të zbulimit të ideve themelore me një gjuhë konkrete figurative dhe të fortë artistike të veprës letrare. Pra, duhet zgjeruar jo vetëm diapazoni i dijeve me anë të studimit të literaturës, por edhe ai i mbledhjes së materialeve jetësore, i tipave, ambjentit dhe peizazhit shqiptar.

«Ilustrimi, si mjet edukues i ngjarjeve që dallohen në veprën letrare, jo vetëm pasuron fantazinë e lexuesit, por ngjall tek ai ndjenja të drejtpërdrejta për heronjtë e veprës e, njëkohësisht, edukon tek ai shijen estetike. E në rast se rruga e ilustrimit tonë këto vite lidhet ngushtësisht me veprat e letërsisë për fëmijë, mendoj se tashmë ka ardhur koha që edhe veprat e gjinive më të mëdha letrare, si romani, të ilustrohen.»

Në plenum e morën fjalën edhe shokë të tjerë. Kështu poeti Fatos Arapi pasi pranoi kritikën që i janë bërë veprave të tij, «Drama e një partizani pa emër» dhe disa

poezive, dobësitë e të cilave ai i gjeti në radhë të parë te shkëputja nga realiteti ynë dhe te ndikimet e huaja në krijimtarinë e tij, foli për nevojën e kalitjes së mëtejshme ideoprofesionale të shkrimtarëve dhe artistëve tanë në mënyrë që ata të jenë në gjëndje të kapin anët më tipike të realitetit tonë e të pasqyrojnë atë në tërë madhësinë e tij. Shoku Spiro Floqi foli për kujdesin që duhet të tregojnë shkrimtarët, këta artistë të fjalës në lidhje me përdorimin e gjuhës në mënyrë që në shkrimet tona të fiksohen format më të drejta leksikore dhe gramatikore. Ndërsa shoku Viktor Gjika diskutimin e tij e përqëndroi në probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin e kinematografisë sonë.



## Çmimet e Republikës për vjetet 1962-1964

**K**ëshilli i Ministrave pasi shqyrtoi propozimet e Komitetit të Çmimeve të Republikës për veprat e krijuara gjatë vjetëve 1962-1963-1964 dhe në zbatim të dekretit «Mbi çmimet vjetore të Republikës për vepra dhe veprimtari të shënuar në fushën e shkencave, çpikjeve, letërsisë dhe arteve» si dhe në urdhëresën e Qeverisë «Mbi dhënien e çmimeve vjetore të Republikës» mori vendimin që të jepen çmimet e Republikës.

Në fushën e teknikës dhe të shkencës jepen këto çmime:

1. Ingj. Petrit Radovickës, Javer Çobanit e Seit Dyrzit, u jepet çmimi i Republikës i shkallës së parë për projektimin e hidrocentraleve të Shkopetit dhe të Bistricës dhe për zgjidhjen e gjithë problemeve teknike që dolën si gjatë fazës së projektimit ashtu dhe gjatë ndërtimit të tyre.

2. Ingj. Hajredin Kumbaros i jepet çmimi i Republikës i shkallës së parë për projektimin me sukses të pjesës teknologjike të uzinës së parë në vendin tonë për shkrirjen e bakrit dhe për ndihmë në zgjidhjen edhe të shumë problemeve të vështira që dolën gjatë zbatimit në tërësi të këtij objekti.

3. Ingj. Pandi Stratoberdhës, Enver Prezës, Emin Mysliut, Pandi Çezmaxhiut dhe Vlash Dakës u jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për projektimin, modelimin dhe ndërtimin e hidrocentraleve të Shkopetit dhe të Bistricës.

4. Ingj. Neim Shashajt, i jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për hartimin e projekteve të ndërtimit të uzinës për shkrirjen e bakrit si autor dhe si konstruktor dhe për ndihmën e dhënë në zgjidhjen e problemeve të vështira që i dolën pjesës elektro-hidro-sanitare të projektit.

5. Ingj. Fadil Kërtushës dhe gjeometrit Adem Stërmasi u jepet çmimi i Republikës i shkallës së tretë për projektimin dhe ndërtimin e fabrikës së çimentos në Tiranë.

6. Ilia Mitrushit i jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për veprën «Dendroflora e Shqipërisë».

7. Jusuf Alibalit e Ndreçi Plasarit u jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për kontributin e shquar të dhënë në përpilimin e Historisë së Shqipërisë (vëllimi i II-të).

8. Selman Rizës i jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për veprën «Pronorët e Shqipes».

9. Haşan Cekës i jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për veprën «Probleme të numismatikës së lashtë të vëndit tonë».

Në fushën e letërsisë dhe të arteve jepen këto çmime:

10. Poetit Ismail Kadarea i jepet çmimi i Republikës i shkallës së parë për poemën «Përse mendohen këto male».

11. Skulptorit Odhise Paskali i jepet çmimi i Republikës i shkallës së parë për monumentin «Partizani» dhe grupin skulptural «Shokët» si dhe për veprimtari të shquar shumëvjeçare në lëmin e skulpturës.

12. Piktorit Foto Stamo i jepet çmimi i Republikës i shkallës së parë për veprimtari të shquar shumëvjeçare në fushën e pikturës si dhe për ekspozitën «Pamje nga RP e Kinës dhe RD e Vietnamit».

13. Kompozitorit Tish Daija i jepet çmimi i Republikës i shkallës së parë për kompozimin e baletit të parë shqiptar «Halili e Hajrija».

14. Panajot Kanaçit i jepet çmimi i Republikës i shkallës së parë për vënien në skenë të baletit të parë kombëtar «Halili dhe Hajrija».

15. Solistit të theatrit të operas e baletit basit Mentor Xhemali i jepet çmimi i Republikës i shkallës së parë për interpretimet e tij të shquara dhe për veprimtari shumëvjeçare në këtë lëmë.

16. Solistit të theatrit të operas e baletit, baritonit Avni Mula i jepet çmimi i Republikës i shkallës së parë për interpretime të shquara dhe për veprimtari shumëvjeçare në këtë lëmë.

17. Poetit Vehbi Skënderi i jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për vëllimin me vjersha «Fletë nga ditari im» si dhe për veprimtari të shquar shumëvjeçare në lëmin e poezisë.

18. Piktorit Vilson Kilica i jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për portretin me ngjyra vaji «Punëtori».

19. Kino-operatorit Viktor Gjika i jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për filmin dokumentar «Bistrica 1963».

20. Solistes së baletit Zoica Haxho i jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për interpretim të mirë të rolit të Delinës si dhe për aktivitet të shquar shumëvjeçar.

21. Solistit të baletit Agron Aliaj i jepet çmimi i Republikës i shkallës së dytë për interpretimin e rolit të Artanit në baletin Delina si dhe për aktivitet të shquar shumëvjeçar.

22. Solistes së baletit Ganimet Vendresha i jepet çmimi i Republikës i shkallës së tretë për interpretim të mirë të rolit të Hajrijes si dhe për aktivitet shumëvjeçar.

23. Shkrimtarit Spiro Çomora i jepet çmimi i Republikës i shkallës së tretë për komedinë «Karnavalet e Korçës».


24. Piktorese Safo Marko i jepet çmimi i Republikës i shkallës së tretë për pllakatin «20 vjetori i Sigurimit të Shtetit».

25. Skulptorit Andrea Mano i jepet çmimi i Republikës i shkallës së tretë për skulpturën në allçi «Malet tona».

26. Skulptorëve Kristaq Rama e Mumtaz Dhrami u jepet çmimi i Republikës i shkallës së tretë për monumentin e Kostandin Kristoforidhit.



Pandi Mele — «Pranvera», linogravurë.



Pandi Mele — «Thatësira po mposhtet», linogravurë.



Pandi Mele — «Ndërtueset», tempera-pastel

nga ana e kangëtarit, qoftë nga orkestrantët, të cilët, të shumtën e rasteve si dhe në takimin e tretë u paraqitën, mund të thuesh, të ngathtë dhe si hije. Ndryshe, nuk mund të delej në një konkluzion të tillë, të cilin e konkretizoi fakti që vetëm solistja e Estradës së Vlorës Meliha Doda u shque për një interpretim të mirë. Solistat në estradë nuk janë për t'u krijuë kohë aktorëvet ose komponentëve të tjerë për t'u veshë. Ata janë pjesë e gjallë e çfaqjes dhe si të tillë duhet të kontribuojnë me kangët e zgjedhuna dhe të këndueme mirë në suksesin e saj. Gjithashtu orkestrinat nuk marrin pjesë në çfaqjet e estradës për zakon. Orkestrantët duhet të paraqesin të gjalla kërkesat që ka vetë kanga. Indiferentizmi, pasiguria, nervozizmi, qoftë në të shprehurit e vijës melodike, të fakturës ritmike etj. pa dyshim janë shkak kryesor në të mos krijuemit e emocioneve ndër spektatorët.

Dekori në estradë ka vendin e vet. Ai, me mjetet që disponon, duhet të ndihmojë për evidencimin artistik të idesë. Fenomeni i thjeshtëzimit të dekoreve dhe të objekteve, ose një lloj konvencionalizmi ka fillue të duket prej kohësh në estradat tona. Ritmi, dinamizmi i ka nxjerrë nga skena tavolinat e mëdha, skenat e plota. Por, siç u vrejti edhe në takimin e tretë, thjeshtëzimi ekstrem vepron negativisht në suksesin e çfaqjes. Estrada e Sarandës kishte për dekor sferën e një globi të futun në kornicen e një sahati katror të veshun me drita të vogla. Ky kompozim, sipas mendimit tonë nuk ishte as logjik, as në funksion të çfaqjes. Trupa e Gjirokastrës, kur donte me paraqitë jetën e re të qytetit të saj, kangës, ose skeçit i krijonte një sfond të tillë ku, nëpërmjet një kartoline të zmadhueme, të binte në sy kalaja e Gjirokastrës ashtu siç ka qenë dyzet vjet të shkueme. Gjirokastrën e sotme, padyshim, e paraqesin veprat e ndërtueme gjatë këtyne 21 vjetëve dhe njeriu i ri, tue pasë në

sfond të largët kalanë. Dekoret e çfaqjes së Vlorës, plot pode dhe shkallë, sikur pengojshin zhvillimin skenik të idesë. Skenat në estradë, sado të thjeshta qofshin, duhet të shërbejnë për evidencimin e mendimeve, t'i veshin ato me një petk të bukur, por logjik. Kombinacione ngjyrash të kota dhe pa asnjë shprehje (dhe aq ma tepër kur ato bahen pengesë ose u krijojnë hije aktorëvet), ulin pa dyshim vlerën e çfaqjes.

Raporti i Byrosë Politike të K.Q. të P.P.Sh. mbajtur nga shoku Ramiz Alia në plenumin e 15-të të K.Q. të P.P.Sh. — mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave — edhe ne punonjëseve të estradave na shtron detyra të mëdha dhe tepër të randësishme për përmirësimin e punës sonë në të ardhmen, për ta cue akoma ma përpara këte art të dashun të masave, në shërbim të tyne dhe të atdheut tonë socialist.

P. Sekuj

### EKSPOZITA E PIKTORIT KOREAN LJU HIEN SUK

Më 22 nëndor 1965, në sallën e Teatrit të Kukllave u hap ekspozita e piktorit korean Lju Hien Suk me peizazhe dhe portrete nga vëndi ynë.

Muarrën pjesë piktore, skulptorë, punonjës të artit e kulturës etj.

Ndodheshin edhe sekretari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Foto Siano, sekretari i Komitetit për marrëdhënie kulturele me botën e jashtëme Kristaq Hobdari, kryetari i degës së arteve figurative në Ministrinë e Kulturës dhe arteve Kristaq Rama etj.

Ishin gjithashtu të pranishëm i ngarkuari me punë a.i. i R.D.P. të Koresë në R.P. të Shqipërisë

Jun Jën Sik dhe kandidati i shkencave biologjike, profesori i Universitetit Kim Ir Sen të Phenianit Lim Çun Hun.

Fjalën e rastit e mbajti kryetari i degës së arteve figurative në Ministrinë e Kulturës dhe Arteve Kristaq Rama, i cili tha ndër të tjera:

«... Punimet e kësaj ekspozite, megjithë të punuara në një kohë shumë të shkurtër të qëndrimit të piktorit në vendin tonë, dëshmojnë qartë për ngrohësinë dhe dashurinë me të cilën ky piktur pa natyrën dhe njerëzit tanë. Si mik i vërtetë i Shqipërisë, atë, në çdo vend dhe qytet që ka vizituar, e ka interesuar jo vetëm natyra e bukur shqiptare, ngjyrat e qarta dhe drita e pastër e bregdetit tonë të shkëlqyer, por dhe veprat e reja, njerëzit e rinj, puls i Republikës së re që po ndërton me vull e vetmohim socializmin në brigjet e Adriatikut.

«Tematika e zgjedhur është mjaft e larmishme. Punimet janë trajtuar me dashuri e vërtetësi. Çdo punë është pasqyrim i realitetit i parë me gëzim dhe i trajtuar shkathët nga miku ynë Lju Hien Suk. Ndërmjet peizazheve të bukur si Dhërmiu, Himara e fabrika e tullave ne shohim portretet e punonjëseve të dalluar dhe atë të nënës shqiptare të luftëtarit korean, të Fotini Nathanailit, e cila bëri për bir djalin e largët nga Koreja që lëftonte për lirinë e vendit të tij nga imperialistët amerikanë.»

Në të 21 tablotë e ekspozuara dhe të punuara që të gjitha brenda një kohe të shkurtër, — siç tha edhe sh. Kristaq Rama në fjalën e tij, — prej një muaji që qëndroi në vendin tonë, piktori korean Lju Hien Suk, zv. drejtor i galerisë së arteve figurative qëndrore shtetërore të R.D.P. të Koresë, është frymëzuar nga peizazhet e mrekullueshme të rivierës sonë («Himara»), «Shtëpia e pushimit në Dhërmi», nga qytete historike dhe pitoreske («Kalaja e Krujës», «Shtëpi karakteristike të Gjirokastrës»), nga pamje fabrikash e uzinash të reja, që po ia ndërrojnë faqen

me një ritëm jashtëzakonisht të shpejtë vëndit tonë («Fabrika e tullave në Vorë», «Laci industrial» etj.), nga punëtorët e këtyre fabrikave dhe uzinave (portrete punonjësish).

Me dashuri e ngohtësi e ka trajtuar piktori edhe portretin. Sigurisht, brenda një kohe kaq të shkurtër të qëndrimit të tij në vendin tonë, ai s'kish si përqëndrohej më shumë.

Piktori Lju Hien Suk ka përdorur pothuase në të gjitha tablotë e ekspozuara ngjyra të ëmbëla, të ngrohta, të çelura e të gëzueshme, ashtu siç është dhe vetë natyra e vendit tonë.

E. F.

### KONCERT ME MUZIKË SHQIPTARE

Me rastin e festës së përvjetorit të 21-të të çlirimit të atdheut, Teatri i Operas dhe Baletit dha më dt. 24 nandor 1965 një koncert me muzikë të kompozitorëve shqiptarë në të cilin merrnin pjesë, nën drejtimin e artistit të merituem Mustafa Krantja, kori, solistat, orkestra dhe trupa e baletit.

Duhet përgëzuar patjetër një inisiativë e tillë dhe shpresojmë se ajo do të jetë fillimi i një burimi të gjallë koncertesh, ku të rrjedhë me të gjithë tingujt muzika e jonë, krijimi i kompozitorëve tanë të talentuem.

Mendoj se ka mbetë shumë mbrapa koha, kur ndëgjuesi i thjeshtë kënaqej me pak. Niveli kultural i masës asht rritë në të gjitha anët, e si rezultat edhe shija e saj artistike (muzikore) ka arritë në një shkallë të tillë, sa që po ven përherë e ma tepër para një përgjegjësie të madhe profesionale si kompozitorët tonë ashtu edhe forcat ekzekutuese.

Ndigjonjësi ynë kërkon tashti, me çdo kusht, përherë pjesë të reja muzikore. Ai kërkon gjithashtu që këto pjesë t'i ndigjo-

jë të ekzekutueme në mënyrën ma të përsosun, jo vetëm nga ana teknike, por edhe nga ana emocionale interpretative.

Përballë detyrave të tilla gjendet sidomos kolektivi i Teatrit të Operas e Baletit, mbasi pikërisht tek ai paraqitet në pikën ma të naltë e ma delikate niveli artistik i ekzekutimit, kultura muzikore si edhe puna krijuese me të gjitha imtësitë e saj.

Koncerti, për të cilin e kemi fjalën, në përgjithësi ç'onte në dy anë: së pari, sepse nuk përmbante kurgja të re dhe, së dyti, sepse qe ndërtue mbi një plan jo të kjtartë dhe heterogjen.

Mund të shtojmë pa frikë se ka kaq shumë muzikë shqiptare, sa që me te mund të përballohet jo vetëm programi i një koncerti vjetor, por edhe i shumë koncerteve të tjerë që mund të jepen kohë më kohë, tue i shfrytëzue njikohësisht ndoshta edhe disa salla të tjera çfaqjeje në mbarë kryeqytetin tonë. Kështu, p.sh., mendoj se një program mund të kombinoesh mjaft mirë vetëm me muzikë dhome, një tjetër, bie fjala, me fragmente nga operat e baletet shqiptare, një tjetër me pjesë të ndryshme vokale (korale ose pjesë për solista) etj, gjë që jo vetëm do të vinte në një lëvizje të gjallë kompozitorët dhe interpretuesit muzikorë, por edhe do të ndihmonte shumë në përhapjen në masë të muzikës sonë profesionale të çfarëdo gjinije qoftë, edhe ajo që asht ma kryesorja, do të ngjallte tek ndigjonjësi i thjeshtë dashurinë ndaj krijimit dhe kompozitorëve tonë.

Në koncertin që u dha përziheshin gjinitë ma të ndryshme muzikore, si, p.sh., miniaturat instrumentale me kantatin e oratorin, ose kangët e tipit të lehtë si «O kangë partizane» e V. Petushit, «Agime shqiptare» e A. Mules, etj. me operën e kështu me radhë. Prandej, asht mirë që të studjohen në parim e pa humbë kohë disa probleme, të cilat, ndonëse për neglizhencë nuk janë mendue si duhet, paraqiten në vetvete për kohën shumë të rëndësishme.

Një minus tjetër për programin qe edhe interpretimi i tij, në përgjithësi mjaft i dobët.

Gjatë koncertit pat aty këtu numura që i tërhoqën vëmëndjen spektatorit, qoftë me përmbajtjen e tyre, qoftë edhe me ekzekutimin. E tillë qe, p.sh., loja e plotë, interpretimi serioz, profesional e i ndërjegjishëm i solistëve të baletit Zoica Haxho dhe Agron Aliaj (laureatë të Çmimit të Republikës) në «pallatin koreografik» muzikë e Çesk Zadesë e koreografi e Agion Aliajt, «Agime shqiptare» e A. Mules interpretuar nga kangëtarja e jonë e talentueme Nina Mula, ose «Skerco» për flaut e piano e Feim Ibrahimit, luejtun me mjaft shkathësi nga flautistit Gjovalin Shestani etj.

Por pat edhe numra të tjerë, të cilët u ekzekutuen mjaft dobët, pa interes, pa ndjenjë, shpesh edhe pa intonacion të plotë, me mungesa rithmike etj. Të tillë qenë p.sh. «Valsi i rinisë» koreografi e Panajot Kanaçit muzikë e Kozma Larës, kanga e Prenkë Jakovës «Në një dorë kazmën në tjetrën pushkën», finali i oratorit të Tonin Harapit «Kangë për malet», i çili megjithëse ishte një ndër numurat ma të bukur dhe ma interesantë të programit, nuk tingëlloi as i plotë e me kontraste, i rrjedhshëm e madhështor siç duhej të buçiste. Mendoj se këtu ka pak të bajë edhe trajtimi e montimi jo i mirë i vetë pjesës.

Orkestra, e cila mori pjesë plotësisht në të gjithë programin luejti me mjaft plogëshi e me mungesë të theksueme intonacioni (sidomos seksioni i frymës), gjë që s'mund t'i falet asaj mbasi pjesët e programit, jo vetëm që janë luejtë kaq herë, por edhe nuk paraqesin kurrfarë vështirësi, as teknike, as interpretative emocionale.

Shpresojmë se në koncertet e ardhëshëm të këtij tipi, programet do të mendohen ma me kujdes e do t'i paraqiten ndigjonjësit tonë, tashma të stërvitun mirë, ma të përgatitun, «të freskët» e në naltësinë e duhun përsa i

përket anës estetike, në mënyrë që edhe ky kolektiv kaq i mirë dhe i fuqishëm artistik, t'i përgjigjet sa të jetë e mundun me të gjitha forcat, detyrave që ka vu para tij, si dhe gjithë artistëve shqiptarë, plenumi i 15-të i K.Q. të P.P.Sh. lidhur me problemet e letërsisë dhe artit.

Ç. A.

## NJË EKSPOZITË QË PREMTON

Ekspozitat e arteve figurative, të organizuara në qytet, qendra pune ose në fshat po forcojnë dita ditës rolin e tyre në zhvillimin e shijeve të drejta në masat. Ekspozimi i veprave të piktoreve të ndryshëm sjell një gjallëri në ambjentin artistik të këtij qyteti dhe ndikon në edukimin ideo-estetik të punonjësve.

Duke u nisur nga ky qëllim, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve në bashkëpunim me Dëgën e Korçës organizoi në fund të tetorit të shkuar ekspozitën e parë me vepra grafike të piktorit të ri Pandi Mele.

Arti grafik, që është në zhvillim e sipër në vendin tonë ka gjetur në tërësi një gjuhë të drejtë dhe elokuate në veprat e Pandi Meles. Në ekspozitë paraqiten vepra të kryera nga autori gjatë pesë vjetëve.

Një ndër punët e para, «Kryet e një vajze», punuar në litografi ka ndërtimin e një vizatimi të kërkuar dhe me efektet e gradacionit dritëhije që i jep një modelim të saktë figurës që trajtohet. Në këtë punë si edhe në ndonjë tjetër, megjithëse mbizotëron mënyra e trajtimit që imponon ambjenti i shkollës, manifestohet sensibiliteti i autorit.

Por piktori i ri paraqitet me kërkues në mjeshhtërinë e grafikës, në ilustrimet e tregimeve të Migjenit të punuara vitin e kaluar si dhe në gjithë veprat e tjera të kryera brenda dy vjetëve.

ve të fundit. Këtë trajtim e gjejmë në shumicën e punimeve të ekspozuara. Në to ndjehet se qëllimi i autorit ka qenë të kapë temën aktuale dhe ta veshë përmbajtjen me mjetet e teknikës së grafikës në një formë ekspresive dhe komunikonjëse. Dhe këtë qëllim autori e ka arritur me një punë të kujdesëshme pothuajse në gjithë punimet e ekspozuara.

Pjesa e ilustrimeve nga tregimet e Migjenit dëshmojnë për një fillim të mirë të autorit në këtë gjini. Në veprën «Zoti të dhashtë» të bën përshtypje vendosja e gjysmë figurës së «Lipësit». psikologjia që shpreh lodhjen, mërziqjen e përbuzjen, ngritja e dorës së tij, zmadhuar me qëllim nga autori, për ta bërë atë në këtë rast më ekspresive, dhe, në të vërtetë, nëpërmjet saj ndjehet forca e fjalës të përsëritur nga goja e Lipësit «Zoti të dhashtë». Kurse në sfond duken silueta e zeza të graus dhe të kryqeve që përforcojnë përmbajtjen. Autori, në këtë veper, na jep një figurë migjeniane të skalituar qartë.

Idea e piktorit ka gjetur zgjidhje të drejtë në veprën «Kufitarët». Është e vërtetë se kompozimin në formë piramidale e gjejmë të përdorur në shumë vepra të artit të së kaluarës. Por në këtë rast përdorimi i kësaj forme bëhet i nevojshëm për ta bërë përmbajtjen edhe më të fuqishme. Krahas piramides së vendosur në siluetën në sfond si she një kufiri zmadhohet dhe forma e piramides të krijuar nga vendosja e kufitarëve, të cilët, duke zënë një sipërfaqe më të madhe në kuadër, bëhen simbol shkëmb graniti të pakapërxyeshëm për armiqtë. Çasti i zgjedhur i mugetirës na jep të kuptojmë se kufitarët nuk kanë mbyllur sy gjithë natën. Qëndrimi i tyre, si ajo e ushtarit në plan të parë me shikimin e tij të mprehtë e vigjilent ashtu edhe ajo e ushtarit dhe qenit të vendosura në sfond pothuajse në silueta të zeza, që janë duke vëzhguar së largu kufirin, lënë të kuptohet qartë se si kryhet detyra që u

ngarkon Partia kufitarëve. Në këtë vepër, në përgjithësi, forma është në funksion me përmbajtjen, duke krijuar kështu një unitet të nevojshëm (me përjashtrim të figurës pleonaste të ushtarit në profil, e cila e shqetëson pak kompozimin) dhe bëhet më komunikonjëse për vëzhguesin.

Një vepër tjetër e realizuar mirë është dhe «Triptihu» punuar në linoleum «Thatësira po mposhtet». Tema është shumë aktuale. Një ndodhi e shkakëtuara nga rrethanat e jashtëzakonshme atmosferike të vitit të kaluar. Dihet masat që u muarrën nga Partia dhe Pushteti me fushatën dhe organizimin e punës vullnetare kundra thatësirës si dhe me çpimin e puseve artizanë. Këto mjete të përdorura, që erdhën në ndihmë të bujqësisë në këto rrethana të vështira, frymëzuan autorin për krijimin e njëres prej veprave më të goditura të ekspozitës. Kjo dëshmon qartë për forcën frymëzuese të subjektit aktual, i cili, në qoftëse jetohet dhe ndjehet, mund të bëhet burim veprave të përsosur.

Autori ka vendosur dy figura në pjesët e anëshme të «triptihut» një të ri nga e majta dhe një të re nga e djathta në silueta të zeza të përkulura përpara në lëvizje, me stomna e kova ndër duar, duke derdhur ujë mbi bimësinë e thatë. Në sfondin e figurave, ullishte dhe të lashta, kurse në sipërfaqen e qendrës, përdoret sfondi i zi për të krijuar kontrastin e nevojshëm me kompozimet e anëshme si edhe për të nxjerrë në evidencë rrjedhjen e ujit të bollshëm që po derdhet me vrull nga një pus i porsa çpuar, po kështu dhe vizatimi i gjeheve të freskëta të vendosura në kuadër për të simbolizuar efektin e vaditjes. Megjithatë ky subjekt është trajtuar në tri pjesë, ashtu si e kërkon zgjidhja e triptihut, forma e zgjedhur nga autori për të trajtuar këtë temë, të tre pjesët e kompozuara veças njëra nga tjetra, së bashku formojnë një unitet në për-

mbajtje dhe në formë nëpërmjet kompozimit pothuajse simetrik të figurave dhe derdhjes së ujit, të cilat, së bashku, formojnë një ritëm të rregullt e të këndëshëm dhe bëjnë të kuptohet se ky subjekt është kapur, ndërë dhe realizuar mirë.

Me kujdes janë trajtuar dhe punimet në linogravurë «Vullnetarët», subjekti romantik «Më pëlqen vështrimi juaj shoqe» si dhe «Pranvera» në realizimin e së cilës shprehen nota poetike të autorit.

Dy punime me dimensione pothuajse të njëjta «Ndërtuesit» dhe «Malësori kooperativist», të vendosura njëra pranë tjetrës në ekspozitë, formojnë kontrast në realizimin e tyre. Te «Ndërtuesit» të tri figurat e punëtorëve të ndërtimit, me vendosjen dhe prerjen kompozicionale që u ka bërë autori, me momentin e goditur të takimit të tyre, duke na i paraqitur ato me veglat dhe mjetet e punës, psikologjinë e tyre në atë çast takimi kur ato shkëmbejnë fjalë të gëzueshme, ambjenti i ndërtimit dhe sfondi i kuq që harmonizon tërësinë koloristike dhe nxjerr në pah figurat, janë mjete shprehëse që e bëjnë atë një vepër të realizuar. Por kjo nuk ngjet edhe në veprën «Malësori kooperativist». Duket se autori nuk e ka patur vizionin e qartë në trajtimin e këtij subjekti. Qëndrimi statik i malësorit me duart në mes formon një kontrast me tri vajzat që punojnë në sfond. Psikologjia e tij e dyshimtë, që duket se shpreh më tepër kënaqësinë që të punojnë të tjerët dhe vetë të rrijë, (në realitet ai qëndron inaktiv ndaj punës) gjithë kjo zgjidhje kompozicionale dhe psikologjike nuk na jep atë që ka dashur të thotë vetë autori. Prandaj ajo mbetet një punë e përcaktuar.

Është mirë t'i vihet në dukje gjithashtu autorit të ketë kujdes që të evitojë ndikimin e ndonjë veprave, e cila e shpie në trajtim të punimeve konvencionale dhe skematike, si në rastin e punimit me pastel «Varkat», gjithashtu të përpiqet që në trajti-

min e peisazhit me ngjyra: «Kështjella Rozafat» të jetë më i qartë në përcaktimin e materies dhe të ambienteve. Përpjekjet e autorit duhen të përqëndrohen edhe në unifikimin e një forme që të përmbajë një gjuhë personale e koerente.

## Vangjush Tushi

### «NË KËRKIM TË NGJARJEVE»

Estrada e Shtetit e hapi stinën e re teatrale me premierën «Në kërkim të ngjarjeve», regjizori i sëcilës është Milto Profi. Në këtë çfaqje trajtohen probleme të ndryshme të ndërgjegjes, por vëndin kryesor e zënë ato të temës politike ndërkombëtare, veçanërisht të ngjarjeve lidhur me Vietnamin. Çfaqja hapet me dy këngë revolucionare për Vietnamin, pas-taj para syve të spektatorëve parakalojnë ngjarjet e ndryshme të gërshetuara për të dy temat. Kish skeçe e intermexo, ku me humor e satirë, e cila herë herë arrinte gjer në sarkazmë, goditej politika e qarqeve drejtonjëse amerikane ndaj Vietnamit dhe, në të njëjtën kohë, tregohet qëndresa heroike e vietnamezëve, të cilët, me vetmohim dhe trimëri të rrallë, mbrojnë atdheun e tyre. Bukur ish ndërtuar pantomima: «Asnjë minutë s'i lëmë të qetë», skeçi «Martesa» etj. Edhe skeçet: «Në tren», «Shitësja», «Ditlindja» ishin të goditur dhe trajtonin probleme të ndryshme, të sjelljeve, zakoneve, e veseve të këqia që akoma mbartin disa persona.

Në përgjithësi, mund të themi se çfaqja kish larmi. Këtë ja jepnin këngët, recitimi, pantomimat akrobatike, skeçet, intermexot etj. Vëndin kryesor, me të drejtë, e zinte skeçi si gjinia kryesore e estradës. Regjizori kish punuar në këtë drejtim.

Premiera «Në kërkim të ngjarjeve», megjithëse pati një farë suksesi, nuk iu përgjigj si duhej kërkesave të spektatorëve, ndaj ata e pritën jo me ngroh-tësinë e duhur. Ka ardhë koha që në çfaqjet tona të rritet cilësia artistike. Ky problem ngrihet me forcë edhe në materialet e plenumit të 15-të të Komitetit Qëndror të P.P.Sh. Çdo premierë duhet të shikohet me sy kritik, t'u bëhet një vlerësim objektiv si vlerave ideo-artistike të materialeve, ashtu edhe realizimit të tyre skenik.

Regjizori nuk kish mundur t'i çfrytëzonte mundësitë e shumta që përmbante titulli për të ndërtuar një çfaqje me një bosht qëndror, me një ide të caktuar dhe një tërësi artistike. Në këtë drejtim nuk ish bërë një punë profesionale e thelluar, kështu që titulli i çfaqjes «Në kërkim të ngjarjeve» tingëllonte artificial, ashtu siç ishte artificiale edhe futja e dy konferenciereve. Ato të dyja (konferencieret) kryenin funksionin e njëres, nuk ish hartuar teksti në mënyrë të tillë, që ato të evidencenin njëra tjetrën. Por ajo që ka më rëndësi është fakti se konferencieret qëndronin krejtësisht jashtë çfaqjes. Ndërhynin kur nuk ish nevojja, shpjegonin idenë e ndonjë skeçi, të cilën spektatori e nxori vetë pasi pa çdo gjë në veprim.

Në montimin e çfaqjes, regjizori nuk kish një koncept të qartë regjizorial. Menjëherë pas skeçit «Bombardimet në Vietnam» del konferencierja e thotë: A. Take do të këndoje këngën «Unaza», teksti i sëcilës është mbushur me dashuri e buzëqeshje në çdo strofë. Do t'ishite e arësyeshme që pikërisht tani të këndohej një këngë revolucionare për Vietnamin e vietnamezët. Kështu, çfaqja i ngjet një albumi me fotografi, ku i zoti i albumit ka futur dorën në grumbullin e fotografive në sunduk dhe nuk ka parë se cilën fotografi të marrë më parë, e cilën më pastaj, por ashtu i ka vendosur në album, si kanë qëlluar.

Një procedim i tillë është diletantesk, i pafrutshëm dhe i dëmshëm. Ndonëse regjia ish udhëhequr nga spontaniteti në ndërtimin e këtij numëri, materialet letraro-muzikore ishin në përgjithësi të mira. Veçanërisht skeçet që përmendëm më lart.

Kish edhe skeçe të dobët si «Klubi kultural», «Tek ustai shko» etj. Skëci «Klubi kultural» ish mbushur plot me vulgarizma, mendime bajate, humor të trashë dhe naiv. Kjo vjen se autori nuk e njuh fare këtë problem.

Nëse materialet janë baza mbi të cilën do të punojnë regjizorët dhe aktorët, realizimi i tyre skenik është çështja e dytë, po kaq e rëndësishme sa e para. Për këtë mund të themi se në këtë çfaqje ishin arritë disa rezultate. Shumë aktorë ishin larguar nga një interpretim pompoz e deklarativ, nga loja e paqëllimë dhe nga një farë diletantizmi që herë herë nxirte krye në çfaqjet e mëparëshme të kësaj trupe. Për interpretim të thjeshtë, të natyreshëm, brënda kuadrit të personazheve që interpretonin, u dalluan Enver Dauti, veçanërisht në skeçin «Në tren», në patomimën «Pikëpamja jugosllave për Vietnam» dhe X. Zyberi në disa role. Mirë interpretoi edhe M. Çobani, megjithëse gati të gjitha personazhet na i dha me ndryshime shumë të vogla e herë herë kalonte në një interpretim natyralist. Dy konferencieret: Maxhide Pici dhe Margarita Pjetri duhej të ishin më të gjalla e më të shkathëta. Fjala dhe mendimi i tyre duhej të komunikonte më tepër me spektatorin dhe me aktorët. Mungesa e gjallërisë së tyre ishte ndofta një ndër shkaqet që çfaqjes i mungonte ritmi.

Në këtë çfaqje, më dobët, u paraqit aktori Skënder Plasari. Si në skeçin e parë «Bombardimet në Vietnam», ashtu edhe në skeçin «Klubi kultural» ai nuk kish arritur të kuptonte personazhet që interpretonte, por thoshte fjalë përmendësh, me një gjuhë të rëndë tiranase.

Në këtë çfaqje binte në sy edhe puna e pakët e regjisë me aktorin, krijimi i mizanskenave të dobëta, qoftë nga ana figurative e simbolike, ashtu edhe përsa i përket ekspresivitetit dhe mundësisë që mund t'i krijonin ato aktorit për të shprehë mendimet e personazhit, sa më të plota, deri në rrjeshtat e fundit të sallës. Dobët ish punuar skeçi «Shitësja», «Klubi kultural», «Usta Brahim» etj.

Në përgjithësi edhe muzika ishte e dobët. Këngët ishin zgjedhur sa për të kaluar radhën dhe këndoheshin pa shpirt nga solistet apo solistët. Dirigjenti pak kish punuar me orkestrën dhe me këngëtarin e ri M. Basha.

Më mirë u paraqit Ansambli i këngëve dhe valleve, i cili ekzekutoi mjaft mirë, me plasticitet, hir artistik dhe ngrohësi, një valle vietnameze me çadra. Baletmaestri S. Selimi kish bërë një punë të mirë.

Duhet të rrisim ekzigjenca si drejtorja ashtu edhe regjizori, aktorët e tërë personeli punonjës. Secili të ndjejë përgjegjësinë që ka, për të nxjerë çfaqje me një cilësi sa më të lartë ideo-artistike, për të plotësuar kërkesat gjithënjë në rritje të spektatorit. Lufta për një përmbajtje të shëndoshë që t'u përgjigjet gjithmonë problemeve aktuale dhe për cilësi të lartë artistike, duhet të jetë problemi i ditës i të gjithë punonjësve të estradës.

Mexhit Prenç

# M e d y f j a l ë

## NGA AKTIVET E PARTISË KUSHTUAR LETËRSISË DHE ARTEVE

Prej datës 30 nëndor gjer më 1 dhjetor u mblodh aktivi i Partisë i qytetit të Tiranës.

Në punimet e aktivitetit mori pjesë edhe i deleguari i Komitetit Qëndror të Partisë së Punës të Shqipërisë Mehmet Shehu, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Aktivi dëgjoi një raport në emër të Byrosë së Komitetit Partisë të qytetit të Tiranës «Mbi punën e Partisë për forcimin e rolit të letërsisë e arteve në edukimin komunist të masave», mbajtur nga sekretarja e Komitetit të Partisë Fiqete Shehu.

Aktivi i Partisë i zhvilloi punimet në frymën e plenumit të 15-të të Komitetit Qëndror të Partisë së Punës të Shqipërisë mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave.

Në aktiv foli edhe shoku Mehmet Shehu.

...

Më 1 dhjetor u mblodh aktivi i partisë i rrethit të Shkodrës, i cili shqyrtoi detyrat që u dalin organizatave bazë të partisë lidhur me detyrat që shtroi plenumi i 15-të i Komitetit Qëndror të P.P.Sh. Merrin pjesë sekretarë të organizatave bazë të partisë etj. Ndodhej edhe anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qëndror të P.P.SH, Hysni Kapo. Raportin mbi detyrat që u dalin organizatave bazë të partisë në rreth për zbatimin e vendimeve të plenumit të 15-të të Komitetit Qëndror të P.P.SH. e mbajti sekretari i parë i Komitetit të partisë për rrethin Sul Baholli.

Në aktiv foli edhe shoku Hysni Kapo.

...

Gjithashtu në Pogradec u mblodh aktivi i partisë për rrethin, i cili diskutoi detyrat që caktoi plenumi i 15-të i Komitetit Qëndror të P.P.SH. mbi letërsinë dhe artet. Merrte pjesë edhe anëtar i Komitetit Qëndror të P.P.SH. Behar Shtylla.

Raportin e mbajti sekretari i Komitetit të partisë për rrethin Todi Kokoneshi.

...

Në qytetin e Durrësit u mbajt aktivi i partisë së rrethit. Aktivi diskutoi mbi detyrat që shtroi plenumi i 15-të i Komitetit Qëndror të Partisë për rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve. Në punimet e këtij aktiviteti asistoi edhe antari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qëndror të P.P.Sh. Ramiz Alia.

Raportin e mbajti sekretari i parë i Komitetit të Partisë së rrethit Dashnor Mamaqi.

\*\*\*

«Të zhvillojmë më tej letërsinë dhe artin për edukimin komunist të masave», nën këtë parullë zhvilloi në Elbasan punimet e tij aktivi i partisë, i cili, në frymën e punimeve të plenumit të 15-të të Komitetit Qëndror të Partisë, diskutoi gjëndjen dhe zhvillimin e letërsisë dhe arteve në këtë rreth dhe përcaktoi detyrat për të ardhmen.

Në punimet e aktivitetit mori pjesë edhe anëtari i Byrosë Politike dhe sekretari i Komitetit Qëndror të Partisë, Rita Marko.

Sekretari i parë i Komitetit të partisë për rrethin Jashar Menzelxhiu mbajti raportin mbi zhvillimin e letërsisë e arteve.

\*\*\*

Më 2 dhjetor zhvilloi punimet aktivi i partisë të rrethit të Beratit. Merrnin pjesë sekretarë të organizatave bazë të partisë, përfaqësues të organizatave të masave, punonjës të letërsisë dhe arteve, etj. Në punimet e tij mori pjesë edhe anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të P.P.SH., Gogo Nushi.

Raportin e Komitetit të partisë të rrethit mbi problemet e letërsisë e arteve për edukimin komunist të punonjësve e mbajti sekretari i Komitetit të partisë të rrethit, Peçi Orgocka.

\*\*\*

Në aktivitetin e partisë të rrethit të Vlorës kushtuar problemeve të letërsisë e arteve, merrnin pjesë anëtarë të plenumit, sekretarë të organizatave bazë të partisë, drejtorë të ndërmarrjeve, kryetarë të kooperativave bujqësore, punonjës të kulturës, etj.

Morri pjesë gjithashtu i deleguari i Komitetit Qëndror të Partisë, anëtari i Komitetit Qëndror Fadil Paçrami.

Sekretari i Komitetit të partisë të rrethit, Petro Ciruna mbajti një raport mbi detyrat e partisë, pushtetit dhe organizatave të masave për vënien në jetë të vendimeve të plenumit të 15-të të Komitetit Qëndror të P.P.Sh., mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave.

\*\*\*

Në Sarandë u mbledh aktivi i partisë, ku u diskutuan detyrat që caktoi plenumi i 15-të i Komitetit Qëndror të P.P.Sh. mbi letërsinë dhe artet.

Në punimet e aktivitetit mori pjesë edhe i deleguari i Komitetit Qëndror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Todi Lubonja, anëtar i Komitetit Qëndror të P.P.Sh.

Raportin e mbajti sekretari i Komitetit të Partisë për rrethin Agim Bejtja.

\*\*\*

Në Korçë u mbledh më 8 dhjetor aktivi i partisë i rrethit kushtuar problemeve të letërsisë dhe arteve. Në aktivitetin mori pjesë edhe anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë dhe zv. kryetar i parë i Këshillit të Ministrave Manush Myftiu.

Raportin e byrosë së komitetit të partisë të rrethit «Mbi masat që duhen marrë për zbatimin e detyrave të plenumit të Komitetit

Qëndror të P.P.Sh.» e mbajti sekretari i komitetit të partisë të rrethit Leka Shkurti.

Në aktivitetin mori pjesë edhe shoku Manush Myftiu.

\*\*\*

Më 8 dhjetor në Gjirokastrë u mbledh aktivi i partisë për rrethin, i cili shqyrtoi problemet e letërsisë dhe arteve sipas detyrave që shtroi plenumi i 15-të i Komitetit Qëndror të Partisë. Në aktivitetin mori pjesë sekretarë të organizatave bazë, përfaqësues të organizatave të masave, punonjës të letërsisë dhe arteve etj. Ndodhën edhe anëtari i Byrosë politike dhe sekretari i Komitetit Qëndror të Partisë, Ramiz Alia.

Një raport mbi punën e gjertanishme në lëmin e letërsisë dhe arteve si dhe mbi detyrat për zhvillimin e tyre të mëtejshëm, mbajti sekretari i Komitetit të Partisë për rrethin, Kristo Shara.

Në aktivitetin mori pjesë edhe shoku Ramiz Alia.

#### U KTHYE NË ATDHE NGA RS E RUMANISË DELEGACIONI I KINEMATOGRAFISË

Më 9 Dhjetor u kthye nga Republika Socialiste e Rumanisë delegacioni i kinematografisë shqiptare, i kryesuar nga Fatmir Gjata, i cili në bazë të planit të bashkëpunimit kulturor midis dy vendeve tona mori pjesë në ditën e filmit shqiptar që u organizua në Bukuresht, me rastin e 21 vjetorit të çlirimit të Shqipërisë.

Delegacioni u prit në aeroport nga Kristaq Rama, kryetar degë në Ministrinë e Kulturës dhe arteve, përfaqësues të Komitetit Shqiptar për marrëdhënie kulturore e miqësore me botën e jashtme, përfaqësues të kinostudios «Shqipëria e Re» etj.

Kishin dalë gjithashtu sekretari i ambasadës së RS të Rumanisë në Shqipëri George Miku.

#### VËNDI YNË DO TË MARRË PJESË NË EKSPOZITËN E VI-TË BIENALE TË ARTEVE FIGURATIVE TË VENDEVE TË MESDHEUT

Më 9 dhjetor u nis për në Aleksandri skulptori Odhise Paskali, i cili do të marrë pjesë në hapjen e ekspozitës së 6-të bienale të arteve figurative të vendeve të Mesdheut, ku përfaqësohet me një ekspozitë edhe vendi ynë.

#### VAJZA OPTIMISTE

Premierën e parë të sezonit teatral 1965-1966 theatri dramatik i qytetit të Vlorës e çeli me komedinë «Vajza optimiste» të M. Daliut vënë në skenë nga regjizori Nazmi Bunjaku dhe skenograf Pandeli Shamo.

Me këtë pjesë kjo trupë bëri edhe turneun e parë të këtij sezoni në qytetet e jugut si në Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Gjirokastrë, Delvinë, Sarandë dhe Himarë.

Gjatë turneut u dhanë 15 çfaqje, të cilat u pritën ngrohtë nga spektatorët e këtyre qyteteve.

Këto ditë trupa është duke dhënë çfaqje në Selenicë, Orikum, Nartë, Llakatund etj.

Tani trupa e teatrit ka filluar punën për vënien në skenë të dramës «Doktor Aleks» të I. Uruçit të cilën do ta çfaqë më 20 janar 1966; me këtë trupa e teatrit të Vlorës vë pjesën e dytë nacionale në sezonin teatral 1965-1966.

«MENDO, BAN KTHESË»

Në kuadrin e festave të Nëntorit, teatri i estradës dha për publikur e Shkodrës premierën «Mendo, ban kthesë». Njëpërmjet të skeqeve, intermexove, kupleteve, këngëve më të mira, trajtohen probleme lidhë me edukimin komunist të punonjësve dhe satirizohen të metat e disa njerëzve, lidhë me qëndrimin ndaj punës. Çfaqja u vu në skenë nga aktori T. Banushi me përgjegjës muzike A. Salobegu, dirigjent M. Kaffalli. Interpretuan aktorët: A. Kastrati, T. Banushi, P. Preka, H. Sula, H. Smaja, si dhe këngëtarët B. Ndoja, F. Puka, F. Gjergji e N. Gjergji.

«ATO QË KEMI DO T'UA THEMI»

Ky është titulli i cfaqjes së re të estradës profesioniste të Beratit, me të cilën ajo hapi stinën e re teatrale. Spektaklin e realizoi në skenë regjizori Vangjush Popli me drejtues muzike Asqeri Kadëna.

Luajtën aktorët A. Popli, Xh. Kadëna, N. Hasnedari, L. Kule, H. Durra. Kënduan solistët Shane Hasko dhe Ireni Dhaskali.

Deri tani ky numur është cfaqur 21 herë për punonjësit e Beratit, Qytetit Stalin, Burrelit, Peshkopisë dhe Kukësit.

EKSPOZITË E ARTEVE FIGURATIVE NË VLORË

Në një nga sallat e shtëpisë së kulturës dhe krijimtarisë popullore të qytetit të Vlorës u hap një ekspozitë me punimet e piktorëve të qytetit.

Në ceremoninë e hapjes merrnin pjesë sekretari i parë i Kom. Partisë të rrethit shoku Mihallaq Gjinikasi dhe shumë të ftuar.

Kanë paraqitur punimet e tyre Skënder Kamberi, Spiro Lolo, Vasil Talo, Rakip Shabani, Skënder Tena, etj.

Tematika e punimeve të kësaj ekspozite është mjaft e gjerë. Mbizotëron kryesisht peizazhi. Ka tablo nga lufta nacional-çlirimtare, aspekte nga ndërtimi socialist i vëndit etj. Dallohen sidomos punët e piktorit Skënder Kamberi, i cili këtë vit mbaroi shkollën e lartë të arteve figurative.

\*\*\*

Më 19, 20 dhe 21 nëndor 1965, u zhvillua në Korçë në sallën e Teatrit «Çajupi» Festivali i këngës korçare. Dymbëdhjetë solistë, tre grupe korale, dy komplekse vokale dhe një kompleks orkestral prej afro 20 vetësh, ekzekutuan me vëmëndje e mobilizim të 20 këngësi konkruuese. Përveç kompozitorëve të njohur si Kono, Trako, Avrazi, Uçi, Morcka, Kote etj. në festival kishin marrë pjesë dhe mjaft të rinj amatorë me talent. Gjatë interpretimit të këngëve, publiku duartrokiti shpesh solistët T. Adhami, M. Tërova, A. Tringovski, R. Jorganxhi, G. Napoloni, E. Daço, F. Puka, M. Zallemi, P. Suljotj etj. Punë të zellëshme e të palodhur në përgatitjen e repertorit të festivalit ka bërë dhe dirigjenti S. Bujari. Çmimi i parë iu dha këngës «Mirëseardhe» të Ll. Morckës. Dy çmime të dyta i fituan këngët «Me zjarr fshatarak» e P. Shollës dhe «Të lashë plakë të gjeta nuse» e K. Kotes. Tre çmime të treta fituan këngët, «Korçë, o qytet freskie» e G. Avrazit, «Yjtë ndizen» e A. Hajros dhe «Gjeollogët» e inxhinjerit të ri Ilo Vinjau.



Dorëshkrimet pranohen të daktilografuara e në dy kopje. Në çdo rast, ato nuk kthehen.

Adresa: Tiranë, Rr. Z. Baboçi Nr. 37. — Tel. 30-16  
Pajtimet: 6 muaj 16,5 1 vit: lekë 33.

Tirazhi: 3300

Formati 56X96 1/16


Stash: 2204-55

Shtyp. N.I.SH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE TË SHQIPËRISË

1

# NENDORI



# NENDORI



E PËRMUAJSHME LETRARE — ARTISTIKE — SHOQËRORE — POLITIKE

Çmimi: 3 lekë